RAPORT
PËR VLERËSIMIN E ZBATIMIT TË KONVENTËS PËR ELIMINIMIN E TË GJITHA FORMAVE TË DISKRIMINIMIT NDAJ GRUAS NË SHQIPËRI

DHJETOR 2005
Ky botim u realizua për Agjencinë e Shteteve të Bashkuara për Zhvillimin Ndërkombëtar nga Chemonics International Inc.

Idetë e shprehura nga autorët e këtij botimi, nuk pasqyrojnë domosdoshmërisht qëndrimin e Agjencisë së Shteteve të Bashkuara për Zhvillimin Ndërkombëtar apo të Qeverisë së Shteteve të Bashkuara.

FALENDERIME

Ky raport u hartua nën kujdesin e Nismës për të Drejtat e Grave (WLR), një projekt i Agjencisë së Shteteve të Bashkuara për Zhvillim Ndërkombëtar (USAID) dhe vjen si rezultat i punës dhe angazhimit të madh të shumë njerëzve.
Nisma për të Drejtat e Grave dëshiron t'i shprehë mirënjohjen para së gjithash Zj. Emira Shkurti, Këshilltare Ligjore e WLR-së dhe Dr. Aida Orgockës, eksperte në çështjet e përkatësisë gjinore. Së bashku, ato kanë mbajtur pjesën më të madhe të barrës për mbledhjen dhe analizën e hulumtimeve, vlerësimin e rezultateve dhe hartimin e këtij raporti si në gjuhën angleze, ashtu edhe në atë shqipe. Ky raport do të kish qenë i pamundur pa përkushtimin dhe këmbënguljen e tyre.
WLR vlerëson kontributin e rëndësishëm të Z. Ledi Bianku dhe Zj. Tefta Zaka, të cilët përgatitën një analizë të hollësishme dhe të kujdesshme të shkallës së përputhjes së legjislacionit shqiptar me Konventën për Eliminimin e të Gjitha Formave të Diskriminimit ndaj Grave për pjesën *de jure* të raportit. Gjithashtu WLR falenderon edhe ata që realizuan kërkimet në terren dhe mblodhën të dhënat për pjesën *de facto* të raportit: Zj. Galsvinda Fili nga Qendra Avokatore e Grave, Z. Admir Meko nga Qendra për Aleancën Gjinore për Zhvillim, Zj. Monika Asllani nga Shoqata e Grave "Refleksione", Zj. Enida Kallço nga Fondacioni Shqiptar për Popullsinë dhe Zhvillimin si dhe Zj. Brunilda Dervishaj nga Komiteti për Mundësi të Barabarta i shtetit shqiptar. Secili prej tyre i kushtoi mjaft kohë realizimit të intervistave dhe diskutimeve në grup nëpër të gjithë Shqipërinë, duke na dhënë mundësinë neve të vështronim nga afër jetën e përditshme të grave shqiptare. Nisma për të Drejtat e Grave vlerëson mjaft edhe pjesëmarrjen e atyre personave që treguan gadishmërinë të ndanin me ne kohën dhe mendimet e tyre nëpër intervista dhe diskutime në grup.
Zj. Lavdie Ruci, Zj. Monika Asllani, Zj. Jasminka Friscic nga Shkupi dhe Zj. Gerry Bjallerstedt nga Uashingtoni, DC, na dhanë komente dhe sugjerime me vlerë për përmirësimin e këtij raporti. Dëshirojmë gjithashtu të falenderojmë Z. Koço Bendo, i cili përktheu pyetjet për pjesën *de jure* dhe *de facto* në gjuhën shqipe. Zj. Shkurti dhe Zj. Manjola Orgocka, Asistente Administrative e Nismës për të Drejtat e Grave koordinuan proçesin e vlerësimit të Konventës për Eliminimin e të Gjitha Formave të Diskriminimit ndaj Grave si dhe publikimin e këtij raporti. Dëshirojmë të shprehim falenderimet tona edhe për Zj. Friscic për mbështetjen dhe përvojën e saj me vlerë në hapat e parë të këtij projekti si dhe për Zj. Teresa Cannady, ish-Zv. Drejtore e Nismës për të Drejtat e Grave, e cila e konceptoi projektin. Ky raport u mbështet gjerësisht në Mekanizmin Vlerësues të Konventës për Eliminimin e të Gjitha Formave të Diskriminimit ndaj Grave, të përpunuar nga Nisma për Europën Qendrore dhe Lindore të Dhomës Amerikane të Avokatëve (ABA/CEELI) Së fundi dëshirojmë t'i shprehim mirënjohjen USAID-it për mbështetjen financiare për Nismën për të Drejtat e Grave si dhe për këtë botim.

Mary C. Theisen
Zëvendës Drejtore
Nisma për të Drejtat e Grave
Chemonics International
Uashington, DC
20 janar, 2006

PËRMBAJTJA

Falenderime .....
Shkurtime i
Përmbledhje.....iii
Hyrje 1
Metodologjia 3
Neni 1 5
Neni 2 7
Neni 3 13
Neni 4 18
Neni 5 20
Neni 6 22
Neni 7 26
Neni 8 30
Neni 9 32
Neni 10 34
Neni 11 40
Neni 12 47
Neni 13 53
Neni 14 55
Neni 15 60
Neni 16 62
Konkluzione 67

Shtojcë 1: Burimet shtesë 71
Shtojcë 2: Listë e Plotë e Aspekteve Problematike 73
Shtojcë 3: Listë e Plotë e Ligjeve të Marra në Analizë 77
Shtojcë 4: Aspektet Problematike dhe Rekomandimet e Dhëna nga Komiteti i CEDAW-t Shtetit Shqiptar me Rastin e Paraqitjes së Raportit Fillestar dhe të Dytë Periodik, të Kombinuar 79
Shtojcë 5: Pyetjet për Vlerësimin De Jure 83

SHKURTIME

CEDAW	Konventa mbi Eliminimin e të Gjitha Formave të Diskriminimit ndaj Grave
CEELI	Nisma për Europën dhe Euroazinë e Dhomës Amerikane të Avokatëve
KMB	Komiteti për Mundësi të Barabarta
IOM	Organizata Ndërkombëtare e Migracionit
ILO	Organizata Ndërkombëtare e Punës
NHDR	Raporti Kombëtar për Zhvillimin Njerëzor
OJQ	Organizatë joqeveritare
OJF	Organizatë jofitimprurëse
ZLT	Zyra për Luftën ndaj Trafikut
OSBE	Organizata për Sigurinë dhe Bashkëpunimin në Europë
RSH	Republika e Shqipërisë
TIP	Trafikimi i personave
PNUD	Programi i Kombeve të Bashkuara për Zhvillimin
UNICEF	Fondi i Kombeve të Bashkuara për Fëmijët
UNIFEM	Fondi i Kombeve të Bashkuara për Zhvillimin e Grave
USAID	Agjencia e Shteteve të Bashkuara për Zhvillimin Ndërkombëtar
OBSH	Organizata Botërore e Shëndetësisë
VKM	Vendim i Këshillit të Ministrave
WLRI	Nisma për të Drejtat e Grave

PËRMBLEDHJE

Ky raport mat shkallën e përputhjes së Shqipërisë me angazhimet e saj ndërkombëtare që rrjedhin nga Konventa mbi Eliminimin e të Gjitha Formave të Diskriminimit të Gruas (CEDAW), ratifikuar prej saj më 1994. Raporti përpiqet të vërë në dukje ato ligje dhe praktika ku Shqipëria përputhet ose nuk përputhet me CEDAW-n.

Përgjithësisht legjislacioni shqiptar përmbush mjaft nga rekomandimet e CEDAW-t. Ai ofron garanci të përgjithshme që të gjithë shtetasit shqiptarë kanë të drejtën e trajtimit të barabartë, pavarësisht nga gjinia. Megjithatë, këto ligje rrallë shkojnë përtej një deklarimi bazë për barazi. Realiteti *de facto* paraqitet më problematik për gratë. Ligjet ekzistuese rrallë vihen në zbatim apo bëhen të detyrueshme. Mbizotëron një mungesë besimi në aftësinë e sistemit të drejtësisë për të zgjidhur problemet që prekin gratë, si për shembull diskriminimi gjinor. Natyra patriarkale e shoqërisë shqiptare vazhdon të bëhet përcaktuese e rolit të grave në shoqëri. Ndonëse shfaqen në mjaft fusha, pabarazia mes burrave dhe grave është më e theksuar në politikë dhe në marrëdhëniet familjare. Për fat të keq shteti shqiptar ka marrë vetëm disa masa të pakta kundër diskriminimit apo pengesave të tjera që ndeshin gratë.

Përputhja *De Jure*

Ligjet e Shqipërisë përgjithësisht iu përmbahen kërkesave të CEDAW-t. Kushtetuta, së bashku me shtyllat kryesore të legjislacionit shqiptar, si Kodi Penal, Kodi Civil, Kodi i Punës dhe ai i Familjes janë miratuar pas ratifikimit të Konventës dhe instrumentave të tjerë ndërkombëtarë dhe europianë, kështu që pasqyrojnë pjesën më të madhe të parimeve të rëndësishme të të drejtave të njeriut, si barazia dhe mosdiskriminimi. Ligji për një Shoqëri Gjinore të Barabartë është më i fundit mes këtyre ligjeve dhe synon të garantojë jo vetëm barazi formale para ligjit, por edhe barazi të mundësive për burrat dhe gratë.

Këto ligje megjithatë, nuk shoqerohen nga proçedura dhe mekanizma të qarta, të tilla që t'i ndihmojnë qytetarët të mbrojnë të drejtat e tyre, ndërsa aktet nënligjore, të cilat bëjnë të mundur zbatimin në praktikë të këtyre ligjeve, ende mungojnë ose janë të paplota.

Veç kësaj, disa ligje duken qartë që kanë nevojë për rishikim dhe ndryshime, si për shembull Kodi Penal, Ligji për Shërbimin Shëndetësor dhe Ligji për Sigurimet Shoqërore, ndërkohë që Shqipërisë ende i mungon legjislacioni për dhunën në familje. Për t'iu përgjigjur drejt pjesëmarrjes së ulët të gruas në vendim-marrje, misionet diplomatike dhe përgjithësisht në postet drejtuese, kuotat ose sisteme te tjera te ngjashme mund të propozohen nga legjislacioni si masa të veçanta te përkohshme.

Përputhja *De Facto*

Gjatë vlerësimit *de facto,* shumica e të intervistuarve/ave përmendën që ndërsa meshkujt dhe femrat konsiderohen të barabartë para ligjit, në realitet, femrat diskriminohen në të gjitha fushat e jetës. Shumica e pjesëmarrësve/eve gjithashtu u shprehën se edhe në rastet kur barazia përpara ligjit ekziston teknikisht, mekanizmat për zbatim nuk ekzistojnë ose janë joefektive; informacioni për zbatimin e ligjeve mungon.

Stereotipet e roleve gjinore dhe natyra patriarkale e shoqërisë u identifikuan si pengesat kryesore për të arritur përputhjen *de facto* me CEDAW. Ekspertët përmendën që shumë femra dhe meshkuj nuk e njohin diskriminimin gjinor si të tillë, por në fakt e shohin atë thjesht si një "mënyrë jetese." Pabarazia është veçanërisht e dukshme në tre fusha: politikë (udhëheqje dhe vendim-bërje), ekonomi (punësim dhe gjenerim i të ardhurave), dhe marrëdhëniet në martesë dhe familje.

Në fushën politike, numri i grave të zgjedhura në pozita shtetërore ra në mënyrë të dukshme gjatë viteve 1990-të dhe ky numër vazhdon të mbetet i ulët.

Në fushën ekonomike, tranzicioni ka goditur veçanërisht seriozisht gratë përsa i përket punësimit. Gratë janë përjashtuar nga sektorë të ndryshëm të punës; kjo lidhet me atë se si femrat përkufizohen (kryesisht për t'u kujdesur për familjen), moshën e tyre, paragjykimet rreth aftësive të grave për të kryer detyra të shkallëve të ndryshme të vështirësisë, dhe mungesën e besimit që gratë mund të japin po aq rezultate sa dhe burrat nëse punësohen në nivele të larta. Gratë nuk kanë pushtet ekonomik. Pozicioni i tyre ekonomik ka patur një influencë negative në aftësinë e tyre për të marrë pjesë në sektorin e biznesit. Për shembull, gratë kanë vështirësi për të marrë kredi financiare, sepse ato zakonisht kanë në pronësi shumë kolateral të vogël, si për shembull prona. Për më tepër, Shqipëria nuk ka programe të veçanta huadhënieje ose asistencë trainuese për gratë që të inkurajojnë nismat e tyre të biznesit.

Së fundi, megjithëse meshkujt dhe femrat kanë të njëjtat të drejta dhe përgjegjësi ligjore gjatë martesës, çiftet priren të ndjekin rolet gjinore tradicionale. Nuk është e pazakontë për gratë që të kenë përgjegjësitë kryesore për administrimin e shtëpisë dhe për t'u kujdesur për fëmijët ndërsa punojnë me kohë të plotë.

Gratë ndeshen me probleme edhe në fusha të tjera. Dhuna ndaj grave është një problem serioz në Shqipëri. Shumë viktima vazhdojnë ta shohin dhunën në shtëpi si një çështje private dhe nuk kanë dëshirë të përfshijnë në të policinë. Komuniteti i OJF-ve ka luajtur një rol aktiv në luftën ndaj dhumës kundër grave dhe në adresimin e nevojave të grave të dhunuara. Për shembull, OJF-të adminstrojnë klinika ligjore, operojnë linja këshillimi, mbajnë strehëza për gratë e dhunuara dhe kanë propozuar legjislacion që ka për qëllim të luftojë dhunën në shtëpi. Për më tepër, megjithë vëmendjen e rritur, trafiku i femrave mbetet ende shqetësues.

Ndërsa ligji garanton shërbime falas të kujdesit shëndetësor për gjithe individët e siguruar, në realitet marrja e këtyre shërbimeve është shpesh e lidhur me pagesa ilegale nën dorë. Konceptualizuar në këtë mënyrë, shërbimet cilësore të kujdesit shëndetësor janë shpesh të paarritshme si nga femrat dhe meshkujt për shkak të paaftësisë së tyre për të përballuar financiarisht shërbime të tilla. Gjithashtu, mjediset e kujdesit shëndetësor në zonat rurale, kur këto ekzisojnë, janë në kushte shumë të këqija. Më gjerësisht, shumë ekspertë u shprehën se marrja e shumë përfitimeve nga qeveria, duke përfshirë ato që lidhen me shëndetin, është gjithashtu e pakënaqshme si për meshkujt dhe femrat.

Arsimi është një prioritet i vazhdueshëm në të gjithë Shqipërinë. Shkalla e lexim shkrimit për meshkujt dhe femrat mbi moshën 15 vjeç është e lartë si në zonat urbane dhe ato rurale. Më shumë se 50 përqind e studentëve në universite janë femra. Pjesa më e madhe e problemeve në lidhje me frekuentimin e shkollës dhe marrjen e një arsimimi cilësor janë të dukshme për nxënësit nën 15 vjeç. Vajzat në zonat rurale janë veçanërisht në rrezik për të lënë shkollën. Në të njëjtën kohë, sistemi arsimor duket se përforcon stereotipet e roleve gjinore në tekste mësimore dhe materiale të tjera, si dhe nëpërmjet qëndrimeve të mësuesve.

Në përfundim, përpjekjet e Shqipërisë për të përmirësuar statusin e grave kanë qenë modeste. Shqipëria nuk ka marrë masa të veçanta për të informuar qytetarët e saj për CEDAW ose të sigurojë zbatimin e saj. Shumë nga të intervistuarit/at shprehën dëshirën për të mësuar më shumë rreth CEDAW dhe për marrë trainime dhe informacion mbi të drejat e grave. Së fundmi, shumë prej tyre pranojnë se ndërsa komuniteti i OJF-ve, në të cilin femrat janë të përfaqësuara mirë, është i fortë dhe i aftë për të sjellë ndryshime pozitive, koordinimi i përpjekjeve për arritjen e këtyre ndryshimeve është i rëndësishëm.

HYRJE

Në periudhën e viteve 1945-1990, Shqipëria ishte një vend socialist i udhëhequr nga një parti e vetme, dhe sistemi i qeverisjes klasifikohej si diktaturë e proletariatit. Gjatë kësaj kohe, statusi ligjor i grave u përmirësua në shumë aspekte. Për shembull, Kushtetuta e vitit 1946 shpalli barazinë pavarësisht nga seksi, shprehimisht "gratë janë të barabarta me burrat në të gjitha aspektet e shtetit, jetës ekonomike dhe shoqëroro-politike." Besohet gjerësisht se, gjatë periudhës 1945-1990, gratë kishin shumë të drejta duke përfshirë të drejtën e votës dhe të drejtën për shërbime të kujdesit shëndetësor. E drejta për arsim dhe punësim të barabartë me burrat i lejoi gratë të studionin dhe punonin në "fusha tradicionale të meshkujve" si për shembull inxhinieri, mjekësi, e bujqësi. Koha e punës nuk diferenconte në bazë të përkatësisë gjinore. Megjithatë këto përpjekje për të zbatuar të drejtat e grave në fushën publike nuk u shoqëruan me të njëjtin intensitet në fushën private; gratë mbetën kujdestaret kryesore, shpesh duke mbajtur ngarkesën e dyfishtë për të qenë të suksesshme si në fushën publike dhe atë private.

Ashtu si në vende të tjera të Evropës Lindore, aplikimi i "terapisë së shokut" në ekonominë e re të tregut në Shqipëri në fillim të viteve 1990 pati pasojë për të gjithë popullsinë, por gratë u prekën më rëndë gjatë kësaj kohe. Papunësia në radhët e grave u rrit ndjeshëm, duke i bërë gratë të varura nga të ardhurat e anëtarëve meshkuj në familje; shumë shërbime shoqërore u ndërprenë. Ndryshimi u shoqërua me ringjalljen e pikëpamjeve tradicionale dhe paragjykimeve që e kthenin gruan në rolin e shtëpiakes. Në zonat rurale, situata e grave u përkeqësua. Pas privatizimit të tokës dhe ndërprerjes së financimeve nga shteti, gratë u mbingarkuan me punë. Burimet financiare shumë të kufizuara të familjeve rurale shqiptare i kanë detyruar këto familje të përdorin punën e gruas në vend të makinerive. Emigrimi i meshkujve ka shtuar ngarkesën e punëve për gratë, pasi këto duhet të kujdesen më shumë për shtëpinë, fëmijët dhe të moshuarit. Kështu, kufizimi i mundësive për t'u punësuar dhe/ose përballimi i pothuaj gjithë barrës së punës dhe kujdesit në familje i ka larguar gratë nga pjesëmarrja në jetën politike dhe shoqërore, dhe ka kufizuar marrjen e informacionit, gjetjen e mundësive dhe pjesëmarrjen në aktivitete të ndryshme.

Pak studime formale janë përqëndruar në gjetjen e të dhënave që tregojnë nëse gratë i gëzojnë të drejtat e tyre në Shqipëri. Të dhëna përtej statistikave të përgjithshme nga UNIFEM janë të rralla. Megjithatë, ato çojnë në konkluzionin se të drejtat e grave nuk janë zbatuar njehësisht. Ndërsa gratë kanë bërë hapa përpara në arsim, të dhënat në terren tregojnë se gratë, dhe veçanërisht ato në pjesën veriore dhe në shumë zona rurale të Shqipërisë, nuk lejohen ose nuk kanë mundësi të vazhdojnë të shkollohen përtej arsimit tetëvjeçar. Organizmat politike mund të përfshijnë të drejtat e grave në axhendën

apo programin e tyre, por pak bëhet për të inkurajuar pjesëmarrjen politike të grave dhe vendim-bërjen e e tyre në jetën publike.

Përkeqësimi i statusit të grave në Shqipëri ka sjellë krijimin e dhjetra organizatave jo-fitim-prurëse (OJF) të grave që janë marrë me çështje të ndryshme që shqetësojnë gratë sot. Në fakt, Indeksi i OJF-ve 2004 hartuar nga USAID raporton se shumica e OJF-ve në Shqipëri përqëndrohen në gratë dhe rininë. Pjesa më e madhe e punës për advokimin e të drejtave të grave është bërë nga këto organizata me mbështetjen financiare të donatorëve ndërkombëtarë. Kjo punë është përqëndruar kryesisht në shëndetin e gruas dhe në dhunën kundër gruas. Megjithatë, asnjë përpjekje sistematike nuk është bërë për të parë se çfarë ndodh në shumë fusha të jetës private dhe publike në të cilat gratë marrin pjesë. Megjithëse ka pak koordinim të përpjekjeve në sektorin e OJF-ve, qeveri të njëpasnjëshme shqiptare dhe legjislatura parlamentare kanë hartuar legjislacion që është i ndjeshëm ndaj vënies së përkatësisë gjinore në qendër të vëmendjes.

Ky raport, i kryer nga Nisma e të Drejtave Ligjore të Grave (NDLG), vlerëson përputhjen e Shqipërisë me Konventën për Eliminimin e të Gjitha Formave të Diskriminimit Kundër Grave.[1] CEDAW përbëhet nga 16 nene që artikulojnë përgjegjësitë e një shteti për të siguruar dhe promovuar të drejtat dhe barazinë e grave, pavarësisht nga kombësia, feja apo kultura. Këto nene adresojnë një gamë të gjerë çështjesh, përfshirë përfaqësimin politik, arsimin, kujdesin shëndetësor, të drejtat ekonomike, shqetësimet e grave në zonat rurale, punësimin dhe marrëdhëniet në familje. CEDAW shprehet që të gjitha palët shtetërore të Konventës duhet të adoptojnë masa për të eleminuar diskriminimin e grave. Shtetet janë gjithashtu të detyruara për të marrë masa të sigurta për të nxitur barazinë midis burrave dhe grave. CEDAW u bë i disponueshëm për t'u firmosur në 1979 dhe hyri në fuqi në 1981. Sot, 173 vende e kanë ratifikuar CEDAW, përfshirë dhe Shqipërinë në 11 maj 1994. Në 23 qershor, 2003 Shqipëria ratifikoi Protokollin Opsional të CEDAW. Në përputhje me këto dokumente, në 2003 Shqipëria dorëzoi raportin fillestar dhe të dytë periodik në Komitetin e CEDAW të Kombeve të Bashkuara. Shtojca 4 bën një përshkrim të listës së shqetësimeve dhe rekomandimeve të adresuara Shqipërisë pas dorëzimit të këtyre raporteve.

Për të bërë këtë vlerësim, u përdor Instrumeti Vlerësues i CEDAW, i përgatitur nga Nisma Ligjore e Evropës Qendrore dhe Euroaziatike e Shoqatës së Gjykatësve Amerikanë (CEELI). Ky instrument mund të aplikohet në çdo shtet në botë për të analizuar përputhjen e shtetit me CEDAW. Ky instrument përbëhet nga dy komponentë të rëndësishëm, përputhja *de jure* dhe *de facto* me të gjithë nenet e CEDAW. Analiza *de jure* shsqyrton shkallën deri në të cilën legjislacioni shqiptar përputhet me CEDAW. Vlerësimi *de facto* konsideron shkallën në të cilën gratë aktualisht i kanë këto të drejta dhe mbrojtjet e përcaktuara në CEDAW. "Fushat shqetësuese" që shoqërojnë çdo nen identifikojë çështje në të cilat përputhja e Shqipërisë me CEDAW është veçanërisht problematike.

Është shpresa e NDLG që ky dokument do të ndihmojë qeverinë shqiptare, organizatat jo-fitimprurëse, organizatat ndërkombëtare, dhe shtetasit në përpjekjet e tyre kolektive për të përmirësuar barazinë e grave dhe për të rritur mundësitë që gratë të kontribojnë plotësisht në shoqërinë shqiptare.

---

[1] Në anglisht Convention on the Elimination of All Forms of Discrimination Against Women (CEDAW). Meqenëse shkurtimi në anglisht ka hyrë gjerësisht në terminologjinë e diskutimeve dhe punës mbi përkatësinë gjinore në Shqipëri, gjatë gjithë teksit i referohemi si CEDAW ose Konventa.

METODOLOGJIA

Të dhënat për këtë raport u mblodhën kryesisht në Mars 2005, duke përdorur Instrumentin e Vlerësimit të CEDAW përgatitur nga CEELI në 2001. Instrumenti i Vlerësimit të CEDAW ka dy komponente kryesore: vlerësimin *de jure*, dhe analizën *de facto*s. Seksioni *de jure* vlerëson shkallën deri në të cilën ligjet e një shteti përputhen me CEDAW. Seksioni *de facto* shqyrton shkallën deri në të cilën gratë, në praktikë, gëzojnë të drejtat dhe mbrojtjet e garantuara nga CEDAW.

Vlerësimi *De Jure*. Për përgatitjen e pjesës *de jure* të vlerësimit të CEDAW-t u konsultuam me dy ekspertë juristë. Secilit prej tyre iu dha një tabelë e gatshme me rreth 70 pyetje që kishin të bënin me CEDAW-n, e cila ishte pjesë e Mekanizmit të Vlerësimit të CEDAW-t të përpunuar nga CEELI (Shih Shtojcën 5 për pyetjet). Ekspertëve juristë iu kërkua të vlerësonin me pikë pjesë të caktuara të legjislacionit shqiptar duke filluar nga 1 (Nuk përputhet) deri në 5 (Përputhet shkëlqyeshëm). Gjithashtu ekspertëve iu kërkua të argumentonin vlerësimin e tyre me pikë, në përputhje me pyetjet e tabelës. Për çdo nen të Konventës, me përjashtim të nenit 5 tabela përmban pyetje të caktuara. Përgjigjet e ekspertëve përmbanin shpjegime për përputhjen ose mospërputhjen e legjislacionit shqiptar me kërkesat e Konventës, disa rekomandime për hapat që duhen ndërmarrë për të siguruar përputhjen si dhe citime të dispozitave të analizuara nën këndvështrimin e CEDAW-t.

Të dy specialistët juristë u këshilluan të punonin në mënyrë të pavarur nga njëri-tjetri, me qëllim që të thithnim dy mendime të ndryshme juridike për problemet gjinore në vend. Në shumicën e rasteve, ekspertët paraqitën mendime të ngjashme lidhur me garancitë që ofron legjislacioni shqiptar, por kishte edhe raste kur mendimet e tyre ndryshonin nga njëri-tjetri, sidomos në vlerësimin me pikë të përputhjes së ligjeve shqiptare me kërkesa të caktuara të Konventës. Në raste të tilla raporti ka paraqitur vlerësimin me pikë që përmbante më shumë argumenta bindëse. Përgjithësisht komentet e ekspertëve plotësonin dhe nuk kundërshtonin njëri-tjetrin. Veç kësaj, bashkëautorja e këtij raporti, e cila vjen edhe vetë nga fusha e drejtësisë, ofronte njëkohësisht edhe një këndvështrim të tretë, i vlefshëm për të provuar vlefshmërinë e argumentimeve të dy të parëve, si dhe për të plotësuar me informacion dhe analizë raportin.

Analiza *De Facto*. Kjo pjesë e vlerësimit u bazua në një rishikim të kujdesshëm të literaturës ekzistuese mbi çështjet gjinore në Shqipëri dhe në intervista në terren. U zhvilluan pesë intervista në grup dhe mbi 48 intervista të detajuara individuale me përfaqësues të qeverisë qendrore dhe lokale si dhe OJF-të. Gjithashtu, u intervistuan profesionistë dhe individë që nuk janë të angazhuar në çështjet e zbatimit të të drejtave të grave. Pjesëmarrësit jetonin në zona urbane dhe rurale. Intervistat adresuan zbatimin e

CEDAW në Shqipëri, dhe më gjerësisht, statusin e grave në shoqërinë shqiptare. Diskutimet në grup dhe intervistat individuale zgjatën rreth 60 minuta secila. Ato u rregjistruan dhe më vonë u përmblodhën nga një ekip prej pesë anëtarësh të specializuar në kërkimin në shkencat shoqërore dhe që punojnë në OJF-të dhe qeverinë shqiptare. Raporti u referohet vëzhgimeve të bëra nga "profesionistë" dhe "të intervistuar", por nuk i atribon thënie specifike individëve të veçantë për të ruajtur fshehtësinë e atyre që u intervistuan. Gjithashtu, literatura e prodhuar në 15 vitet e fundit nga organizma ndërkombëtare përfshirë Kombet e Bashkuara, Organizatën Ndërkombëtare për Migrim (IOM) dhe Organizatën Ndërkombëtare të Punës (ILO), si dhe kërkues të pavarur shqiptarë dhe ndërkombëtarë shërbyen për të plotësuar të dhënat e marra nga terreni.

Pas përgatitjes së draftit të parë të raportit, komentet u morën nga katër specialistë të çështjeve gjinore. Këto komente u reflektuan në draftin e dytë. Ky i fundit u paraqit në një tryezë të rrumbullakët të aktivistëve dhe ekspertëve të çështjeve gjinore,[2] që luajtën rolin e kritikëve. Ky raport final i CEDAW është bazuar në komentet dhe/ose informacionin shtesë që u mor nga diskutimi në tryezën e rrumbullakët.

Ky raport u finalizua më 15 dhjetor 2005 dhe përmban të dhëna apo përshkruan situatën gjinore në vend deri në tetor 2005.

[2] Përfaqësues të organizatave të mëposhtme morën pjesë në tryezën e rrumbullakët dhe dhanë komente për draftin e raportit të CEDAW: USAID/Albania, Ministria e Kulturës, Rinisë, Sporteve dhe Turizmit, Parlamenti Shqiptar, Gjykata Kushtetuese e Shqipërisë, Shkolla e Magjistraturës, OSBE, UNICEF, Komiteti për Barazinë Gjinore, SNV Organizata për Zhvillim e Hollandës/, Rrjeti Grave për Mileniumin, PNUD, Fondacioni Kvinna Till Kvinna, Zyra për Mbrojtjen e Qytetarëve dhe Shoqata e Grave *Refleksione*.

Neni 1
Në këtë Konventë shprehja "diskriminimi i gruas" nënkupton çdo dallim, përjashtim ose kufizim në bazë gjinie që ka për pasojë ose për qëllim të dëmtojë ose zhvlerësojë njohjen, gëzimin ose ushtrimin nga gruaja, cilado qoftë gjendja e saj martesore, mbi bazën e barazisë së burrit dhe gruas, të të drejtave të njeriut dhe lirive themelore në fushat politike, ekonomike, shoqërore, kulturore e civile ose në çdo fushë tjetër.

Fushat Shqetësuese

- Përkufizimi i "diskrimimit" në legjislacionin e tanishëm shqiptar është i paplotë.
- Përkufizimi "diskriminim kundër grave" siç jepet në Nenin 1 të CEDAW nuk është pasqyruar në legjislacionin shqiptar.
- Ka mospërputhje të konsiderueshme midis konceptit të barazisë midis burrave dhe grave si përshkruhet në ligj dhe si zbatohet në jetë.
- Megjithëse Shqipëria ka ratifikuar CEDAW, kjo e fundit njihet pak ndër aktorë të ndryshëm.
- Koordinimi midis Qeverisë Shqiptare dhe OJF-ve për të informuar gratë për CEDAW dhe legjislacionin mbi të drejtat e grave në Shqipëri mbetet i dobët.

Përputhja *De Jure*

Përputhja e legjislacionit shqiptar me nenin 1 të Konventës është përgjithësisht e mirë.[3] Neni 122, paragrafi 1 i Kushtetutës shqiptare parashikon që konventat ndërkombëtare të ratifikuara nga RSH (përfshi pra edhe CEDAW-n) bëhen pjesë e sistemit të brendshëm ligjor dhe kanë përparësi mbi ligjet e vendit, ndërsa sipas paragrafit 2 konventat ndërkombëtare janë drejtpërdrejt të zbatueshme, përveç rastit kur për zbatimin e tyre nevojiten ligje shtesë.[4] Kushtetuta shpall parimin e barazisë para ligjit dhe ndalon diskriminimin por nuk jep një përkufizim të diskriminimit.

Gjithashtu, ligji "Për një Shoqëri Gjinore të Barabartë", i miratuar rishtazi[5] përmend shprehimisht diskriminimin mbi baza gjinore. Neni 2, paragrafi 2 i këtij ligji përkufizon "Shkeljen e të drejtave të barabarta të grave dhe burrave" ose "diskriminimin" si veprime aktive ose pasive që shprehin nënvlerësim, përbuzje dhe kufizim të të drejtave ose të privilegjeve për arsye të seksit të personit…" Ndërkohë që ky përkufizim është i paplotë, ai duhet të interpretohet i lidhur me përkufizimin e "shoqërisë gjinore të barabartë" siç jepet nga paragrafi 1 i te njejtit nen: "Shoqëri gjinore e barabartë" është ajo shoqëri ku burrat dhe gratë kanë mundësi të barabarta për të marrë pjesë në veprimtaritë e të gjitha fushave si partnerë të barabartë, të ndajnë bashkërisht përgjegjësitë dhe të gëzojnë të drejta politike, sociale, ekonomike dhe kulturore të barabarta." Deri në një farë mase, këto dy përkufizime të marra së bashku shprehin idenë e nenit 1 të CEDAW-t.

Kodi i Punës[6] përmban një përkufizim më të hollësishëm të diskriminimit në marrëdhëniet e punës. Seksi është një nga shkaqet e diskriminimit të numëruara nga përkufizimi i nenit 9, paragrafi 2: "Me diskriminim kuptohet çdo dallim, përjashtim ose parapëlqim që bazohet në racë, ngjyrë, seks, moshë, fe, bindje politike, origjinë

[3] Shih shpjegimin te seksioni i Metodologjisë për kriteret e përdorura për përcaktimin e shkallës së përputhjes.
[4] Kushtetuta e Republikës së Shqipërisë, miratuar me ligjin nr. 8417, datë 21 tetor 1998
[5] Ligji për një Shoqëri Gjinore të Barabartë, nr. 9198, datë 1 korrik 2004
[6] Kodi i Punës i RSH, miratuar me ligjin nr. 7961, datë 12 korrik 1995

kombëtare, origjinë shoqërore, lidhje familjare, të meta fizike ose mendore që cënon të drejtën e individit për të qenë i barabartë në punësim dhe trajtim..."

Përputhja *De Facto*

Të intervistuarit/at u pyetën nëse burrat dhe gratë gëzojnë të njëjtat të drejta, çfarë ata kuptonin me diskriminim kundër grave, dhe, nëse diskriminimi ekziston, ku është më i dukshëm. Të gjithë ranë dakord që ndërsa burrat dhe gratë ligjërisht i gëzojnë të gjithë të drejtat, në jetën e përditshme nuk ndodh e njëjta gjë. Pjesa më e madhe e ekspertëve ranë dakord që diskriminimi i grave është fakt i jetës; megjithatë, ata kishin përcaktime individuale të termit 'diskriminim'. Ky diskriminim ka elemente të ndryshme përfshirë mohimin e mundësive të barabarta; dhunën; mohimin e të drejtatve të grave në të gjitha nivelet shoqërore dhe institucionale, perceptimet, mënyra të menduari, dhe shprehje që u mohojnë të drejtat grave dhe i vënë ato në një pozicion inferioriteti dhe shfrytëzimi; mungesa e zgjedhjeve në jetë; nënvlerësimi i potencialit të tyre dhe kontrolli i burrave. Gratë diskriminohen në të gjitha fushat e jetës, po kjo ndjehet më shumë në politikë dhe në familje: gratë janë shumë pak të përfaqësuara në politikë dhe në pozicione udhëheqëse në administratë; ka një shpërndarje të pabarabartë të punëve brenda shtëpisë, ku gratë mbajnë peshën më të madhe të riprodhimit shoqëror.

Ndërsa zbatimi i dobët i të drejtave të grave dhe faktorë politikë, ekonomikë dhe social-kulturorë kanë mundësuar këtë diskriminim, një pjesë e burrave dhe grave të intervistuar përmendën që pjesë e fajit për vazhdimin e këtij diskriminimi mbetet me gratë si individë që vetë nuk i njohin të drejtat e tyre, nuk i kërkojnë dhe nuk i mbrojnë ato. Niveli i ndërgjegjësimit nga gratë në lidhje me këto të drejta mbetet i ulët, veçanërisht në zonat fshatare, dhe zbatimi i këtyre të drejtave është i lidhur me një kulturë heshtjeje dhe sjelljeje të përshtatshme sipas përkatësisë gjinore dhe roleve që i vendosin gratë kryesisht brenda shtëpisë dhe përgjegjëse të kujdesit për të moshuarit dhe fëmijët.

Ndërsa Qeveria Shqiptare është përfshirë në fushata ndërgjegjësimi për përmirësimin e statusit të grave të organizuara nga OJF-të, pjesëmarrësit/et përmendën se koordinimi i mirë midis punës së QSH dhe OJF-ve është i një rëndësie të veçantë.

Të pyetur nëse e njihnin CEDAW, vetëm meshkujt dhe femrat që janë të përfshirë drejtpërdrejt në nisma mbi zbatimin e të drejtave të grave raportuan se kishin informacion për Konventën. Midis këtyre, mendimi më i shpeshtë ishtë që teksti i Konventës përbën një instrument të mirë që lehtëson raportimin për statusin e grave në Shqipëri. Megjithatë, në përgjithësi, ka shumë pak familjaritet me ekzistencën e Konventës. Informacioni se si duhet të zbatohet Konventa mungon. Fushata që lehtësojnë proçesin e ndërgjegjësimit dhe familjaritetin me Konventën dhe dokumente të tjera të rëndësishme që përqëndrohen në të drejtat e grave u menduan si të nevojshme.

Neni 2
Shtetet Palë dënojnë diskriminimin e gruas në të gjitha format, pranojnë të ndjekin me të gjitha mjetet e përshtatshme dhe pa vonesë një politikë me pikësynim eliminimin e diskriminimit dhe per këtë marrin përsipër:
(a) Të përfshijnë në kushtetutat e tyre kombëtare ose në çdo dispozitë tjetër ligjore të përshtatshme, parimin e barazisë së burrit dhe te gruas, nëse kjo nuk është bërë deri tani, dhe të sigurojnë përmes legjislacionit apo me mjete të tjera të përshtatshme zbatimin praktik të këtij parimi;
(b) Të miratojnë masa legjislative dhe masa të tjera të përshtatshme, të shoqëruara edhe me sanksione po të jetë nevoja, për ndalimin e çdo diskriminimi të gruas;
(c) Të vendosin mbrojtjen gjyqësore të të drejtave të gruas mbi bazën e barazisë me burrin dhe të garantojnë, përmes gjykatave kombëtare kompetente dhe institucioneve të tjera publike, mbrojtjen efektive të gruas nga çdo veprim diskriminues;
(ç) Të mos ndërmarrin asnjë veprim ose praktikë diskriminuese ndaj gruas dhe të sigurojnë që autoritetet dhe institucionet publike t'i përmbahen këtij detyrimi;
(d) Të marrin të gjitha masat e përshtatshme për të eliminuar diskriminimin ndaj gruas, që ushtron një person, organizatë ose ndërmarrje e çfarëdoshme;
(e) Të marrin të gjitha masat e përshtatshme, përfshirë dispozita ligjore, për të ndryshuar ose anuluar çdo ligj, dispozitë rregulluese, zakon apo praktikë, që përbën diskriminim ndaj gruas;
(ë) Të anulojë të gjitha dispozitat penale që përmbajnë diskriminim ndaj gruas.

Fusha Shqetësuese

- Sfera e aplikimit të Ligjit të Barazisë Gjinore është e kufizuar vetëm në jetën publike. Diskriminimi me bazë gjinore në besimin fetar apo jetën private nuk mbulohen nga garanci ligjore.
- Është e nevojshme të hartohen aktet nënligjore dhe të ngrihen mekanizmat institucionalë për zbatimin e barazisë gjinore dhe eliminimin e diskriminimit me bazë gjinore.
- Zbatimi i sanksioneve kundër diskriminimit sipas Ligjit të Barazisë Gjinore është i vështirë pasi dispozita është e paqartë.
- Kodi Penal Shqiptar nuk përmban dispozita për dhunën në familje.
- Legjislacionit shqiptar i mungojnë mekanizmat dhe proçedurat e duhura për rastet e dhunës në familje.
- Nuk është bërë asnjë analizë gjinore mbi legjislacionin e tanishëm apo atë që po hartohet.
- Niveli i perceptimit në lidhje me ekzistencën e sanksioneve kundër pabarazisë gjinore është i ulët.
- Ekzistojnë pak instrumente që sigurojnë zbatimin e barazisë gjinore.
- Praktikat fetare dhe kulturore ndikojnë në diskriminimin e grave.
- Shteti shqiptar ende nuk ka botuar një përkthim zyrtar të tekstit të CEDAW-t.

Përputhja *De Jure*

Legjislacioni shqiptar përputhet mjaftueshëm me nenin 2 të Konventës. Parimi i barazisë mes burrave dhe grave, siç u përmend edhe në shpjegimet për nenin 1 më sipër, parashikohet në Kushtetutë, ashtu siç parashikohet edhe ndalimi i diskriminimit.[7] Po

[7] Neni 18 i Kushtetutës shpall: 1. Të gjithë janë të barabartë përpara ligjit; 2. Askush nuk mund të diskriminohet për shkaqe të tilla si gjinia, raca, feja… (etj.)

ashtu edhe Kodi i Familjes, kur jep përkufizimin e martesës deklaron barazinë morale dhe juridike të bashkëshortëve si një parim bazë të rëndësishëm.[8]

Ligji për Barazinë Gjinore e shpall barazinë e të drejtave jo ndër parimet por si qëllim: "Qëllimi i këtij ligji është që: (a) të sigurojë realizimin e të drejtave të barabarta të grave dhe burrave, të garantuar nga neni 18 i Kushtetutës...; (b) të përcaktojë masa për promovimin e mundësive të barabarta midis burrit dhe gruas për të eliminuar diskriminimin direkt ose indirekt, bazuar në gjininë, në jetën publike të vendit". Megjithatë, efektet e këtij ligji shtrihen vetëm në jetën publike dhe nuk gjejnë zbatim në besimet fetare dhe në jetën private të qytetarëve[9] Kështu që ligji shqiptar duhet të kishte përfshirë dispozita që luftojnë këtë formë diskriminimi edhe kur ai ndodh në sferën private apo atë fetare.

Neni 3 i Ligjit për Barazi Gjinore parashikon qartë detyra konkrete për qeverinë dhe administratën publike për zbatimin e të drejtave të barabarta për gratë dhe burrat. "...Këshilli i Ministrave dhe administrata publike... ...duhet; (a) të sigurojnë që të drejtat e barabarta të grave dhe burrave të jenë të garantuara me akte normative; ... (c) të krijojnë mekanizma institucionalë që sigurojnë mbështetje për programet e institucioneve publike dhe shoqërisë civile për të realizuar mundësi të barabarta për burrat dhe gratë." Shteti shqiptar nuk ka miratuar aktet nënligjore të nevojshme dhe as ka krijuar mekanizmat institucionalë për zbatimin e barazisë gjinore dhe eliminimin e diskriminimit gjinor.

Kodi Penal përmban sanksionet më të rënda për diskriminimin. Neni 253 thotë se dallimet mbi bazë origjine, seksi... të kryera nga ana e punonjësit shtetëror apo në shërbim publik, që konsiston në krijimin e privilegjeve të padrejta ose në refuzimin e një të drejte ose përfitimi që buron nga ligji, dënohet me gjobë ose me burgim gjer në pesë vjet.

Edhe Kodi i Punës përmban sanksione të tilla. Neni 9, paragrafi 1 ndalon çdo lloj diskriminimi në punësim dhe veprimtarinë profesionale, pa specifikuar punëdhënësin, i cili mund të jetë një institucion publik apo person privat. Diskriminimi mund të sjellë si pasojë sanksione me shuma deri në 50-fishin e pagës minimale mujore.

Po kështu edhe Ligji për Barazinë Gjinore e ndalon diskriminimin në marrëdhëniet e punës (publike dhe private), si dhe në fushën e arsimit e shkencës. Veç kësaj, për të mbështetur dhe përmirësuar pjesëmarrjen e balancuar të grave në vendim-marrje, i detyron edhe partitë politike dhe OJF-të ta zbatojne këtë ligj.[10] Neni 7 synon të sigurojë barazinë gjinore në fushën e sigurimeve shoqërore dhe mbështetjes sociale. Shkelja e dispozitave të Ligjit për Barazi Gjinore nga persona publikë apo privatë mund të sjellë si pasojë sanksione disiplinore, administrative, civile apo penale në bazë të nenit 15. Këto sanksione nuk përshkruhen shprehimisht në nenin 15, por ligji iu referohet dispozitave të Kodit të Punës, Kodit Civil, Kodit Penal dhe ligjit "Për Statusin e Nëpunësit Civil". Ky formulim është i paqartë, gjë që e bën të vështirë zbatimin e sanksioneve.[11] Në këtë rast është e paqartë se kur përgjegjësia do të jetë disiplinore dhe jo penale apo civile dhe si do

---

[8] Kodi i Familjes, miratuar me ligjin nr. 9062, datë 8 maj 2003, neni 1
[9] Ligji për një Shoqëri Gjinore të Barabartë nr. 9198, datë 1 korrik 2004, neni 1, paragrafi 2
[10] Ligji për një Shoqëri Gjinore të Barabartë nr. 9198, datë 1 korrik 2004, neni 10, paragrafi b
[11] Neni 15 i Ligjit për Barazinë Gjinore parashikon: "Shkelja e dispozitave të këtij ligji shoqërohet sipas rastit me përgjegjësi disiplinore, administrative, civile apo penale për fajtorin, në bazë të dispozitave të këtij ligji, të Kodit të Punës, Kodit Civil, Kodit Penal dhe Ligjit për Statusin e Nëpunësit Civil nr. 8579, datë 11 nëntor 1999".

të kontrollohet zbatimi, cili institucion do të përcaktojë përgjegjësine e shkelësve. I vetmi rast i qartë që përmendet në ligj është kur një nëpunës i administratës shtetërore shkel dispozitat e Ligjit për Barazinë Gjinore. Në këtë rast , eprori i tij më i lartë ose Inspektoriati Shtetëror i Punës mund të vendosë një gjobë prej 30 000 lekësh (afro 300 USD).

Kufizimi i zbatimit të Ligjit për Barazinë Gjinore vetëm në disa nga fushat që mbulon CEDAW si dhe mungesa e dispozitave në ligje të tjera që ndalojnë dhe vendosin sanksione për diskriminimin gjinor e lënë individin pa "armatime" ligjore me të cilat mund të çojë në gjykate rastet e diskriminimit. Përgjithësisht një qytetar në sistemin ligjor shqiptar kërkon vënien në vend të një të drejte ligjore sesa drejtpërdrejt të një të drejte kushtetuese, pra një të drejte që buron nga një ligj specifik, i nxjerrë në bazë dhe për zbatim të një dispozite të caktuar në Kushtetutë. Kështu, kërkuesi/paditësi kërkon nga gjykata një të drejtë, duke vënë në dukje edhe nenin konkret të një ligji të caktuar, ku e mbështet kërkesën e tij dhe jo një të drejtë të përgjithshme të parashikuar në Kushtetutë. Në rastin e Kodit të Punës për shembull ngritja e një padie të tillë do të ishte e lehtë pasi ky Kod përmban dispozita konkrete që ndalojnë diskriminimin dhe po kështu do të ishte edhe në rastin e Ligjit për Barazi Gjinore për fushat që ai mbulon shprehimisht, si arsimi, puna dhe shkenca. Në raste të tjera të diskriminimit mbi baza gjinore që nuk trajtohen nga Ligji për Barazinë Gjinore apo nga ligje të tjera, kërkuesi/paditësi potencialisht mund të mos ketë dispozita ligjore për të invokuar për mbështetjen e kërkesës së tij.

Neni 17 i Ligjit për Barazinë Gjinore abrogon tre Vendime të Këshillit të Ministrave[12] si dhe të gjitha aktet ligjore dhe nënligjore që vijnë në kundërshtim me të. Kjo shprehje e fundit lë vend dhe madje edhe ka nevojë për interpretim. Me këtë rast është e domosdoshme një analizë e hollësishme nga pikëpamja gjinore e legjislacionit ekzistues për të përcaktuar nëse ai është në përputhje me CEDAW-n apo edhe me Ligjin për Barazinë Gjinore dhe për të nxjerrë konkluzione për efektet e tij në praktikë mbi gratë dhe burrat. Parimisht, një analizë e tillë duhet të bëhet rutine, pra një proçedurë e zakonshme përpara propozimit të çdo ligji në Shqipëri. Përfshirja e perspektivës gjinore duhet të bëhet një koncept i njohur dhe i pranuar nga të gjithë hartuesit e ligjeve dhe politikave, me qëllim që legjislacioni i ardhshëm t'i nënshtrohet gjithmonë një analize nga këndvështrimi gjinor.

Legjislacioni shqiptar e trajton dhunën mbi baza gjinore, përfshi edhe dhunën në familje. Për herë të parë, neni 62 i Kodit të Familjes parashikon mundësinë që një bashkëshort të kërkojë nga gjykata largimin e bashkëshortit të dhunshëm nga banesa bashkëshortore për një kohëzgjatje deri në 3 vjet. Kjo dispozitë përdor një gjuhë neutrale nga pikëpamja gjinore, por studimet dhe vëzhgimet në Shqipëri tregojnë se gratë janë më të rrezikuarat nga kjo formë dhune, gjë që të çon në konkluzionin se kjo dispozitë synon të mbrojë kryesisht gratë. Mirëpo kjo dispozitë e vetme është e vështirë të zbatohet nga gjykatat pasi ka nevojë të shoqërohet me dispozita të tjera proçedurale. Kodi Penal shqiptar penalizon dhunën ndaj grave ose në mënyrë specifike ose nëpërmjet dispozitave më të përgjithshme. Dhuna ndaj gruas mbulohet nga disa seksione të Kodit siç tregohet nga tabela më poshtë:

---

[12] VKM nr. 415, datë 1 korrik 1998, nr. 59, datë 23 janar 2003 dhe nr. 127, datë 15 mars 2003. Këto vendime kishin ngritur dhe rregulluar Komitetin për Mundësi të Barabarta, institucionin shtetëror të ngarkuar me detyrën e çuarjes përpara të të drejtave të grave dhe nxitjes së barazisë gjinore. Pra, me hyrjen në fuqi të Ligjit për Barazinë Gjinore, Komiteti për Mundësi të Barabarta pushon së ekzistuari.

Tabela 1. Kodi Penal Shqiptar për Dhunën Ndaj Grave				
Seksionet e Kodeve	Vepra penale kundër lirisë së personit	Vepra penale kundër moralit dhe dinjitetit	Vepra penale kundër fëmijëve, martesës dhe familjes	Krime seksuale
Veprat penale	-Rrëmbimi -Trafikimi i femrave - Heqja e paligjshme e lirisë	Shfrytëzimi i prostitucionit	Shtrëngimi ose pengimi për të bashkëjetuar ose për të zgjidhur martesë	- Marrëdhënie seksuale me dhunë (të mitura ose të rritura) - Marrëdhënie seksuale me persona në gjini ose nën kujdestari

Ndonëse sipas nenit 50 kryerja e veprave penale kundër grave shtatzëna dhe duke përfituar nga marrëdhëniet familjare mes viktimës dhe dhunuesit, konsiderohen si rrethana rënduese, Kodi Penal nuk përmban dispozita të shprehura për dhunën në familje. Dhuna në familje mbulohet nga krime me natyrë më të përgjithshme, si vrasja, plagosja, rrahja, pa ndonjë dallim teorikisht nëse dhunuesi është një i panjohur apo pjesëtar familjeje. Megjithatë, duke patur parasysh përhapjen që ka marrë sot dhuna në familje legjislacioni penal shqiptar duhet të pësojë një sërë ndryshimesh, me qëllim që të penalizojë në mënyrë specifike këtë formë të dhunës për shkaqe gjinore. Sanksionet në këtë rast duhet të jenë më të rënda pasi dhuna në familje nuk prek vetëm viktimën por një rreth më të gjerë të pjesëtarëve të familjes dhe sidomos fëmijët që bëhen dëshmitarë të saj.

Përputhja *De Facto*

Shumica e pjesëmarrësve/eve njohën se ndërsa ligjërisht shumë të drejta i garantohen grave, në praktikë kjo është larg realitetit. Praktikat tradicionale në veçanti, pengojnë zbatimin e ligjeve që nxisin barazinë. Gjithashtu, diskriminimi kundër grave ndonjëherë ndodh mes vetë grave dhe nxitet nga veprime e tyre. Një pjesë e pjesëmarrësve/eve perceptuan se diskriminimi i fshehur është i pranishëm dhe nuk ka sanksione kundër pabarazisë.

(a) Integrimi i parimit të barazisë në Kushtetutë apo në legjislacion. Parimi i barazisë ekziston në Kushtetutë dhe në legjislacionin kombëtar. Megjithatë, në gjyqe nuk janë sjellë padi që sfidojnë dhurime të këtij parimi. CEDAW është pjesë e sistemit ligjor shqiptar, madje merr përparësi në rastet e ligjeve kombëtare konfliktuese. Në mënyrë informale, gjykatësit/et, juristët/et dhe prosekutorët/et, pa dallim përkatësie gjinore, kanë marrë informacion të detajuar mbi përmbajtjen e CEDAW dhe rëndësinë e tij në lidhje me legjislacionin shqiptar në trainime të ndryshme. Megjithatë, teksti i CEDAW nuk është përkthyer zyrtarisht dhe botuar në *Fletoren Zyrtare* të Republikës së Shqipërisë. Meqenëse botimi në *Gazetën Shqiptare* konfirmon hyrjen në fuqi të të gjitha ligjeve dhe dokumenteve zyrtare, sfida kryesore për punonjësit e ligjit mbetet t'i referohen Konventës dhe ta zbatojnë në praktikë.

(b) Legjislacioni që ndalon diskriminimin. Ndërsa ekzistojnë sanksione kundër diskriminimit në fushën e punësimit, nuk raportohet asnjë rast prosekutimi. Dhunimi i të drejtave të grave në vendin e punës, dhe mungesa e prosekutimit, sipas ligjit, janë të dukshme në sektorin shtetëror dhe privat. Mungesa e raportimit lidhet me faktin që gratë nuk i dinë të

drejtat e tyre në punë. Kontratat e punës nuk përpilohen në përputhje të plotë me ligjin. Kështu në sektorin privat rastet e punësimit pa kontratë janë dominuese, ndërsa në sektorin shtetëror shmangen rastet që lidhen me pengesat që hasen për të ecur në shkallët e karrierës dhe ngacmimi seksual.

(c) Mbrojtja ligjore e të drejtave të grave. Rritja e numrit të juristeve dhe të grave në forcat e policisë në të gjitha strukturat policore duke përfshirë dhe Ministrinë e Rendit Publik ka sjellë një mentalitet të ri në profesionin juridik dhe në forcat policore. Shërbimet ligjore janë të disponueshme për të gjitha gratë që prosekutohen për rastet penale. Në raste kur gratë në këto raste nuk kanë mundësi të përballojnë mbrojtjen nëpërmjet ndihmës juridike private, ato përfaqësohen profesionalisht falas nga juristë të dhënë nga shteti. Megjithatë, shërbimet e mbrojtjes ligjjore përdoren rrallë nga gratë. Kjo lidhet me nivelin e njohurive që shërbime të tilla ekzistojnë, mungesën e besimit që shërbimet falas të dhëna nga shteti janë cilësore, nivelin e angazhimit të grave në shoqëri, dhe marrëdhëniet që gratë kanë në familjet e tyre ku shpesh burrat perceptohen si ata që duhet të merren me ligjin. Pengesa të tjera lidhen me vetëvlerësimin e grave: gratë shqiptare flasin rrallë, sidomos për probleme që lidhen me familjen, dhe shpesh e lënë veten në dorë të atij që e quajnë fat. Gratë në rastet penale janë në minoritet. Në 2001, vetëm tre përqind e grave u dënuan në rastet penale. Shërbimet falas për gratë në rastet civile nuk janë të disponueshme.

(d) Eleminimi i diskriminimit në sferën publike. Për shkak të mungesës së gjykatës së familjes dhe gjykatës për të miturit, njohuritë mbi të drejtat në këto dy kategori mund të jenë të kufizuara. Financimit të kufizuar lidhet sesione trainimi sporadike mbi barazinë gjinore dhe zbatimin e ligjeve anti-diskriminuese për punonjësit civilë dhe profesionistët që zbatojnë ligjin. Duhen burime për të mbështetur përvojën e marrë nëpërmjet programeve të trainimit dhe arsimit.

(e) Eleminimi i diskriminimit në sferën private. Inspektoriati i Punës në Ministrinë e Punës, Çështjeve Sociale dhe Mundësive të Barabarta siguron që legjislacioni mbi kushtet e punës dhe sigurimin shëndetsor ndiqet edhe në sektorin privat. Sektori privat, megjithatë, është më pak i sistemuar në lidhje me proçedurat që sigurojnë përputhje me ligjet anti-diskriminuese. Marrja në punë i lihet kryesisht preferencave të punëdhënësit. Nuk janë marrë masa nga shteti për të eleminuar praktikat kulturore që kufizojnë mundësitë e grave për të përfituar punësim.

(f) dhe (g). Ligje dhe reforma diskriminuese. Nuk ka dhëna që shteti vetë të ketë ndërmarrë studime që vlerësojnë ekzistencën dhe efektet e ligjeve dhe praktikave diskriminuese. Modelet shoqërore dhe kulturore që ushqejnë stereotipet ishin fusha kryesore e shqetësimit për shumicën e pjesëmarrësve. Stereotipet kryesore ishin të besuarit se pozicionet udhëheqëse janë zakonisht për burrat, në politikë burrat duhet të udhëheqin, gratë duhet të nënshtrohen dhe të dëgjojnë burrat, gratë janë pjesë komplementuese e burrave, dhe gratë duhet të bëjnë të gjitha punët në shtëpi. Pjesëmarrësit/et besonin se praktikat fetare dhe kulturore, deri në një masë, influençojnë diskriminimin e grave. Përsa i përket fesë, pjesëmarrësit/et ishin të ndarë në dy kampe. Disa ishin të mendimit që feja luan një rol të rëndësishëm në krijimin e këtyre stereotipeve, sepse fe të caktuara i portretizojnë gratë si qenie sensuale dhe të paprekshme. Në emër të këtyre karakteristikave, gratë janë të mbyllura në "kullën e fildishtë" dhe si rrjedhojë të distancuara nga marrëdhëniet në jetën reale. Gratë shpesh trajtohen si individë që shërbejnë për të krijuar një mikro-mjedis dhe nuk shihen si qenie njerëzore shoqërore. Në këtë aspekt, feja pengon zhvillimin e grave. Pjesëmarrës/e të tjerë/a ishin të mendimit që feja rrallë prezanton shtypjen dhe diskriminimin e grave nga burrat.

Praktikat kulturore kanë ndikimin më të fortë në diskriminimin e vajzave dhe grave, sepse këto lidhen me edukimin e marrë në familje dhe mënyrën e rritjes së fëmijëve në Shqipëri. Nënat zakonisht i mësojnë vajzat e tyre të jenë të nënshtruara, dhe t'u binden burrin dhe familjes së tij, veçanërisht, në zonat rurale dhe të largëta të Shqipërisë. Gjithashtu, është e papërshtatshme që gratë të hyjnë në arenën publike si politika, sepse familja është më e rëndësishme. Stereotipi kryesor i transmetuar nëpërmjet këtyre praktikave është që gratë të punësohen në pozicione tradicionale për gratë si mësuese, punonjëse sociale, shërbime, sekretare; burrat duhet të jenë udhëheqës, sepse ata janë politikanë të lindur.

Neni 3
Shtetet Palë do të marrin të gjitha masat e përshtatshme, në të gjitha fushat, sidomos në ato politike, shoqërore, ekonomike dhe kulturore, përfshirë dispozita legjislative, për të siguruar zhvillimin e plotë dhe përparimin e grave me qëllim që t'u garantojnë atyre ushtrimin dhe gëzimin e të drejtave të njeriut dhe të lirive themelore mbi bazën e barazisë me burrat.

Fushat Shqetësuese

- Aktet nënligjore që përshkruajnë me hollësi përbërjen, strukturën dhe detyrat specifike të institucioneve që sigurojnë barazinë gjinore nuk është i disponueshëm.
- Mbështetja financiare për këto struktura nuk merret në konsideratë në aprovimin e ligjit të buxhetit vjetor.
- Mungojnë autoritetet/strukurat për përkatësinë gjinore në nivelin ministror me mandat ligjor integrimin e përkatësisë gjinore në të gjitha fushat (*gender mainstreaming)*.
- Mungon plani afatgjatë për zbatimin e nenit 3 të CEDAW-t

Përputhja *De Jure*

Përputhja e legjislacionit shqiptar me nenin 3 të Konventës mbi Eliminimin e të Gjitha Formave të Diskriminimit të Gruas mund të përshkruhet si e mjaftueshme. Përgjegjësia e shtetit për problemet gjinore është e shpërndarë në disa struktura qeveritare, në nivel kryeministri, ministri apo qarku. Ligji për Barazinë Gjinore krijon disa struktura të ngarkuara për të marrë masat e nevojshme dhe për të zbatuar ligjet kundër diskriminimit.

Së pari, Ligji për Barazi Gjinore krijon një këshill konsultativ: Komitetin Ndërministror, i cili i raporton Këshillit të Ministrave. Ky komitet ka për detyrë të vërë në jetë politikat shtetërore për barazinë gjinore, të përgatisë dhe nxisë programe si dhe të kontrollojë situatën e çështjeve gjinore në vend. Përshkrimi i funskioneve dhe përbërjes së tij konkrete iu është lënë akteve nënligjore.[13] Sipas nenit 12 të Ligjit për Barazi Gjinore, ku Komitet Ndërministror funksionon si organ mbikqyrës i Komitetit për Barazi Gjinore. Ky i fundit ka detyrat e mëposhtme ligjore:

a) i propozon Komitetit Ndërministror programe dhe plane veprimi për promovimin e barazisë gjinore
b) i raporton Komitetit Ndërministror për situatën e balancës gjinore në shoqërinë shqiptare
c) informon Komitetin Ndërministror për veprimtarinë e nëpunësve të barazisë gjinore në shkallë vendi
d) ofron trainime në fushën e barazisë gjinore
e) organizon mbledhjen e statistikave gjinore
f) përgatit programe dhe plane veprimi për arritjen e barazisë gjinore
g) drejton dhe monitoron zbatimin e programeve të miratuara nga Komiteti Ndërministror
h) ndërmerr fushata sensibilizimi për ndërgjegjësimin e shtetasve për një shoqëri të barabartë gjinore
i) bashkëpunon me përfaqësuesit e lëvizjes feministe si dhe me organizma ndërkombëtare

[13] Neni 13, paragrafi 2 i Ligjit për Barazi Gjinore thotë: "Përbërja, organizimi dhe funksionimi i këtij Komiteti do të përcaktohet në urdhrin që nxjerr Kryeministri"

Diagrama më poshtë përfaqëson strukturat e krijuara në nivelin qendror dhe lokal nga Ligji për Barazinë Gjinore:

Mekanizmi Shtetëror për Çështjet Gjinore



Deri në miratimin e Ligjit për Barazinë Gjinore, Komiteti për Mundësi të Barabarta, një strukturë që i parapriu krijimit të Komitetit për Barazi Gjinore, kishte pika fokale në çdo ministri. Ato siguronin transmetimin e të dhënave me bazë gjinore midis Komitetit dhe ministrisë përkatëse. Ligji i ri, megjithatë, kur iu referohet nëpunësve të barazisë gjinore, i përmend ata në kuadrin e nivelit lokal (të qarkut), jo në nivel ministror. Në qoftë se këto struktura (pikat fokale gjinore) kanë qenë efektive në të shkuarën, ose konsideroheshin të rëndësishme, do të kish qenë mirë që këto jo vetëm të përmendeshin në Ligjin e ri të Barazisë Gjinore, por edhe të përcaktohej statusi i tyre, detyrat dhe përgjegjësite, me qëllim që t'i konsolidonte ato.

Është me rëndësi të vëmë në dukje se neni 17 i Ligjit për Barazi Gjinore shfuqizon aktet nënligjore që krijonin Komitetin për Mundësi të Barabarta dhe që përshkruanin organizimin dhe funksionimin e tij. Këshilli i Ministrave duhet të kishte nxjerrë vendime të reja për krijimin e komitetit të ri pasues dhe të rregullonte organizimin dhe funksionimin e tij. Këto masa nënligjore duhet të ndërmerren sa më parë sepse Komiteti për Mundësi të Barabarta (tashmë i quajtur Komiteti për Barazi Gjinore) tani për tani nuk ka status *de jure*.

Një strukturë e dytë, Ministri i Punës dhe Çështjeve Sociale, është organi publik që ka përgjegjësinë për zbatimin e Ligjit për Barazi Gjinore në fushën e punës. Ministri drejton dhe kontrollon veprimtarinë e strukturave në varësi të tij/saj. Me qeverinë e re të krijuar

nga shtatori 2005, Ministri përfshin edhe Shanset e Barabarta në titullin e tij, që do të thotë se ministria do të përqendrohet edhe në çështjet e barazisë gjinore përveç punës dhe çështjeve sociale.[14]

Diagrama e mëposhtme përfaqëson organet që zbatojnë dhe mbikqyrin zbatimin e Ligjit për Barazinë Gjinore në fushën e punës dhe punësimit:

Zbatimi i Ligjit për Barazinë Gjinore në Ministrinë e Punës dhe Çështjeve Sociale



Organi i tretë që siguron zbatimin e ligjeve anti-diskriminuese është sistemi gjyqesor. Një person që pretendon se ka pësuar diskriminim në çfarëdo sfere të jetës mund t'i bëjë kërkesë gjykatës dhe të invokojë ose nene të veçanta të Konventës mbi Eliminimin e të Gjitha Formave të Diskriminimit të Gruas, të Kodit të Punës apo edhe të drejtën kushtetuese për barazi dhe mosdiskriminim.

Institucioni i Avokatit të Popullit është një krijesë e re në sistemin juridik dhe shtetëror shqiptar. Avokati i Popullit mund të kryejë hetime apo të hartojë raporte në bazë të ankesave nga qytetarët për veprime të ndërmarra nga organet publike, duke përfshirë këtu edhe diskriminimin për çfarëdo shkaku. Megjithatë Avokati i Popullit nuk ka ndonjë seksion të veçantë për çështjet gjinore.

Përputhja *De Facto*

Aktivitetet e makinës shtetëore. Kanë ndodhur ndryshime në luftën kundër diskriminimit, por këto nuk janë shumë të dukshme, të qëndrueshme dhe përfshijnë të gjithë rajonet gjeografike të Shqipërisë. Diskriminimi ndaj grave në Shqipëri mund të zvogëlohet ose të eleminohet nëpërmjet punës së shumë aktorëve. Qeveria Shqiptare (QSH) është aktore kryesore në këtë proçes. Pjesëmarrësit përmendën disa arritje, megjithëse me rezerva:

- QSH hartoi një draft platformë për të përmirësuar statusin e grave në Shqipëri për periudhën 2002- 2005. Kjo platformë i ka dhënë rëndësi të dukshme barazisë gjinore në qeverisje dhe vendim-bërje, ekonomi, shoqëri, shëndetësi dhe arsim. Gratë që

[14] Titulli i plotë i ri për kreun e këtij institucioni të rëndësishëm është Ministri i Punës, Çështjeve Sociale dhe Shanseve të Barabarta. Përshkrimi që i është bërë këtij institucioni më lart do të vazhdojë të ruajë emërtimin e mëparshëm : Ministri i Punës dhe Çështjeve Sociale, pasi ky është edhe përkufizimi që i jepet në Ligjin për Barazi Gjinore.

jetojnë në zonat rurale, që janë më shumë të diskriminuara dhe të paangazhuara në jetën shoqërore dhe politike të vendit, u është dhënë vëmendje e veçantë në këtë platformë.

- Ligji mbi Mundësitë e Barabarta i aprovuar në 2004 mund të përbëjë bazën për nisma që janë të ndjeshme ndaj përkatësisë gjinore.

- Ligji për Barazinë Gjinore ka për qëllim të adresojë diskriminimin e grave.

- Një vendim i QSH-së ka krijuar një program që inkurajon punësimin e grave që përfshihen në kategori të ndryshme: gratë në nevojë, prostitutat dhe gratë Rome. Këtë vit programi ka patur në qendër të vëmendjes veçanërisht komunitetet e margjinalizuara dhe diskriminuara (Shihni diskutimin *de facto* në Nenin 11).

Mekanizmi kryesor kombëtar për zbatimin e barazisë gjinore është Komiteti për Mundësi të Barabarta (KMB). KMB-ja është organizëm qendror që qeveriset nga QSH. KMB-ja mbështet institucionalisht promovimin interesave të grave, *inter alia*, zbatimin e politikave të qeverisë për çështjeve të grave dhe familjes, koordinimin dhe vlerësimin e programeve, hartimin e propozimeve për legjislacionin e ri dhe/apo amendamente për legjislacionin ekzistues për të drejtat e familjes dhe grave në përputhje me standartet ndërkombëtare dhe mbështet aktivitetet e OJF-ve në lidhje me gratë dhe familjen.

KMB ka kaluar nëpër disa ndryshime që kur u krijua në 1992 si Sektori i Gruas dhe Familjes në Ministrinë e Punës, Emigracionit dhe të ish-Persekutuarve Politikë. Në 1994 ai u shndërrua në Departamentin e Gruas dhe Familjes brenda të njëjtës ministri. Në 1996, ai u ndryshua në Sekretariatin e Shtetit pranë Ministrisë së Kulturës, Rinisë dhe Gruas, për t'u transformuar në 1997 në Departamentin e Gruas dhe familjes në Ministrinë e Punës, Çështjeve Sociale dhe Gruas. Në 1998 ky ishte Komiteti i Gruas dhe Familjes në Këshillin e Ministrave. Bazuar në këtë, në 2001 u krijua Këshilli Qendror për Mundësi të Barabarta. Komiteti për Mundësi të Barabarta është tani nën mbikqyrjen e Ministrit të Punës, Çështjeve Sociale dhe Mundësive të Barabarta. Kjo është një strukturë *de facto* pa bazë ligjore.

Struktura e KMB është si më poshtë:



Stafi i KMB-së është i mirëkualifikuar dhe përfshin ekspertë ligjor dhe të shkencave shoqërore. Në pesë vitet e shkuara, nëpërmjet fondeve të dhuruara nga PNUD, Soros Shoqëria e Hapur për Shqipërinë dhe Fondacioni Friedrich Ebert, KMB përgatiti Platformën për Veprim të Qeverisë Shqiptare, Strategjinë Kombëtare për Fëmijët dhe Raportin për CEDAW. KMB-ja ka zhvilluar gjithashtu sesione trainimi për të ngritur ndërgjegjësimin në stafin e qeverisë vendore dhe përfaqësuesve të OJF-ve, ka organizuar fushata mbarëkombëtare për të drejtat e grave, dhe sesione për përkatësinë gjinore përfshirë diskutimin e CEDAW, Platformën e Veprimit të QSH dhe legjislacionin shqiptar për mbrojtjen e grave.

Megjithë arritjet, kërkohet një rol më aktiv dhe angazhues nga QSH për përmirësimin e statusin të grave në Shqipëri. Nuk është e mjaftueshme të ndërtohen vetëm struktura të reja statutore. Është e rëndësishmë për proçesin e zbatimit të ligjit të mbështetet nga legjislacion dytësor që përshkruan në detaje përbërjen, strukturën dhe detyrat specifike të këtyre strukturave. Po aq e rëndësishme është mbështetja financiare për këto agjensi që duhet marrë parasysh në aprovimin e ligjit për buxhetin vjetor. Për shembull, fondi për KMB ka qenë i pamjaftueshëm dhe veprimtaria e tij është influencuar nga mbështetja financiare e kufizuar. Në nivelin e politikave, rekomandohet që në të ardhmen të hartohen politika specifike që integrojnë përkatësinë gjinore në çdo fushë të jetës dhe punës dhe kështu të krijojnë mekanizma të përshtatshëm dhe të nevojshëm për zbatimin e këtyre politikave.

Plan Afatgjatë. Asnjë plan afat-gjatë nuk është hartuar në lidhje me zbatimin e këtij neni. Ligji i Barazisë Gjinore dhe ky vlerësim mund të jenë një bazë e mirë që mund të inkurajojë strukturat qeveritare të përgatisin një plan afatgjatë për zbatimin e këtij neni të CEDAW.

Neni 4
1. Kur Shtetet Palë marrin masa të përkohshme të veçanta që synojnë përshpejtimin de facto të vendosjes së barazisë midis burrit dhe gruas, kjo nuk duhet të konsiderohet si diskriminim sipas përkufizimit të kësaj Konvente, por në asnjë mënyrë nuk duhet të ketë për pasojë ruajtjen e normave të pabarabarta apo të veçuara; këto masa duhen ndërprerë sapo të jenë arritur objektivat e barazisë së mundësive dhe trajtimit.
2. Marrja e masave të veçanta nga Shtetet Palë, përfshirë ato të parashikuara në këtë Konventë, që synojnë mbrojtjen e amësisë, nuk duhet të konsiderohet veprim diskriminues.

Fushat Shqetësuese

- Legjislacionit shqiptar përgjithesisht i mungojnë masat e veçanta të përkohshme, të tilla si kuotat, sistemi i zebrës, trajtim preferencial për gratë, etj. që synojnë përshpejtimin e arritjes së barazisë midis burrave dhe grave në të gjitha sferat e jetës.
- Ligji i Barazisë Gjinore prezanton konceptin e masave të veçanta të përkohshme, por pa specifikime të mëtejshme për ta bërë efektiv.
- Fushatat informuese për të kuptuar Ligjin e Barazisë Gjinore janë organizuar kryesisht nga OJF-të.

Përputhja *De Jure*

Ligji për Barazinë Gjinore futi për herë të parë konceptin e masave të veçanta të përkohshme në legjislacionin shqiptar. Neni 10, paragrafi (d) parashikon: "Për të rregulluar raportet gjinore në institucione, në proçesin e vendimmarrjes, gjatë proçedurës së përzgjedhjes së kandidatëve, me vlerësime të barabarta në testim e kualifikime dhe eksperienca të njëjta, përparësi duhet të ketë zgjedhja e një konkurrenti grua." Megjithatë, është e paqartë për çfarë proçesesh vendimmarrjeje dhe në cilat institucione (zyrat shtetërore, institucionet publike apo private apo të gjitha së bashku) gjen zbatim kjo normë. Veç kësaj, termi "proçedurë përzgjedhjeje" lë mjaft hapësirë për interpretim. Ligji duhet të saktësojë nëse trajtimi preferencial do të gjejë zbatim në proçesin e marrjes në punë të nëpunësve civile apo të punonjësve të tjerë, apo do të zbatohet edhe për ngritjet në detyrë, trainimet për vendin e punës apo edhe specializime të mëtejshme.
Potencialisht neni 10 i Ligjit për Barazi Gjinore nuk ka kufizime dhe mund të shtrihej, për shembull, edhe në proçeset e përzgjedhjes për proçedurat e prokurimit publik, për të favorizuar ato veprimtari tregtare që drejtohen nga gratë. Si parim legjislacionet e sistemeve si ai i Shqipërisë, janë përgjithësisht mjaft të sakta në formulime dhe e kufizojnë hapësirën e interpretimit apo keqinterpretimit nga ana e zbatuesve të ligjit. Që të mënjanohen shkelje apo kufizime të mundshme të të drejtave të grave, rekomandohet një formulim më i qartë i kësaj dispozite, një përshkrim më i hollësishëm i proçedurave dhe organeve përgjegjëse dhe në të njëjtën kohë, edhe sanksione efektive për moszbatimin e kësaj forme diskriminimi pozitiv.

Duke patur parasysh pjesëmarrjen tepër të ulët të grave shqiptare në proçeset e vendimmarrjes, si në sektorin publik, ashtu dhe në atë privat, masat e veçanta të përkohshme janë një kompensim i dëshirueshëm. Me këtë rast rekomandohet edhe përdorimi i skemave të tjera, si për shembull sistemi i kuotave.

Përputhja *De Facto*

Ndërsa Ligji i Barazisë Ligjore ka krijuar bazën e nevojshme për masa të veçanta të përkohshme që favorizojnë gratë, sidomos në punësim, një sfidë kryesore mbetet se si

perceptohen këto masa. Shumë diskutime për përkatësinë gjinore zakonisht referohen si "çështjet e grave", "problemet e grave", probleme që "duhet të zgjidhen nga vetë gratë". Perceptime të tilla krijojnë përshtypjen që shoqëria mund të ndërgjegjësohet kaq shumë për të adresuar nevojat e vajzave dhe grave saqë djemtë dhe burrat do të preken në mënyrë joproporcionale. Është e nevojshme që fushatat për ndërgjegjësimin në këtë fushë të përqëndrohen në atë se çfarë humbasin djemtë dhe burrat kur vajzat dhe gratë në familjet e tyre nuk integrohen në fushat e edukimit dhe punësimit.

Qeveria Shqiptare në mënyrë progresive ka inkurajuar punësimin e kategorive të veçanta të grave për t'i integruar në tregun e punës. Për shembull, strategjia shtetërore mbi Punësimin dhe Trainimin Profesional 2003-2008, që hyri në fuqi në Janar 2003, i kushtoi vëmendje të veçantë grave të papuna. Një vendim i Këshillit të Ministrave "për Programin e Promovimit të Punësimit për Gratë e Papunësuara të Rregjistruara", datë 18 shtator 2003, i jep prioritet të veçantë promovimit të punësimit të grave. Në 2004, një Urdhër i Ministrit të Punës dhe Çështjeve Sociale parashikoi një reduktim të konsiderueshëm të pagesës ose trainim profesional falas për disa kategori të veçanta, përfshirë këtu gratë në nevojë dhe gratë Rome. Ndërsa administrata mund të jetë e ndërgjegjshme për këto strategji të veçanta, vendime dhe masat, ka pak informacion se si zbatimi i këtyre do të monitorohet dhe nëse kategoritë e veçanta të grave që këto strategji, vendime dhe masa synojnë t'u shërbejnë janë të ndërgjegjshme që mundësi të tilla ekzistojnë.

Mungesa e transparencës në zbatimin e këtyre masave të përkohshme ka kontribuar në besim të reduktuar te gratë se këto masa mund të funksionojnë. Për shembull, masa që thotë se kandidatja ka prioritet për një vend të lirë pune në administratën publike nëse kandidatët dhe kandidatet marrin të njëjtat pikë në teste nuk zbatohet rigorozisht. Pjesëmarrësit/et besonin se kjo masë mund të shmanget nëpërmjet manipulimit të pikëve. Rekomandohet që në të tilla raste të ketë një komitet rishikues të balancuar nga ana gjinore.

Neni 5
Shtetet Palë marrin të gjitha masat e përshtatshme me synimin që:
(a) Të ndryshojnë skemat dhe modelet e sjelljes shoqërore dhe kulturore të burrit dhe gruas, në mënyrë që të arrijnë të zhdukin paraghykimet dhe praktikat zakonore, ose të çdo lloji tjetër, që mbështeten në idenë e inferioritetit ose të epërsisë së njërit apo tjetrit seks, apo në rolin stereotip të burrit dhe të gruas:
(b) Të sigurojnë që edukimi i familjes të përfshijë kuptimin e duhur të amësisë si një funksion shoqëror dhe njohjen e përgjegjësisë së përbashkët të burrit dhe të gruas në edukimin dhe zhvillimin e fëmijëve të tyre, duke bërë të qartë se interesi i fëmijëve është kushti parësor në të gjitha rastet.

Fushat shqetësuese

- Fushatat kombëtare informuese për të adresuar eleminimin e stereotipeve gjinore janë kryer kryesisht nga OJF-të.
- Media i ushqen stereotipet duke kriminalizuar ose mbivlerësuar seksualisht gratë.
- Gratë ende vazhdojnë të mbajnë peshën kryesore në familje, megjithëse ato mund të jenë të punësuara dhe jashtë shtëpisë.

Përputhja *De Facto*

(a) Fushata kombëtare informimi për të eleminuar stereotipet gjinore. QSH nuk ka organizuar fushata kombëtare informimi për të adresuar eleminimin e stereotipeve gjinore. Pjesa më e madhe e kësaj pune është ndërmarrë nga OJF-të që specializohen në çështjet gjinore. Sesione trainimi janë bërë pothuajse në të gjithë Shqipërinë dhe kanë synuar grupe të ndryshme grash dhe burrash të grupmoshave, niveleve arsimore dhe profesioneve të ndryshme. Megjithatë, kjo punë është e koordinuar dobët. Pjesëmarrësit/et përmendën që mungesa e koordinimit mund të ketë rezultuar në shpërdorim të burimeve.

Media. Gazetarët dhe reporterët vijnë nga një mjedis që është i mbushur me stereotipe që diskriminojnë gratë. Ata janë të prirur të reflektojnë këtë realitet. Për shembull, një pjesëmarrëse kujtoi një kronikë në Ditën Ndërkombëtare të gruas (8 marsin) që pasqyroi arritjet e mëdha të grave në arsimim, por nuk përmendi që në nivelin universitar, shumica e pozicioneve udhëheqëse në arsim ende mbahen nga burrat. Të tjera mënyra që media mund të ushqejë stereotipet është duke bërë raportim të pjesshëm ose duke i paraqitur gratë si objekte kënaqësie. Gratë mbivlerësohen seksualisht në reklama për linja komerciale telefonike për sjellje seksuale. Një studim që monitoroi se si media e shkruar përshkruante dhunën në familje në 2001-2002 arriti në përfundimin se media përforcon stereotipet gjinore të ndeshura në shoqërinë shqiptare duke etiketuar gratë, një përdorim jo profesional të fjalorit në përshkrimin e grave dhe të gjurmuarit e lajmit sensacional me shumë pak konsideratë për analizën e çështjeve(Gjermeni & Bregu, 2003).
Rekomandohet që profesionistët e medias të marrin pjesë në sesione trainimi në rritjen e ndërgjegjësimit në lidhje me atë s si gratë dhe shqetësimet e tyre duhet të prezantohen në media.

(b) Përgjegjësia e përbashkët e të dy prindërve në rritjen e fëmijëve. Shqipëria ka për të bërë një rrugë të gjatë në fushën e ndarjes së barabartë të përgjegjësive të prindërimit në rritjen e fëmijëve. Në fakt, shteti shqiptar ka bërë pak në këtë drejtim. Për shembull, legjislacioni shqiptar nuk lehtëson lejen e baballarëve kur lindin fëmijë. Mjediset e mëdha të punës që punësojnë shumë gra nuk kanë shërbime për fëmijët. Megjithatë, problemi kryesor qëndron me traditën –përgjegjësia për të rritur fëmijët nuk ndahen mes prindërve dhe

gratë mbajnë ende peshën kryesore, pavarësisht nga fakti që ato mund të jenë të punësuara jashtë shtëpisë. Stereotipet kalohen te brezi i ri nëpërmjet prindërimit, megjithëse ka ndryshime se si realizohet kjo, sidomos në grupet që kanë jetuar në Tiranë për një kohë të gjatë dhe emigrantëve që kanë lëvizur në periferitë e Tiranës së fundi. Për pjesëmarrësit/et, shteti nuk mund të jetë përgjegjës për edukimin e njerëzve, por mund të hartojë legjislacionin që ndihmon në këto drejtime. Shoqëria civile e ka bërë një gjë të tillë, d.m.th. edukimin, në 15 vjetët e fundit. Megjithatë nuk ka kërkime se sa kjo punë ka sjellë ndryshim në sjellje.

Neni 6
Shtetet Palë marrin të gjitha masat e duhura, përfshirë legjislacionin, për të zhdukur të gjitha format e trafikut të grave dhe shfrytëzimin e prostitucionit të grave.

Fushat shqetësuese

- Legjislacioni shqiptar e penalizon prostitucionin.
- Mbrojtja e dëshmitarëve nuk është shumë efektive
- Mungon bashkëpunimi për zbatimin e ligjeve.
- Janë bërë pak përpjekje në fushata mbarëkombëtare për rritjen e ndërgjegjësimit në lidhje me trafikun.
- Dhuna kundër prostitutave nuk raportohet. Nuk ka të dhëna për nivelin e dhunës.
- Nevojitet mbrojtja dhe/ose ndihma për viktimat dhe rehabilitimin e tyre.

Përputhja *De Jure*

Legjislacioni shqiptar përputhet mirë me nenin 6 të Konventës mbi Eliminimin e të Gjitha Formave të Diskriminimit të Gruas. Shfrytëzimi i prostitucionit mund të dënohet deri me 15 vjet heqje lirie.[15] Po ashtu, Kodi Penal i trajton si vepra penale edhe favorizimin e prostitucionit apo mbajtjen e lokaleve për prostitucion.[16] Megjithatë, Kodi Penal shqiptar është një ndër të paktët, në mos i vetmi në Europë që i ngarkon edhe prostitutat me përgjegjësi penale.[17] Nga këto dispozita nuk është e qartë nëse edhe *klienti* mban përgjegjësi penale. Dispozita për shfrytëzimin e prostitucionit mund të interpretohet gjerësisht që të përfshijë edhe klientët, por gjithsesi kjo mbetet çështje e zbatimit të ligjit në praktikë dhe çështje ndërgjegjësimi dhe bindjeje të brendshme të gjyqtarëve dhe prokurorëve.

Ndryshimet e fundit në legjislacionin penal e sollën atë më pranë standarteve ndërkombëtare. Dispozitat e reja në fushën e trafikimit[18] duke përfshirë trafikimin e

---

[15] Neni 114/a i Kodit Penal
[16] Përkatësisht nenet 114 dhe 115
[17] Neni 113 i Kodit Penal parashikon: "Ushtrimi i prostitucionit dënohet me gjobë ose me burgim gjer në tre vjet"
[18] Neni 2, i ligjit nr. 9188, datë 12 shkurt 2004 "Për disa shtesa dhe ndryshime në ligjin nr. 7895, datë 27 janar 1995, Kodi Penal i RSH jep përkufizimin e mëposhtëm për trafikimin e femrave: Rekrutimi, transportimi, transferimi, fshehja ose pritja e femrave nëpërmjet kërcënimit ose përdorimit të forcës apo formave të tjera të shtrëngimit, rrëmbimit, mashtrimit, shpërdorimit të detyrës ose përfitimit nga gjendja shoqërore, fizike a psikike ose dhënies apo marrjes së pagesave ose përfitimeve, për të marrë pëlqimin e një personi që kontrollon një person tjetër, me qëllim shfrytëzimin e prostitucionit të të tjerëve ose formave të tjera të shfrytëzimit seksual, të punës ose shërbimeve të detyruara, të skllavërimit ose formave të ngjashme me skllavërimin, të vënies në përdorim ose transplantimit të organeve, si dhe formave të tjera të shfrytëzimit, dënohen me burgim nga shtatë deri në pesëmbëdhjetë vjet dhe me gjobë nga tre milionë deri në gjashtë milionë lekë.
Organizimi, drejtimi dhe financimi i trafikimit të femrave dënohen me burgim nga dhjetë deri në pesëmbëdhjetë vjet dhe me gjobë nga pesë milionë deri në shtatë milionë lekë.
Kur kjo vepër kryhet në bashkëpunim ose më shumë se një herë, apo shoqërohet me keqtrajtimin dhe detyrimin me dhunë fizike a psikike ndaj të dëmtuarës, për të kryer veprime të ndryshme, ose sjell pasoja të rënda për shëndetin, dënohet me burgim jo më pak se pesëmbëdhjetë vjet dhe me gjobë nga gjashtë milionë deri në tetë milionë lekë.
Kur vepra ka sjellë si pasojë vdekjen e të dëmtuarës, dënohet me burgim jo më pak se njëzet vjet ose me burgim të përjetshëm, si dhe me gjobë nga shtatë milionë deri në dhjetë milionë lekë.

femrave, përdorin thuajse të njëjtat përkufizime si Protokolli shtesë për Trafikimin i Konventës së Kombeve të Bashkuara për Krimin e Organizuar Ndërkombëtar. Këto ndryshime, të shoqëruara edhe me ndryshime të tjera legjislative në lidhje me mbrojtjen e dëshmitarëve dhe të bashkëpunëtorëve të drejtësisë, futjen e teknikave të reja hetimore si dhe paketën ligjore anti-mafia, të gjitha së bashku synojnë të luftojnë të gjitha format e trafikimit të femrave.

Që nga fillimi i vitit 2004 Shqipëria ka një gjykatë me juridiksion të veçantë, Gjykatën e Krimeve të Rënda.[19] Ndryshimet proçedurale[20] që u bënë më vonë gjatë atij viti i drejtuan të gjitha rastet e trafikimit të personave në Gjykatën e Krimeve të Rënda dhe jo më në ato të juridiksionit të zakonshëm.

Përputhja *De Facto*

Trafiku i grave dhe vajzave. Shqipëria ka qenë proaktive në luftën kundër trafikut në këto vitet e fundit si pasojë e trysnisë së ushtruar nga organizma ndërkombëtare dhe OJF-të. Janë kryer fushata ndërgjegjësimi në nivele të ndryshme të shoqërisë. Shteti ka reaguar ndaj ndryshimeve të sugjeruara nëpërmjet instrumentave ndërkombëtare dhe tashmë ka një angazhim më të madh për të prosekutuar rastet e trafikut. Megjithatë, rastet e raportuara të trafikut mbeten të larta. Ngritja e sistemit të Gjykatës së Krimeve të Rënda me juridiksion të veçantë për rastet e trafikut dhe aktivitetet e tjera të krimit të organizuar e rrisin efektivitetin e përgjigjes së shtetit ndaj kësaj dukurie. Burimet nga Gjykata e Krimeve të Rënda tregojnë se numri i rasteve të trafikut të trajtuara nga kjo gjykatë në gjashtëmujorin e parë të 2005 është shumë më i lartë sesa numri i rasteve të njëjta të trajtuara nga gjykata me juridiksion normal në tre vitet para ngritjes së kësaj gjykate.

Zyra për Luftën kundër Trafikut

Në 2002 Zyra për Luftën kundër Trafikut mundësoi mbledhjen e të dhënave të vlefshme dhe të mjaftueshme për interceptimin dhe eleminimin e rrjeteve të medha të trafikut të qenieve njerëzore, gra dhe fëmijë. Kjo zyrë tani ka përvojë të konsiderueshme dhe stafi është i mirëkualifikuar nëpërmjet trainimeve të përshtatura sipas detyrave specifike. Disa nga vakumet e mëparshme ligjore tani janë mbushur dhe ne mund të marrim masat e duhura ligjore për të penalizuar kriminelët. Kjo përfshin prosekutimin dhe dënime të rënda afatgjata për individët e përfshirë në trafikim. Unë besoj se kjo ka influencuar pozitivisht uljen e rasteve të trafikut. Shumë raste kanë shkuar në gjykatë. Të tjera raste janë përfunduar dhe ata që u dënuan janë ende në burg. Policia dhe Gjykata e Krimeve të Rënda janë shumë të rrepta në rastet e trafikut. Kjo gjykatë dhe Grupi Special i Task Force i krijuar për këtë arsye ka bashkëpunuar plotësisht dhe rasteve të trafikut u jepet vëmendja e duhur dhe e veçantë.

Përfaqësues i Zyrës për Luftën kundër Trafikut

Mbrojtja dhe/ose ndihma për viktimat e trafikut ka qenë një tjetër fushë veprimi e qeverisë shqiptare për rehabilitimin e viktimave. Nëpërmjet një projekti të Ministrisë së Punës dhe Çështjeve Sociale dhe IOM, u ngrit një qendër rehabilitimi në Tiranë në 2003 dhe kjo qendër funksionon ende. Në lidhje me shërbimet ofruar viktimave të trafikut, u raportua se në nivelin policor, ka një njësi ose person të trainuar për të trajtuar një vajzë ose grua

---

Kur vepra penale kryhet nëpërmjet shfrytëzimit të funksionit shtetëror ose shërbimit publik, dënimi me burgim dhe gjoba shtohen me ¼ e dënimit të dhënë.

[19] Ligj nr. 9110, datë 27 korrik 2003 "Për organizimin dhe funksionimin e gjykatave të krimeve të rënda"

[20] Neni 4, ligj nr. 9276, datë 16 shtator 2004 "Për disa shtesa dhe ndryshime në ligjin nr. 7905, datë 21.3.2005, Kodi i Proçedurës Penale i Republikës së Shqipërisë, i ndryshuar"

që ka qenë viktimë e trafikut. Përfaqësuesi/sja nga zyra e prosekutorit duhet të jetë i/e pranishëm/shme në intervistimin e viktimës së trafikut.

Në nivelin e trainimeve, organizma të ndryshme me përgjegjësi për të adresuar dhe luftuar trafikun kanë bashkëpunuar me OJF-të për të marrë njohuri në nevojat psiko-sociale të viktimave të trafikut.

- Janë organizuar shkëmbime në nivelin profesional me organzimat indërkombëtare dhe trainime, trainimet e mëtejshme për të rritur nivelin profesional të individëve të angazhuar me luftën kundër trafikut janë të kufizuara për arsye financiare dhe logjistike. Përfshirja e psikologëve dhe punonjësve socialë në forcat policore ka lehtësuar proçesin.

- Programi mësimor në Shkollën e Policisë përfshin rregulloret për etikën profesionale dhe intervistimin, sidomos për shtresat e popullsisë në rrezik, si qeniet njerëzore të trafikuara dhe të shfrytëzuara. Megjithatë trainimi për të mbrojtur konfidencialitetin e viktimave është i domosdoshëm.

- Shkolla e Magjistraturës organizon sesione të vazhdueshme trainimi me gjykatësit/et dhe prosekutorët/et, duke theksuar veçanërisht vulnerabilitetin ndaj trafikut dhe mënyrën se si të trajtohen viktimat.

Me gjithë punën e bërë, ka ende shumë nevojë për të ngritur ndërgjegjësimin e profesionistëve ligjorë, dhe të shoqërisë në tërësi në lidhje me trafikun, me fokus të veçantë zbutjen e paragjykimeve kundrejt viktimave. Shumë punë në drejtimin e parandalimit duhet të bëhet nga institucionet e edukimit, duke filluar që nga parashkollorët.

Parandalimi: Rritja e ndërgjegjësimit për rrezikun e trafikut nuk është e njëtrajtshme. Në zonat rurale bëhet pak për të ngritur ndërgjegjësimin për këtë rrezik; informacioni parandalues shpesh shkëmbehet në nivel individual. Ekziston nevoja për përpjekje më formale. Midis forcave të policisë, puna e parandalimit është e ngarkuar me paragjykime dhe kjo është një tjetër fushë për ndërhyrje.

Shfrytëzimi i prostitucionit. Prostitucioni mbahet i fshehur në Shqipëri dhe është shumë i vështirë për t'u dalluar. Sfida mbetet se gratë zakonisht përbuzen nëse praktikojnë prostitucionin, megjithëse ato mund ta bëjnë këtë vetëm për arsye ekonomike.

Përfaqësuesit e gjykatave përmendën që përpara se të aprovohej ligji për viktimat e trafikut, këto gra konsideroheshin prostituta dhe trajtoheshin nëpërmjet legjislacionit që ndalonte/dënonte prostitucionin. Nëpërmjet përpjekjeve të OJF-ve dhe ndërgjegjësimit të gjykatësve/eve dhe juristëve/eve, rastet e viktimave të trafikut të trajtuara si prostituta ka rënë ndjeshëm.

Midis përfaqësuesve të forcave policore, u shpreh shqetësimi se policia duhet të identifikojë njerëzit që e mbajnë prostitucionin, jo vetëm të arrestojë viktimat. Dhuna

kundër grave që praktikojnë prostitucionin nuk raportohet në polici ose në institucione të përshtatshme. Besohet se meqenëse prostitucioni kriminalizohet, gratë janë të frikësuara për të raportuar probleme të tilla. Një përfaqësues i policisë komentoi që ligji i mbrojtjes së dëshmitarëve është shumë i ri dhe ka një numër problemesh juridike dhe financiare. Mbrojtja e dëshmitarëve kërkon bashkëpunimin nga vende të tjera. Që ky ligj të interpretohet në mënyrë korrekte është i nevojshëm bashkëpunimi për aprovimine akteve të tjera ligjore.

Neni 7
Shtetet Palë marrin të gjitha masat e duhura për të eliminuar diskriminimin e gruas në jetën politike dhe publike të vendit. Në mënyrë të veçantë i siguron, në kushtet e barazisë me burrat të drejtën që ajo:
(a) Të votojë në të gjitha zgjedhjet dhe në të gjitha referendumet publike, si dhe të zgjidhet në të gjitha organizmat publikisht të zgjedhura;
(b) Të marrë pjesë në përpunimin e politikës qeveritare dhe në zbatimin e saj; të punojë në poste publike dhe të kryejë të gjitha funksionet publike në të gjitha hallkat e qeverisjes;
(c) Të marrë pjesë në organizatat dhe shoqatat joqeveritare që merren me jetën publike dhe politike të vendit.

Fushat Shqetësuese

- Pjesëmarrja e ulët e grave në jetën politike ka rezultuar në përfaqësim të ulët të grave në strukturat e vendimmarrjes.
- Mungojnë kuotat ose sisteme të ngjashme që inkurajojnë pjesëmarrjen e grave në politikë ose në strukturat e vendimmarrjes.
- Megjithë përputhjen e mirë legjislative me këtë nen, ligjet rrallë përkthehen në programe konkrete dhe politika që sigurojnë pjesëmarrjen reale për gratë.
- Një mentalitet specifik gjinor që i sheh gratë si ofruese të kujdesit familjar dhe burrat si udhëheqës në politikë i bën gratë të tërhiqen nga pjesëmarrja në jetën politike.
- Duhet të bëhet kujdes për një drejtpeshim midis cilësisë dhe sasisë së kandidateve të angazhuara në politikë.

Përputhja *De Jure*

Si e drejta për të votuar ashtu edhe ajo për t'u zgjedhur iu garantohen qytetarëve shqiptarë nga Kushtetuta, pa dallim përsa i përket seksit të personit. [21] Kjo e drejtë garantohet si për zgjedhjet dhe për referendumet publike. Veç kësaj, Kodi Zgjedhor parashikon: "Çdo shtetas shqiptar, pa dallim race, etnie, gjinie ... ka të drejtën të zgjedhë dhe të zgjidhet, në përputhje me rregullat e vendosura nga ky Kod". [22] Më tej vazhdon: "Zgjedhësit e ushtrojnë lirisht të drejtën e tyre për të votuar, në përputhje me rregullat e përcaktuara në këtë Kod". [23] Për më tepër, RSH ka ratifikuar edhe një numër instrumentash të tjera ndërkombëtare që garantojnë të drejtat politike të grave, të tilla si Protokolli 1 i Konventës Europiane për të Drejtat e Njeriut..

Kushtetuta shqiptare përdor një gjuhë neutrale nga pikëpamja gjinore, duke i garantuar kujtdo të drejtën e organizimit, e cila përfshin krijimin ose bashkimin në organizata jo-fitimprurëse, parti politike dhe organizata të tjera në jetën politike dhe publike.[24] Një gjuhë e tillë përdoret edhe për funksione të tjera të rëndësishme, përfshi kreun e shtetit dhe ministrat. Neni 12 i Ligjit për Statusin e Nëpunësit Civil" parashikon: "Çdo shtetas shqiptar, me zotësi të plotë, për të vepruar dhe që përmbush kërkesat e ligjore lidhur me nivelin arsimor dhe ka kualifikimin profesional që kërkon vendi i punës, ka të drejtë të punësohet në shërbimin civil.[25]

---

[21] Kushtetuta e Republikës së Shqipërisë, ligj nr. 8417, datë 21 tetor 1998, neni 45
[22] Kodi Zgjedhor, ligj nr. 8609, datë 8 maj 2000, neni 3, paragrafi 2
[23] Kodi Zgjedhor, ligj nr. 8609, datë 8 maj 2000, neni 3, paragrafi 3
[24] Kushtetuta e Republikës së Shqipërisë, ligj nr. 8417, datë 21 tetor 1998, neni 46
[25] Ligji për Statusin e Nëpunësit Civil, nr. 8549, datë 11 nëntor 1999

Ligji për Barazinë Gjinore shkon një hap më përpara duke shfaqur konceptin e barazisë së mundësive, jo thjesht barazisë së të drejtave të burrave dhe grave për të marrë pjesë në funksione publike dhe proçesin e vendimmarrjes. Neni 10 i këtij ligji parashikon: "Barazia e mundësive midis burrit dhe gruas lidhur me pjesëmarrjen në proçesin e vendimmarrjes do të realizohet nëpërmjet:

a) krijimit të një shoqërie gjinore të barabartë, bazuar në sigurimin e mundësive të barabarta të burrave dhe grave, bashkërisht, si partnerë të barabartë në shoqëri, në hartimin dhe zbatimin e politikave shtetërore, qendrore dhe vendore dhe politikave të institucioneve private;
b) partitë politike dhe organizatat jofitimprurëse duhet të veprojnë duke respektuar këtë ligj, për të përmirësuar dhe përkrahur pjesëmarrjen e balancuar të burrave dhe grave në proçesin e menaxhimit dhe marrjes së vendimeve në jetën politike, legjislative dhe publike në përgjithësi;
c) drejtuesit e lartë të organeve shtetërore, që kanë të drejtën e propozimit të kandidaturave për funksione të rëndësishme shtetërore, duhet të krijojnë mundësi të barabarta për burrin dhe gruan;
ç) Departamenti i Administratës Publike dhe departamentet e personelit në institucionet e pavarura, në përputhje me Kushtetutën, me ligjin... ..., duhet të vendosin kritere të njëjta rekrutimi, vlerësimi e seleksionimi për gratë dhe burrat.
d) për të rregulluar raportet gjinore në institucione, në proçesin e vendimmarrjes, gjatë proçedurës së përzgjedhjes së kandidatëve, me vlerësime të barabarta në testim e kualifikime dhe eksperienca të njëjta, përparësi duhet të ketë zgjedhja e një konkurrenti grua, në raport me konkurrentin burrë.

Përputhja *De Facto*

Megjithë përputhjen e mirë legjislative me Nenin 7, pjesëmarrja e grave në jetën publike dhe politike si dhe në proçesin e vendim-bërjes mbetet e kufizuar. Ligjet ende nuk janë përkthyer në programe dhe politika konkrete për të siguruar pjesëmarrjen e vërtetë të grave. Një përqindje e përcaktuar e grave që marrin pjesë në organizmat ekzekutive ose legjislative mund të përfshihet si kërkesë ligjore.

(a) E drejta për të votuar. Midis përfaqësuesve të qeverisë, ideja mbizotëruese është që nuk ka tolerancë ndaj dhunimit të të drejtës së individit për të votuar. Megjithësë gratë përgjithësisht e ushtrojnë të drejtën e votës, të dhëna të marra nga përfaqësuese të OJF-ve tregojnë se në disa vende gratë mund të mos lejohen të hyjnë në kabinën e votimit nëse ato nuk shoqërohen nga burrat. Fatkeqësisht, këto raste nuk janë dokumentuar. Intervistat në grup gjithashtu treguan se ndërsa vota është e fshehtë, bëhet punë paraprake në shtëpi nga burrat që u thonë grave se për kë të votojnë. Disa pjesëmarrëse në këto intervista përmendën që, nga respekti për bashkëshortët, ato do të votonin për kandidatin/en që rekomandonte bashkëshorti. Intervistat flasin për një tendencë, sidomos e pranishme në komunitetet rurale: votimi është më shumë shprehje e proçesit të "konsensusit" në familje e imponuar nga burrat se sa ushtrimi i të drejtës së gruas për të shprehur opinionin e saj në fshehtësi.

Janë bëra pak përpjekje sistematike nga perspektiva gjinore për të rritur pjesëmarrjen e votuesve në zgjedhjen e kandidateve. Një pjesëmarrëse kujtoi që në 1994 pesë kandidate nga parti të ndryshme politike bënë takime me gratë dhe i prezantuan ato me programin

e tyre për gratë. Organizma ndërkombëtarë si PNUD kanë bërë përpjekje për të rritur ndërgjegjësimin lidhur me pjesëmarrjen e grave në politikë.

Në lidhje me kandidimin, të gjitha kandidatet mbështeten njësoj financiarisht pavarësisht nga përkatësia gjinore, sepse interesi i një partie politike është që të fitojë kandidatja e saj. Gjithashtu, në pak raste, OJF-të kanë ndihmuar duke bërë fushata për kandidate dhe duke ngritur fonde për to, por kjo është larg të qenit një përpjekje e rregullt e sistematike. Ekziston perceptimi se gratë që futen në politkë mund të shërbejnë si modele të pjesëmarrjes civile. Në fakt, partitë politike nuk kanë një preferencë të deklaruar që gratë nuk duhet të kandidojnë. Ka patur raste kur gratë janë ftuar të bëhen pjesë e një strukture të caktuar politike dhe nuk kanë pranuar të kandidojnë. Megjithatë, në shumicën e rasteve, partitë politike fajësojnë për humbjen e një kandidateje në zgjedhje elektoratin që nuk tregon preferencë për gratë.

Pjesëmarrësit/et përmendën disa faktorë që ndalojnë gratë nga pjesëmarrja në politikë dhe kandidimi:

1) Politika rrallë shihet si një fushë veprimi për gruan. Intervistat në grup reflektuan mentalitetin patriakal të shoqërisë shqiptare që percepton burrat duhet të zgjidhin gjithmonë problemet në politikë dhe gratë duhet të përfaqësohen nga burrat.
2) Militantizmi është një faktor vendimtar për pjesëmarrjen në politikë, dhe gratë shihen rrallë si militante.
3) Gratë që kandidojnë mund të bëhen subjekt i ngacmimeve dhe sulmeve kundër karakterit të tyre. Në kundërshtim nga sulmet mbi burrat që përqëndrohen në aftësitë e tyre profesionale dhe nëse ata kanë qenë pjesë e korrupsionit apo kompromiseve kur ishin të angazhuar në politikë, sulmet kundër grave zakonisht përqëndrohen në sjelljen e tyre morale dhe në shkallën deri në të cilën kryejnë rolin e tyre si nëna dhe gra.
4) Ndërsa rrallë ekzistojnë imazhe negative të grave që i hyjnë politikës në nivelet e larta, në nivelin e qyteteve të vogla dhe fshatrave, gratë hezitojnë të përfshihen në politikë. Në disa raste gratë vetë tregojnë pak besim për gratë që provojnë të hyjnë në politikë.

Edhe nëse gratë fitojnë në zgjedhje, ato janë një përqindje e papërfillshme në Parlament. Sistemi i kuotave dhe i "vendeve të përcaktura" në Parlament është një mekanizëm i nevojshëm për të krijuar mundësi për gratë dhe për të siguruar zhvillimin e plotë, efektiv dhe demokratik të shoqërisë. Një nismë e tillë duhet të studiohet me shumë kujdes, pasi përpjekje të mëparshme nga OSBE-ja për të prezantuar sistemin e kuotave dështuan.

(b) E drejta për të formuluar politikë dhe për të patur finksion shtetëror. Megjithëse legjislacioni thotë që gratë mund të marrin pjesë në të gjitha nivelet e hartimit të politikave, strategjive dhe programeve, në nivelin e zbatimit dhe vlerësimit ato zakonisht përjashtohen dhe/ose nuk u jepen përgjegjësi të plota. Pjesëmarrësit/et perceptuan se pushteti i grave në vendim-bërje është i kufizuar, dhe ato nuk lejohen të vendosin në shumë prej çështjeve që kanë të bëjnë me gratë. Duke qenë në minoritet, zakonisht, mendimet e tyre nuk merren në konsideratë. Modeli i "femrës politikane" nuk është krijuar ende.

Pjesëmarrësit/et vunë në dukje rëndësinë e përshirjes së grave në politikë. Së pari, mundësitë e barabarta për pjesëmarrje në politikë janë pjesë e të drejtave të njeriut. Vendet ku pjesëmarrja e grave është më e ulët nuk janë shumë demokratike. Së dyti, pjesëmarrja e barabartë në politikë mundëson që interesat e grave të reflektohen qartë në

të gjitha nivelet e vendim-bërjes. Megjithëse e vogël, pjesëmarrja e grave në të gjitha nivelet ka influencuar drejtpërdrejt aprovimin e ligjeve, hartimin dhe zbatimin nga e cila përfitojnë gratë, fëmijët dhe familjet. Së treti, pjesëmarrja e grave në struktura të vendim-bërjes përmirëson qeverisjen. Pjesëmarrja e grave në politikë është thelbësore në arritjen e Qëllimit të Tretë të Zhvillimit të Mileniumit (mbi barazinë gjinore) për shoqërinë shqiptare.

Megjithë interesin e grave për të marrë pjesë në politikë dhe vendim-bërje, përfaqësimi i tyre mbetet i ulët. Megjithëse u bënë përpjekje për të inkurajuar partitë politike të arrinin kuotat e 30 përqind të pjesëmarrjes së grave si deputete në parlament, në Parlamentin Shqiptar 2001 vetëm 6.4 përqind ishin gra. Në zgjedhjet vendore të 2003 vetëm katër përqind e qeverisë bashkiake dhe dy përqind e komunave u fituan nga gra; zgjedhjet e 2005-s sollën 7.1 përqind gra në Parlamenti. Pjesëmarrja e ulët e grave në politikë njihet si problem nga partitë politike dhe nga OJF-të. Por në varësi të kontekstit (nëse është urban apo rural), ndryshimet mund të duan kohë që të zbatohen.

(c) E drejta për të marrë pjesë në OJF-të dhe në jetën publike të vendit. Gratë janë gjerësisht të përfaqësuara në OJF-të që kryesisht japin shërbime sociale kategorive më vulnerabël të shoqërisë. Në fakt, OJF-të e grave janë grupi më i madh dhe më i vjetër në përvojë në shoqërinë civile në Shqipëri që daton fillimet e tij në fillimin e viteve 1990. Nga njëra anë, këto OJF kanë kontribuar disa përfaqësuese të fuqishme që janë thithur nga strukturat shtetërore. Shteti nga ana tjetër ka patur nevojë dhe ka kërkuar mbështetjen e këtyre OJF-ve pasi ato kanë specialiste të mira rekomandimet e të cilave kanë qenë të vlefshme në hartimin e legjislacionit shtetëror dhe politikave të favorshme për gratë. Tashmë ka rreth 100 OJF të rregjistruara grash. Raporti Kombëtar i Zhvillimit Njerëzor i Shqipërisë 2005 përmend të dhëna nga Qendra e Aleancës Gjinore për Zhvillim:

Fusha e veprimtarisë e OJF-ve	**Përqindje e OJF-ve**
Ligj	23%
Gratë, fëmijët dhe familjet	18%
Ekonomi	11%
Kulturë	10%
Informacion	9%
Këshillim dhe shërbime direkte	6%
Gratë fshatare	6%
Forume politike	4%
Vendim-bërja e grave, feja, arsimi, media, punësimi dhe anti-trafiku	2%

OJF-të shqiptare kanë luajtur një rol të dobishëm në ngritjen e pjesëmarrjes së grave në politikë. Megjithëse sporadike, disa OJF të grave kanë ndihmuar për ngritjen e fondeve për kandidatet politike dhe kanë inkurajuar pjesëmarrjen në votime dhe votimin e kandidateve. OJF-të kanë lobuar me organizmat ndërkombëtare dhe kanë tërhequr vëmendjen e tyre në përfaqësimin e grave në politikë.

Një nga sfidat kryesore të OJF-ve mbetet koordinimi i mirë i punës së tyre. Sfida tjetër e OJF-ve të grave është qëndrueshmëria financiare. Tërheqja e donatorëve nga Shqipëria ka kërcënuar ekzistencën e atyre OJF-ve që janë kryesisht të varura nga donatorët. Mund të sugjerohet që QSH të krijojë një fond për aktivitetet e OJF-ve në buxhetin vjetor në mënyrë të tillë që OJF-të të vazhdojnë të kontribojnë në demokratizimin e shoqërisë shqiptare.

Neni 8
Shtetet Palë marrin të gjitha masat e duhura me qëllim që gruaja, në kushtet e barazisë me burrin dhe pa asnjë diskriminim, të ketë mundësinë të përfaqësojë qeverinë e saj në arenën ndërkombëtare dhe të marrë pjesë në punimet e organizatave ndërkombëtare.

Fushat Shqetësuese

- Gratë kanë përfaqësim të ulët në nivelet ndërkombëtare.
- Gratë kanë përfaqësim të ulët në Trupin Diplomatik.

Përputhja *De Jure*

Të gjithë nënshtetasit, pa dallime mes burrave dhe grave, gëzojnë mundësinë për të përfaqësuar vendin e tyre në organizmat ndërkombëtare, në qoftë se plotësojnë kriteret për Shërbimin e Jashtëm.[26]

Përputhja *De Facto*

Raporti fillestar dhe i dytë periodik i Shqipërisë në lidhje me përputhjen e Shqipërsë me CEDAW (2002) përmend që numri i grave që punojnë në Shërbimin e Huaj është ngritur çdo vit. Megjithatë, përfaqësimi i grave në nivelin ndërkombëtar mbetet i ulët. Gratë përbëjnë vetëm rreth 16 përqind të përfaqësimit të Shqipërsë në Misionet Diplomatike të Shqipërisë (shih tabelën më poshtë për informacionin e detajuar riprodhuar nga Raporti Kombëtar i Zhvillimit Njerëzor, 2005).

Përqindja e Grave në Misionet Diplomatike – Janar 2002			
Pozicioni	**Totali**	**Femra**	**% Femra**
Ambasadore	43	2	4.6
Konsulle Ministre	4	1	25
Konsulle	15	2	13
Sekretare e Parë	36	6	16.7
Sekretare e Dytë	30	9	30
Sekretare e Tretë	7	1	14.3
Attaché	2	1	50

Nga organizma të ndryshme ndërkombëtare ku Shqipëria përfaqësohet, përfshirë NATO-n, Kombet e Bashkura dhe OSBE-në, vetëm misioni shqiptar në UNESCO udhëhiqet nga një grua. Nuk ka informacion të botuar në përqindjen e grave që kanë pozicione të larta në Ministrinë e Punëve të Jashtme. Shqipëria merr pjesë në nismat e mëposhtme: (1) Nisma e Adriatikut dhe Jonit (gjatë zona veprimi: lufta kundër krimit të organizuar, ekonomi-turizëm, dhe bashskëpunim midis ndërmarrjeve të vogla dhe të mesme, mbrojtje e mjedisit dhe zhvillim i qëndrueshëm, bashkëpunim transporti dhe lundrimi, bashkëpunim kulturor dhe ndër-universitar); (2) Nisma e Evropës Qendrore;

[26] Neni 27 i Ligjit për Shërbimin e Jashtëm, nr. 9095, datë 3 korrik 2003 parashikon që kushdo që përmbush kriteret e mëposhtme mund të punësohet në Shërbimin e Jashtëm: a) Ka nënshtetësinë shqiptare dhe banon në Shqipëri; b) gëzon zotësi të plotë për të vepruar; c) nuk ka qenë ndonjëherë i dënuar për vepra penale; d) nuk është pushuar nga ndonjë pozicion në administratën publike; e) gëzon shëndet të mirë; f) ka diplomë universitare shqiptare apo të huaj; dhe g) flet një gjuhë të huaj në përshtatje me vendin e punës

dhe (3) Këshilli i Evropës. Nuk ka informacion të botuar mbi përqindjen e grave që kanë detyra në organizata ndërkombëtare.

Dy rekomandime bazë vijnë nga kjo situatë. Së pari, për të siguruar një prezencë më të lartë të grave në pozicionet diplomatike, rekomandohet një kuotë e vendosur ligjërisht. Për shembull, Ligji për Shërbimin e Huaj mund të thotë që të paktën 30 përqind e grave të mbajnë misione diplomatik, ose të paktën 20 përqind e ambasadorëve të Shqipërisë në vende të tjera të jenë gra. Së dyti, si në fushat e tjera të aktivitetit, mungesa e studimeve dhe të dhënave kontribon në gjetje jopërfundimtare. Ndaj, duhen kërkime të mëtejshme që të mund të identifikohen faktorë aktualë apo kontribues që infuençojnë barazinë gjinore në këtë sektor, përfshirë ndërgjegjësimin brenda sistemit arsimor, menaxhimin e ministrisë (roli i nepotizmit dhe korrupsioni; informacioni i disponueshëm për mundësi punësimi në këtë sektor), dobësitë proçedurale në sistem që nuk arrijnë të monitorojnë/mbrojnë kundër praktikave diskriminuese dhe ngacmimeve.

Neni 9
1. Shtetet Palë i japin gruas të drejta të barabarta me ato të burrit në fushën e marrjes, ndërrimit dhe mbajtjes së shtetësisë. Në mënyrë të veçantë ata garantojnë që as martesa me një të huaj, as ndërrimi i shtetësisë së burrit gjatë martesës, nuk e ndërrojnë automatikisht shtetësinë e gruas, po ashtu nuk e bëjnë atë pa shtetësi dhe nuk e detyrojnë të marrë shtetësinë e burrit
2. Shtetet Palë i japin gruas të drejta të barabarta me ato të burrit përsa i përket shtetësisë së fëmijëve të tyre.

Fushat Shqetësuese

- Megjithëse gratë mund të pajisen me pasaporta dhe nuk kërkohet nga ligji që ato të paraqesin leje, ato zakonisht kërkojnë pëlqimin e bashkëshortit përpara se të udhëtojnë brenda ose jashtë vendit.

Përputhja *De Jure*

Nënshtetësia e grave. Legjislacioni shqiptar është në përputhje me nenin 9 të Konventës mbi Eliminimin e të Gjitha Formave të Diskriminimit të Gruas. Neni 19/2 i Kushtetutës parashikon: "Shtetasi shqiptar nuk mund ta humbasë shtetësinë, përveçse kur ai heq dorë prej saj." Ky formulim i vendos burrat dhe gratë në të njëjtin plan dhe kërkon vullnetin e shprehur të qytetarit për të hequr dorë nga shtetësia e tij. Kështu, martesa me një nënshtetas të huaj, nuk sjell automatikisht as humbjen dhe as fitimin e shtetësisë shqiptare. Ligji për Shtetësinë Shqiptare parashikon se i huaji që është i martuar me një shtetas shqiptar prej jo më pak se 3 vjetësh, *në rast se dëshiron*, mund të fitojë shtetësinë shqiptare me natyralizim". Po ashtu, zgjidhja e martesës nuk shkakton automatikisht humbjen, ndryshimin apo ri-fitimin e shtetësisë shqiptare." [27]

Shtetësia e fëmijëve. Ligji për Shtetësinë Shqiptare parashikon fitimin automatikisht të shtetësisë shqiptare nga ana e fëmijës që e ka të paktën njërin prind shqiptar, pa bërë dallim mes nënës dhe babait të fëmijës. Nëse njëri nga prinderit nderron me vone shtetesi, femija mund te ndryshoje shtetesi vetem nese te dy prinderit japin pelqimin.[28] Serish, ligji nuk ben dallim mes babait dhe nenes.

Përputhja *De Facto*

1. Të dreja të barabarta për të fituar, ndryshuar dhe mbajtur nënshtetësinë. Kombësia e femrave përcaktohet mbi të njëjtat kritere si ato për nënshtetësinë e meshkujve. Në pesëmbëdhjetë vitet e shkuara, ka patur një tendencë si për meshkujt dhe femrat të ndryshojnë nënshtetësinë shqiptare duke u martuar me nënshtetas jo-shqiparë.

Në praktikë, femrat mund të pajisen me pasaportë dhe atyre nuk u kërkohet ligjërisht të kenë një leje nga bashkëshorti apo kujdesari për të udhëtuar jashtë vendit. Megjithatë, pjesëmarrësit/et raportuan se ndryshe nga meshkujt, femrat zakonisht kërkojnë pëlqimin e bashkëshortit nëse kanë nevojë të udhëtojnë jashtë shtetit. Femrat në zonat rurale përmendën se gruaja duhet të ketë lejen dhe pëlqimin e bashkëshortit të saj (ose në mungesë të tij, të vjehrrit dhe vjehrrës) për të udhëtuar edhe brenda vendit (për shembull, për të vizituar familjen e saj të origjinës). (Shihni diskutimin në Nenin 14 në lidhje me lëvizjen e grave rurale).

[27] Ligji për Shtetësinë Shqiptare, nr. 8389, datë 5 gusht 1998
[28] Ligji për Shtetësinë Shqiptare, nr. 8389, datë 5 gusht 1998, neni 7

2. Femrat kanë të drejta të barabarta me meshkujt në lidhje me nënshtetësinë e fëmijëve të tyre. Siç theksohet në ligj, nuk u raportuan problem në lidhje me vendosjen e nënshtetësisë të fëmijës. Minorenët mund të udhëtojnë me pasaportën e secilit prind, por tani ata mund të kenë dhe pasaportën e tyre. Leja e të dy prindërve kërkohet për lëshimin e kësaj pasaporte.

Neni 10
Shtetet Palë marrin të gjitha masat e duhura për të eliminuar diskriminimin e gruas, me qëllim që asaj t'i sigurohen të drejta të barabarta me burrin në fushën e arsimit dhe, në mënyrë të veçantë, t'i sigurohen, mbi bazën e barazisë midis burrit dhe gruas:
(a)Të njëjtat kushte të kualifikimit profesional, të ndjekjes së shkollave dhe të marrjes së diplomave në institucionet shkollore të të gjitha kategorive, si në fshat, ashtu edhe në qytet. Kjo barazi duhet siguruar në arsimin parashkollor, të përgjithshëm, teknik profesional dhe teknik të lartë, si dhe në çdo institucion tjetër të përgatitjes profesionale;
(b) Të drejtën për të ndjekur të njëjtat programe, për t'iu nënshtruar të njëjtave provime, për të patur një personel mësimor me të njëjtin kualifikim, mjedise shkollore dhe pajisje të një cilësie të njëjtë;
(c) Eliminimin e çdo koncepti stereotip mbi rolin e burrit dhe të gruas në të gjitha nivelet dhe në të gjitha format e arsimit, duke nxitur arsimin mikst dhe tipe të tjera arsimimi që ndihmojnë për realizimin e këtij objektivi, duke rishikuar sidomos librat dhe programet shkollore dhe duke përshtatur metodat pedagogjike;
(ç) Të njëjtat mundësi në përfitimin e bursave dhe të ndihmave të tjera për studime;
(d) Të njëjtat mundësi për të ndjekur programet e shkollimit të pandërprerë, përfshirë programet e luftës kundër analfabetizmit për të rritur, në mënyrë të veçantë programet që synojnë ngushtimin e dallimit arsimor që ekziston midis burrit dhe gruas;
(e) Uljen e përqindjes së braktisjes së shkollave nga vajzat dhe organizimin e programeve për të reja dhe ato vajza që janë larguar nga shkollat para kohe;
(ë) Të njëjtat mundësi për të marrë pjesë në sportet dhe edukimin fizik;
(f) Të drejtën për të marrë informacione specifike të karakterit edukativ që synojnë mbarëvajtjen e shëndetit dhe mirëqeniën e familjeve, përfshirë informacionin dhe këshillimin për planifikim familjar.

Fushat Shqetësuese

- Tekset mësimore nuk janë rishikuar në lidhje me stereotipet gjinore.
- Arsimimi për të rritur ndodh vetëm në mënyrë sporadike.
- Zbatimi i rregulloreve që dekurajojnë lënien e shkollës nga vajzat dhe djemtë ka mangësi.
- Megjithë dispozitat jo diskriminuese në bazë të përkatësisë gjinore, sportet mbeten të dominuara nga meshkujt.
- Edukimit për shëndetin dhe planifikimin familjar nuk i kushtohet vëmendje e duhur në planin mësimor dhe stafi mësimdhënës është pak i kualifikuar për të dhënë mësim në këto fusha.

Përputhja *De Jure*

Neni 18 i Kushtetutës i garanton të drejtën për arsim kujtdo, pa dallim race a seksi. Neni 57 e zgjeron këtë të drejtë më tej: "1) Kushdo ka të drejtën për arsimim. 2) Arsimi shkollor i detyrueshëm caktohet me ligj. 3) Arsimi i mesëm i përgjithshëm publik është i hapur për të gjithë. 4) Arsimi i mesëm profesional dhe i lartë mund të kushtëzohet vetëm nga kritere aftësie. 5) Arsimi i detyrueshëm, si dhe arsimi i mesëm i përgjithshëm në shkollat publike është falas." Këto vlejnë si për sistemin me shkëputje, ashtu edhe për atë pa shkëputje nga puna. Gratë që janë martuar në moshë të re mund të përdorin sistemin pa shkëputje nga puna për të përfunduar arsimimin e tyre

Neni 8 i Ligjit për Barazi Gjinore i përcakton si diskriminuese ato veprime të institucioneve arsimore dhe shkencore që zbatojnë kritere të ndryshme për gratë dhe burrat në lidhje me pranimin në shkollë dhe programe studimi, në hartimin e kurrikulave dhe vlerësimin e njohurive.

Po ashtu diskriminuese do të quhen edhe ofrimi i mundësive jo të njëjta, të cilat ndikojnë në zgjedhjen e një fushe të caktuar studimi, trainimi, diplomimi apo ndikojnë në kohëzgjatjen e studimeve. Neni 9 i ligjit të sipërpërmendur trajton rastet e njoftimeve diskriminuese në fushën e arsimit.

Kuadri ligjor që rregullon të tre nivelet e arsimit, si dhe formimin profesional jo vetëm përdor gjuhë neutrale nga pikëpamja gjinore, me terma të tilla, si : "kushdo", "specialistë", "shkencëtarë"[29] "individë", etj., por në disa dispozita ndalon shprehimisht diskriminimin dhe nxit barazinë: "Ky ligj garanton të drejtën e shprehur në Kushtetutën e Republikës së Shqipërisë për arsim dhe formim profesional... ...duke krijuar shanse të barabarta për të gjithë"[30] Po kështu, neni 3 i Ligjit për Arsimin Parauniversitar [31] parashikon që shtetasit shqiptarë gëzojnë të drejta të barabarta për arsimin në të gjitha nivelet që mbulon ky ligj, pavarësisht nga kushtet e tyre sociale, kombësia, gjuha, seksi...". Gjithashtu ky ligj pengon lënien e shkollës për të gjithë nxënësit e arsimit të detyrueshëm, pa dallim seksi.[32]

Në disa raste legjislacioni shqiptar tregon kujdes të veçantë për arsimimin e grave. Për shembull, Kushtetuta shpall arsimimin e grave në vështirësi ekonomike apo sociale si një nga objektivat sociale të Shqipërisë. Kategoritë e personave që përfitojnë nga Ligji për Arsimin dhe Formimin Profesional përfshijnë vajzat-nëna të papuna, vajzat dhe gratë e trafikuara dhe gratë e divorcuara me probleme sociale.[33]

Ligji për Shëndetin Riprodhues parashikon të drejtën e çdokujt për informacion, këshillim, edukim dhe shërbimet sociale të nevojshme për një shëndet të mirë riprodhues dhe për ushtrimin e të drejtave dhe përgjegjësive të tyre seksuale dhe riprodhuese.[34] Ky ligj parashikon masa për parandalimin dhe trajtimin e sëmundjeve seksualisht të transmetueshme, planifikimin familjar dhe mënanjmin e shtatzënive të padëshiruara. Nenet 6 dhe 8 të këtij ligji synojnë të mbrojnë të drejtat seksuale dhe riprodhuese të grave.[35] Por me gjithë përputhjen e mirë *de jure* me CEDAW-n këto ligje duhet të gjejnë

---

[29] Neni 2, ligj nr. 8461, datë 25 shkurt 1999 "Për arsimin e lartë në RSH"
[30] Neni 1, par. 3, ligj nr. 8872, datë 29 mars 2002 "Për arsimin dhe formimin profesional në Republikën e Shqipërisë"
[31] Ligj nr. 7952, datë 21 qershor 1995 "Për arsimin parauniversitar"
[32] Neni 8 i ligjit nr. 7952, datë 21 qershor 1995 "Për arsimin parauniversitar" parashikon: "Në Republikën e Shqipërisë të gjithë fëmijët e moshës 6-vjeçare duhet të regjistrohen në shkollat e arsimit të detyrueshëm, i cili vazhdon për jo më pak se 8 vjet." Neni 24 vazhdon: "Të gjithë prindërit e fëmijëve të moshës shkollore duhet t'i dërgojnë fëmijët në institucione të arsimit të detyruar shkollor, publike apo private." Sipas nenit 59 të këtij ligji, kur nxënësit lënë shkollën, prindërit e tyre gjobiten për kundërvajtje administrative deri në 50 000 lekë (afërsisht 500USD)
[33] VKM nr. 616, datë 4 dhjetor 2002
[34] Ligji për Shëndetin Riprodhues, nr. 8876, datë 4 prill 2002, Neni 5
[35] Neni 6 i Ligjit për Shëndetin Riprodhues përcakton: "1. Çdo grua, e lirë dhe e përjashtuar nga çdo formë diskriminimi, detyrimi dhe dhune, ka të drejtë për t'u kontrolluar e për të vendosur lirisht për të gjitha çështjet që lidhen me seksualitetin e saj dhe shëndetin seksual e riprodhues. 2. Respektimi reciprok i marrëdhënieve të barabarta nga ana e grave dhe burrave gjatë lidhjeve seksuale dhe riprodhimit nënkupton respektin, moscënimin e integritetit të secilit, mirëkuptimin dhe ndarjen e përgjegjësive për sjelljet seksuale dhe pasojat e tyre."

më shumë zbatim në praktikë. Shteti duhet të sigurojë përcjelljen e informacionit tek qytetarët dhe të rrisë ndërgjegjësimin për të drejtat e tyre seksuale dhe riprodhuese.

Edhe ligji për shërbimin shëndetësor [36] garanton shërbim shëndetësor për cilindo, duke përfshirë edukimin shëndetësor, masat profilaktike, etj., por përgjithësisht dispozitat e këtij ligji kanë karakter deklarativ dhe me gjithë ndryshimet që ka pësuar më vonë, ky ligj mbetet i vjetër, i miratuar që më 1963.[37]

Legjislacioni shqiptar nuk përmban ndonjë dispozitë diskriminuese për shkak të gjinisë, në lidhje me pjesëmarrjen në sporte.

Përputhja *De Facto*

Eliminimi i diskriminimit dhe promovimi i barazisë në arsim. Ndërsa arsimi është një e drejtë e dhënë vajzave dhe djemve njësoj, shumica e pjesëmarrësve/eve përmendën se vajzat dhe gratë në Shqipëri janë të privilegjuara të kenë patur mundësi të arsimohen. Midis zyrtarëve qeveritarë, nuk ka vend për përmirësime, sepse në fushën e arsimit nuk ka diskriminim.

(a) Marrja e njëjtë e udhëzimeve për karierrë dhe profesione. E drejta për arsim është një nga fushat ku Shqipëria ka njohur sukses. Asnjë nxënësi apo nxënseje nuk i mohohet e drejta për arsim. Pjesëmarrësit/et raportuan se më shumë vajza se djem rregjistrohen në shkolla, pjesërisht sepse djemtë emigrojnë jashtë shtetit dhe kërkojnë mundësi për t'u punësuar në një moshë më të re. Megjithatë, indeksi i përgjithshëm i rregjistrimit jep një pamje tjetër.

INDEKSI I PËRGJITHSHËM I RREGJISTRIMIT DERI NË 2002 [38]		
Zona	**Meshkuj**	**Femra**
Bregdetare	0.669	0.615
Qendrore	0.677	0.594
Malore	0.628	0.573
Tirana	0.712	0.783
Totali	0.671	0.615

Siç tregon tabela, indeksi i përgjithshëm i rregjistrimeve (kombinon rregjistrimin fillor, të mesëm dhe të lartë) është më i lartë për djemtë se vajzat megjithë perceptimin e zakonshëm që më shumë vajza se djem rregjistrohen në shkolla. Në zonat fshatare dhe të largëta, vajzat mund të ndalohen të frekuentojnë shkollën e mesme (shihni diskutimin në pikën (e)). Për më tepër, trainimi profesional zakonisht përcaktohet në bazë të përkatësisë gjinore Nxënëset i kalojnë në numër nxënësit në shkencat fililogjike dhe shoqërore.

Neni 8/1 parashikon: "Ky ligj i garanton çdo individi vendimmarrjen për ushtrimin e te drejtave riprodhuese sipas dëshirës dhe interesit të tyre të lirë nga diskriminimi, detyrimi dhe dhuna."

[36] Neni 6, ligji nr. 7718, datë 3 qershor 1993 "Për disa ndryshime në ligjin nr. 3766, datë 17.12.1963 "Për shërbimin shëndetësor dhe ndihmën mjekësore të ofruar falas nga shteti"

[37] Për më shumë informacion lidhur me të drejtat dhe shëndetin riprodhues ju lutem referojuni analizës *de jure* mbështetur në nenin 12 të CEDAW-t.

[38] Të dhënat janë marrë nga Raporti Kombëtar i Zhvillimit Human të Shqipërisë 2005

(b) Akses te të njëtat programe shkollore, tekste mësimore, provime, kualifikime të mësuesve, trainime, mjedise dhe mjete mësimore. Pjesëmarrësit/et ranë dakord që si në zonat urbane dhe ato rurale vajzat përfitojnë nga të njëjtat plane mësimore, të njëjtat mjedise dhe mjete mësimore si dhe djemtë. Politika e vlerësimit të njohurive është e njëjtë për djemtë dhe vajzat. Megjithatë, nuk janë kryer studime që shohin preferencat apo qëndrimet e mësuesve/eve për t'u dhënë mësim nxënësve të të dy përkatësive gjinore.

Kualifikimet e mësuesve megjithatë ndryshojnë në zonat urbane dhe rurale. Shkollat në zonat urbane kanë staf të kualifikuar që kanë diploma universitare. Në shumë zona në verilindje të Shqipërisë (me rreth 70 perqind popullsi rurale), më shumë se 50 përqind e mësuesve janë të nënkualifikuar. Djemtë dhe vajzat preken njësoj në marrjen e dijes në këtë drejtim.

(c) Bashkëarsimimi, dhe eleminimi i stereotipeve gjinore në materiale.[39] Si pjesë e reformës në arsim, shumica e teksteve mësimore i janë nënshtruar një rishikimi për përmbajtjen dhe nivelin shkencor. Megjithatë, nuk është ndërmarrë asnjë nsimë për të rishikuar tekstet për stereotipet gjinore. Pjesa më e madhe e programeve mësimore dhe teksteve mësimore qëndrojnë në nivelin e moralizimeve; në to sugjerohet pak veprim për barazinë gjinore. Sipas një eksperteje, me mbështetjen e donatorëve të ndryshëm, Ministria e Arsimit dhe Shkencës ka bërë një analizë gjinore të programeve të aprovuara nga Ministria, po kjo ka mbetur vetëm në nivelin e evidentimit të situatës.[40] Ndërsa mësuesit/et formalisht nuk lejohen të diskriminojnë vajzat, kjo ndodh në praktikë. Për shembull, një mësues/e mund të nxisë barazinë gjinore me fjalë, por nëpërmjet veprimeve diskriminon në bazë të përkatësisë gjinore.

(d) Akses për bursa dhe grante të tjera për studime. Nuk ekzisojnë diskriminime në lidhje me akordimin e bursave. Kriteret për marrjen e bursave janë të njëjta për djemtë dhe vajzat. Në fakt, disa nga pjesëmarrësit/et perceptonin se vajzat përfitojnë më shumë nga bursat dhe grantet se djemtë, sepse vajzat kanë tendencë të qëndrojnë në shkollë për një kohë më të gjatë. Një pjesëmarrës përmendi që në zonat urbane, ndërsa prindërit presin që djemtë e tyre të punësohen, ato priren që t'i inkurajojnë vajzat të qëndrojnë në shkollë.

(e) Akses për vazhdimin e arsimit për të rriturit. Ministria e Punës dhe Çështjeve Sociale – jo Ministria e Arsimit dhe Shkencave – liçenson kurset për edukimin profesional. Intervistat me ekspertët treguan që arsimi për të rriturit lihet në kompetencë të qeverive lokale. Për shembull, një nga Drejtoritë Arsimore në zonën jugore të Shqipërisë raportuan që ndërsa nuk ka kurse, shkollat me kohë të pjesshme për të gjithë qytetarët që nuk kanë mbaruar shkollën janë të disponueshme. Këto shkolla zakonisht frekuentohen nga meshkujt, meqenëse më shumë femra tentojnë të vazhdojnë shkollën e mesme. Gjithashtu, për mendësinë e tanishme, nëse vajzat nuk arrijnë të mbarojnë shkollën e mesme, ato duhet të orientohen nga kujdesi për familjen dhe të rrisin fëmijë, dhe arsimi i mëtejshëm nuk është objektivi kryesor. Përpjekje sporadike janë ndërmarrë nga OJF-të për të trainuar të rriturit dhe sidomos gratë e margjinalizuara për t'i ndihmuar të integrohen në tregun e punës.

---

[39] Një nga rishikueset e draftit të mëparshëm sugjeroi që Ministria e Arsimit dhe Shkencës ka përfshirë një klasë për Çështjet Gjinore që të mësojë fëmijët që djemtë dhe vajzat janë të barabartë dhe kanë mundësi të barabarta në familje dhe në shoqëri që në lindje. Megjithatë autoret e raportit nuk kanë mundër të lokalizojnë këtë informacion

[40] Nuk është botuar asnjë rezultat.

(f) Reduktimi i braktisjes së shkollës nga femrat. Dukuria e braktisjen së shkollës është në ngritje midis djemve dhe vajzave, veçanërisht në zonat e largëta dhe rurale të Shqipërisë. Varfëria, problemet e infrastrukturës, mungesa e sigurisë (sidomos për vajzat) influençojnë braktisjen e shkollës në moshë të re. Ndërsa të dhënat nuk ndahen sipas përkatësisë gjinorë, rajoni i Kukësit (një nga më të varfërit në vend) raporton se mesatarisht shatë përqind e fëmijëve në moshën 7-14 vjeç kanë braktisur shkollën.[41] Zyrtarë dhe ekspertë besojnë se kjo është shifër është më e vogël se realiteti. Një tjetër dukuri shqetësuese është braktisja e fshehtë e shkollës, d.m.th., nxënësit/et kalojnë nga një klasë në tjetrën pa përfunduar detyrimet e klasës së mëparshme.

Pamje nga Shkodra

Për të mundësuar arsimin e vajzave të vendosura së fundmi në Shkodër, u arrit një marrëveshje me shkollën për aftësimin profesional që është e licencuar të për të dhënë edukim tetëvjeçar dhe të mesëm. Në bazë të ligjit, përtej një moshe të caktuar, vajzat dhe djemtë nuk mund të vazhdojnë me shkollën e mesme. Megjithatë, përderisa këto vajza kanë emigruar së fundi nga një zonë e largët ku nuk lejoheshin të arsimoheshin dhe janë vendosur në qytet, *"Refleksione"* lehtësoi rregjistrimin në shkollë pavarësisht se këto ishin mbi moshën e parashikuar nga ligji. Gratë në komunitetin Rom zakonisht nuk frekuentojnë shkollën e mesme, por nëpërmjet një bashkëpunimi me Drejtorinë Arsimore, *"Refleksione"* hapi një shkollë fillore në komunitetin Rom.

Intervistë me përfaqësuesen e Shoqatës së Grave "Refleksione"

Ndërsa Ministria e Arsimit dhe Shkencës i jep prioritet konsiderimit të dukurisë, nuk ekzistojnë politika dhe programe që dekurajojnë braktisjen e shkollës nga vajzat. Në shumë zona në Shqipëri ku ka patur emigracion të brendshëm të konsiderueshëm, popullsia nuk është rregjistruar ende dhe kjo ka kontribuar në nën vlerësimin e madhësisë së problemit. KMB-ja dhe UNICEF kanë krijuar një bankë të dhënash për të dokumentuar përmasat e kësaj dukurie dhe po punon me PNUD-in për të ndërtuar një strategji ndërhyrjeje. Kjo strategji do të përqëndrohet veçanërisht në vendosjen e politikave për trainimin dhe ngritjen e ndërgjegjësimit për grupet e margjinalizuara përfshirë këtu dhe komunitetet Rome.

(g) Pjesëmarrja në sporte dhe edukimin fizik në shkollë. Megjithëse legjislacioni shqiptar nuk përmban dispozita diskriminuese për sa i përket përkatësisë gjinor në lidhje me pjesëmarrjen në sporte, në praktikë kjo mbetet një fushë e dominuar nga meshkujt. Midis administratorëve të shkollave të intervistuar, u përmend shembulli një shkolle tetëvjeçare privare në të cilën ishte krijuar një skuadër futbolli për vajzat. Qeveria duhet të hartojë programe specifike që inkurajojnë përfshirjen e femrave në sporte.

(h) Arsimi shëndetësor dhe planifikimi familjar. Në dhjetë vitet e fundit, konceptet e arsimit shëndetësor dhe planifikimit familjar janë prezantuar në shkollat shtetërore,[42] megjithëse, këtyre nuk u kushtohet vëmendja e duhur në programin mësimor. Pjesëmarrësit/et raportuan se ndërsa ka një klasë të edukimit seksual të integruar në programin mësimor, tema të caktura janë të vështira për mësuesit/et, veçanërisht sepse të mësuarit për shëndetin seksual nuk inkurajohet si i tillë nga mentaliteti shqiptar. Në periferi si dhe në

[41] Ekspertë nga Ministria e Arsimit dhe Shkencës raportojnë që numri i vajzave që lënë shkollën është më i ulët se i djemve, por nuk jepen të dhëna.

[42] Një intervistuese nga një shkollë private tregoi se arsimi për shëndetin dhe planifikimin familjar nuk ishin pjesë e programit mësimor.

zonat rurale të Shqipërisë, të folurit për seksin është tabu. Gjithashtu, mësuesve/eve u duhet të përballen me një mendësi që përcakton jë nxënës/e si të formuar dhe të përgjegjshëm/me nëse ai/ajo njeh një gjuhë të huaj apo ka njohuri të mira kompjuterike. Kjo është ambicja kryesore e prindërve në ditët e sotme.

Ndërsa edukimi për shëndetin dhe planifikimin familjar është i ngarkuar me probleme, ekspertët besojnë që nuk ka pengesa ligjore për të trajtuar këto çështje të lidhura me shëndetin në shkolla. Megjithëse informacioni për planifikimin familjar jepet nëpërmjet punës së OJF-ve të ndryshme, në mendimin e ekspertëve arsimi për shëndetin dhe planifikimin familjar duhet të përfshihet si lëndë më vete në programin mësimor. Paralel me këtë është i nevojshëm trainimi i mësuesve/eve që japin lëndën e edukimit seksual.

Neni 11

1. Shtetet Palë duhet të marrin të gjitha masat e nevojshme për të eliminuar diskriminimin e gruas në fushën e punësimit, me qëllim që të sigurojnë, mbi bazën e barazisë së burrit dhe gruas, të njëjtat të drejta dhe konkretisht:

(a) Të drejtën për punë, si një e drejtë e pamohueshme e çdo njeriu;

(b) Të drejtën për të njëjtat mundësi punësimi, përfshire zbatimin e të njëjtave kritere të përzgjedhjes për punësim;

(c) Të drejtën për të zgjedhur lirisht profesionin dhe vendin e punës, të drejtën për t'u ngritur në përgjegjësi, për punë të qëndrueshme, për përfitimet dhe kushtet e shërbimeve, të drejtën për përgatitje profesionale dhe kualifikim, përfshirë mësimin e zanateve, përsosjen profesionale dhe kualifikimin e pandërprerë;

(ç) Të drejtën për pagë të barabartë, përfshirë shpërblimet, për trajtim të barabartë për punë me të njëjtën vlerë, si dhe për trajtim të barabartë lidhur me vlerësimin e cilësisë së punës;

(d) Të drejtën për sigurime shoqërore, veçanërisht në rastet e daljes në pension, të papunësisë, të sëmundjeve, të invaliditetit dhe pleqërisë ose për çdo humbje tjetër të aftësisë për punë, si dhe të drejtën për pushime të paguara;

(e) Të drejtën për mbrojtjen e shëndetit dhe për sigurimin në punë, përfshirë ruajtjen e funksionit të riprodhimit.

2. Për të parandaluar diskriminimin e gruas për shkak martese ose të amësisë dhe për të garantuar të drejtën e saj efektive për punë, Shtetet Palë zotohen të marrin masat e duhura që të kenë për efekt:

(a) Moslejimin e pushimit nga puna për shkaqe shtatzanie apo amësie, si dhe diskriminimin në raste të pushimit nga puna për shkak martese, duke parashikuar edhe sanksione;

(b) Vendosjen e dhënies së lejes së paguar të amësisë ose ndihmave sodciale të krahasueshme, duke ruajtur vendin e punës të mëparshëm, vjetërsinë dhe shpërblimet sociale;

(c) Inkurajimin e sistemit të shërbimeve sociale mbështetëse të nevojshme për t'u lejuar prindërve të gërshetojnë detyrimet familjare me përgjegjësitë profesionale, e njëherësh të marrin pjesë në jetën publike, sidomos duke favorizuar vendosjen dhe zhvillimin e një rrjeti çerdhesh e kopshtesh;

(ç) Sigurimin e një mbrojtjeje të veçantë për gratë shtatzëna kur provohet se puna që kryejnë është e dëmshme.

3. Ligjet që kanë të bëjnë me mbrojtjen e grave në fushat që përmenden në këtë nen do të rishikohen periodikisht në varësi të njohurive shkencore e teknike dhe sipas nevojave, do të rishikohen, anulohen ose zgjerohen.

Fushat Shqetësuese

- Ligjet që mbulojnë disa marrëdhënie specifike të punës dhe kategori specifike punonjësish nuk parashikojnë shprehimisht parimin 'pagesë të barabartë për punë me vlerë të barabartë'.
- Legjislacioni shqiptar nuk e njeh lejen e paslindjes për baballarët.
- Diferencimi në moshën e pensionit ul mundësitë e grave për ngjitje në karierrë dhe çon në një pagesë më të ulët pensioni, ç'ka rrit nivelet e varfërisë midis grave të moshuara.
- Legjislacioni mbrojtjes rishikohet vetëm në mënyrë sporadike.
- Mungojnë proçedura specifike ligjore për rastet e ngacmimit seksual.
- Mungojnë politika konkrete për integrimin e grave rurale që kanë emigruar në zonat urbane.

Përputhja *De Jure*

Legjislacioni shqiptar ndalon diskriminimin në fushën e punësimit, veprimtarisë profesionale dhe përfitimeve nga sigurimet shoqërore

Kushtetuta i garanton pa dallim kujtdo të drejtën e punës si dhe lirinë e zgjedhjes së profesionit, vendit të punës dhe arsimit profesional. Kodi i Punës[43] iu garanton të drejtën të gjithë personave, që sipas Kodit Civil gëzojnë zotësi të plotë për të vepruar, të drejtën për të lidhur kontratë pune.[44] Edhe Ligji për Barazi Gjinore detyron punëdhënësit publikë dhe privatë t'u ofrojnë të njëjtat mundësi dhe të zbatojnë të njëjtat kritere për punësimin e burrave dhe grave.

Kodi i Punës, i cili mbulon pjesën më të madhe të marrëdhënieve të punës, përmend shprehimisht në një dispozitë parimin "pagë e barabartë për punë me të njëjtën vlerë."[45] Megjithatë një numër ligjesh të tjera që mbulojnë disa marrëdhënie të veçanta pune dhe kategori punonjësish, si p.sh.: Ligji për Statusin e Nëpunësit Civil, Ligji për Organizimin e Pushtetit Gjyqësor në RSH dhe Ligji për Organizimin dhe Funksionimin e Prokurorisë në RSH, nuk e përmendin shprehimisht këtë parim. Sidoqoftë këto ligje përdorin një gjuhë neutrale përsa i përket gjinisë. Ligji për Barazinë Gjinore vendos si detyrim për punëdhënësit përdorimin e kritereve të njëjta për vlerësimin e punës së punonjësve meshkuj dhe femra si dhe detyrimin për t'u dhënë atyre të njëjtën pagesë për një punë me të njëjtën vlerë. Neni 115 i Kodit të Punës përmban të njëjtin parim.

Përsa i përket sigurimeve shoqërore dhe përfitimeve prej tyre, Kushtetuta i garanton *kujtdo* të drejtën e përfitimeve nga sigurimet shoqërore me mbushjen e moshës së pensionit ose në rast paaftësie për punë, ashtu siç garanton përfitimet në rast papunësie. Ligji për Sigurimet Shoqërore[46] ndjek të njëjtën linjë, ndonëse bën një dallim përsa i përket pagesës së kompensimit dhe përfitimeve nga sigurimet shoqërore për barrëlindje, ku përfshihen shtatzënia dhe periudha pas lindjes së fëmijës; këto gjejnë aplikim vetëm për gratë. Një tjetër dallim mes punonjëseve femra dhe meshkujve është leja e lindjes. Legjislacioni shqiptar nuk jep leje lindje për babanë, ndonëse njeh të drejtën e pushimit 3- ditor për baballarët e rinj. Ndërkohë pushimet e tjera dhe pushimet vjetore zbatohen njëlloj si për burrat dhe për gratë. Shembull tjetër i trajtimit të ndryshëm të burrave dhe grave është edhe neni 31 i Ligjit për Sigurimet Shoqërore, i cili përcakton se personat e siguruar kanë të drejtë të marrin pensionin e plotë të pleqërisë me mbushjen e moshës 65-vjeçare për burrat dhe 60 për gratë. Që të gëzojë pension të plotë, individi duhet të ketë paguar të paktën për 35 vjet kontribute në skemën e sigurimeve shoqërore.

Jo vetëm që legjislacioni i punës nuk i diskriminon gratë, por disa kategorive të grave, si p.sh. nënave me shumë fëmijë, u jepet prioritet në sferën e punësimit. Kushtetuta parashikon mbrojtjen e veçantë të shtetit për nënat e reja dhe gratë shtatzëna. Sipas Kodit të Punës shtatzënia nuk duhet të përbëjë shkak për diskriminim në fushën e punës. Kështu, për shembull, neni 105/a ndalon testet e shtatzënisë përpara marrjes së gruas në punë. Për më tepër, kur gruaja pushohet nga puna gjatë periudhës së shtatzënisë ose pas

---

[43] Kodi i Punës, ligj nr.7961, datë 12 korrik 1995, neni 20, paragrafi 1/a

[44] Kodi Civil nuk e lidh fitimin e zotësisë për të vepruar me shkaqe të tilla diskriminuese si seksi. Personi fiton zotësinë e plotë për të vepruar, me mbushjen e moshës 18-vjeçare. Për gratë kjo mund të ndodhë edhe më parë, në ato raste përjashtimore kur ato martohen para moshës ligjore për martesë (18 vjeç). Këto gra nuk e humbasin zotësinë për të vepruar as kur martesa e tyre mbaron para se ato të mbushin moshën madhore.

[45] Kodi i Punës, ligji nr.7961, datë 12 korrik 1995, neni 115

[46] Ligji për Sigurimet Shoqërore, nr. 7703, datë 11 maj 1993

kthimit nga leja e lindjes, barra e provës i mbetet punëdhënësit, për të bindur gjykatën se prishja e kontratës nuk ka ardhur si rezultat i shtatzënisë apo lindjes së fëmijëve.

Legjislacioni shqiptar ofron mbrojtje të posaçme për funksionin riprodhues të grave. Puna 35 ditë përpara dhe 42 ditë pas lindjes së fëmijës është absolutisht e ndaluar dhe kur gruaja ka në barrë më shumë se një fëmijë kjo periudhë është edhe më e gjatë. Pas kalimit të këtyre ditëve, punonjësja ka të drejtë të zgjedhë nëse dëshiron të kthehet në punë apo të vazhdojë të kujdeset për fëmijën e saj. Nëse ajo zgjedh të dytën, punëdhënësi është i detyruar t'ia ruajë vendin e punës për një periudhe 12-mujore. Leja i garantohet edhe nënave adoptive. Gjithashtu, Kodi i Punës i ndalon punëdhënësit vendosjen e punonjëses në kushte të vështira dhe të rrezikshme për shtatzëninë apo fëmijën e saj. Po kështu, turni i natës është i ndaluar për gratë shtatzëna. VKM nr. 207, datë 9 maj 2002 përcakton listën e punëve të vështira dhe të rrezikshme, ku vetëm punonjësit që paraqesin çertifikatë mjekësore se janë klinikisht shëndoshë mund të punësohen. Leja e lindjes llogaritet si vit pune për gruan dhe ajo nuk e humbet vjetërsinë në punë për shkak të shtatzënisë apo lindjes së fëmijës.

Diskriminimi për shkak të martesës nuk përmendet posaçërisht në legjislacionin shqiptar të punës. Sidoqoftë, neni 9 i Kodit të Punës e ndalon diskriminimin për shkak të lidhjeve familjare. Interpretimi i gjerë i këtij termi mund të përfshinte edhe gjendjen civile të punonjësit. Veç kësaj, punëdhënësi nuk mund të mbledhë informacione personale për punëmarrësin, përveçse kur këto lidhen me aftësinë profesionale ose janë të rëndësishme për ekzekutimin e kontratës. Për më tepër, neni 146 i Kodit të Punës, e kondideron të pajustifikueshme prishjen e kontratës së punës për motive që lidhen me shtatzëninë, gjendjen civile, detyrimet familjare, etj. Prishja e kontratës së punës pa shkaqe të arsyeshme është e pavlefshme dhe punëdhënësi i paguan punëmarrësit një dëmshpërblim të barabartë me pagën vjetore. Përsa i përket shpeshtësisë së rishikimit të legjislacionit mbrojtës për të pasqyruar kërkimet dhe konkluzionet më të fundit shkencore, mund të thuhet se legjislacioni shqiptar përputhet pak ose aspak me kërkesat e CEDAW-t. Rishikimi i kategorive të vendeve të punës që konsiderohen të rrezikshme për gratë, ndodh shumë rrallë, ose me iniciativën e ministrisë përkatëse, ose për shkak të trysnisë nga OJQ-të apo organizatat ndërkombëtare.

Legjislacioni shqiptar e trajton çështjen e ngacmimit seksual në mënyrë sporadike. Kodi i Punës ndalon shprehimisht çdo veprim nga ana e punëdhënësit që mund të konsiderohet ngacmim seksual i punonjësit dhe vendos mbi të parin detyrimin që punonjësi të jetë i mbrojtur edhe nga ngacmimi seksual nga ana e punonjësve të tjerë.[47] Ligji për Barazinë Gjinore detyron punëdhënësit të ndërmarrin masa disiplinore dhe masa të tjera organizative për të luftuar ngacmimin seksual ndaj punonjësve të tij.[48] Mirëpo për t'i bërë këto të drejta efektive, rekomandohet krijimi i mekanizmave proçedurale që i krijojnë mundësi viktimës së ngacmimit seksual të kërkojë mbrojtje gjyqësore, përfshirja në legjislacion e përkufizimit të ngacmimit seksual dhe ndoshta edhe transferimi i barrës së provës mbi punëdhënësin.

Përputhja *De Facto*

1. Eliminimi i diskriminimit në fushën e punësimit

(a) E drejta për punë. E drejta për punë garantohet për të gjithë shtetasit shqiptarë të moshës për punë.

---

[47] Neni 32, Kodi i Punës, ligji nr.7961, datë 12 korrik 1995

[48] Ligji për një Shoqëri Gjinore të Barabartë, nr. 9198, datë 1 korrik 2004, neni 6

(b) Mundësi të barabarta punësimi. Grave u garantohen mundësi të barabarta punësimi në Shqipëri. Kjo reflektohet në konkurrencën e hapur për pozicione në sektorin shtetëror apo privat. Megjithatë, në sektorin privat shumë varet nga preferencat e punëdhënësit. Kodi i rishikuar i Punës e ndalon diferencimin për zgjedhjen e punonjësve/eve në bazë të racës, moshës apo seksit. Profesionistët ligjorë përmendën se praktikat diskriminuese janë prosekutuar. Gjithashtu, Ligji për Shërbimin Civil rregullon punësimin në administratën civile dhe shtetërore duke shmangur punësimin nëpërmjet emërimit të drejtpërdrejtë. Konkursi, testimi, intervistimi, dhe kritere të zgjedhura me kujdes kanë rezultuar në marrjen në punë të një personeli të kualifikuar intelektualisht dhe profesionalisht pa diskriminimin gjinor. Megjithatë, kërkime tragojnë se femrat që arsimohen jashtë shtetit mund të diskriminohen për marrjen në punë. Një studim i femrave emigrante shqiptare në Shtetet e Bashkuara tregoi që gratë që kthehen në Shqipëri pas një periudhe studimesh jashtë vendit zhgënjehen shumë. Jo vetëm që ato mendohet të jenë shumë të kualifikuara për mjedisin e punës në Shqipëri, por punësimi i tyre lidhej me dhënien e favoreve seksuale për punëdhënësit (Orgocka, 2005).

Gratë që janë vendosur tani vonë në qytetet kryesore nëpërmjet emigrimit të brendshëm dhe gratë Rome kanë shumë mungesa aftësish dhe janë ndihmuar me anë të kurseve të trainimit për rrobaqepsi, dhe përpunimin e produkteve bujqësore. Një njësi në Shërbimin Shtetëror Shoqëror punon për të përmirësuar nivele e shkrim leximit për gratë dhe fëmijët Romë. Të mbështetura nga OJF-të këto gratë kanë mundur të integrohen në tregun e punës.

Megjithatë më shumë duhet bërë nga shteti në lidhje me integrimin e grave rurale që kanë emigruar së fundi në zonat urbane. Këto gra kanë vetëm arsim fillor dhe punojnë në kushte të vështira, kanë familje të mëdha me pesë ose gjashtë fëmijë të vegjël që kanë nevojë për kujdesin e prindërve. Transporti urban e bën më të vështirë problemin. Kështu shteti ka nevojë të ketë politika konkrete për integrimin në punë të kësaj kategorie grash.

Në kushtet e lulëzimit të ekonomisë joformale, shumë gra shqiptare kanë filluar të punojnë në shtëpi. Nuk dihet në çfarë kushtesh gratë ushtrojnë aftësitë e tyre. Ashtu si Finlanda, Irlanda dhe Hollanda, Shqipëria ka ratifikuar Konventën 177 të ILO-s për Punën në Shtëpi, e cila rekomandon politikë kombëtare në punën në shtëpi me qëllim që të përmirësojë kushtet e atyre që punojnë në shtëpi, shumica e të cilëve janë gra. (Chen, Vanek, Lund, & Heintz, 2005). Megjithatë, deri më sot nuk janë bërë fushata për hapat që duhen ndërmarrë për zbatimin e rekomandimeve të kësaj Konvente.

(c) Zgjedhje e lirë e punësimit; kritere të njëta për promovimin dhe përfitimet, përfshirë ritrainim. Sipas pjesëmarrësve/eve që punonin për Ministrinë e Punës, Çështjeve Sociale dhe Mundësive të Barabarta, shqiptarët kanë mundësi për të punuar dhe për patur të drejtat e tyre të respektuara. Drejtoria e Marrëdhënieve të Punës rregullon zgjidhjen e konfliktit dhe merr përsipër marrëveshjet me sektorin privat dhe sindikatat dhe kjo ka rezultuar në zgjidhjen e çështjeve konfliktuale për individët me paaftësi, individët që punojnë në miniera dhe pilotët. Intervistat treguan se avancimi në karierre është më i vështirë për gratë. Shembujt e përmendur përfshijnë fushën e juridikut, ku avancimi në karierrë i lihet Parlamentit, dhe për rrjedhojë politikës, dhe nuk bazohet në kritere që lidhen me profesionin. Edhe në sektorin e arsimit, mësuesit/et rekrutohen bazuar në proçedura të konkurimit që vlerësojnë aftësitë individuale profesionale, por kur vjen rasti për t'u bërë drejtorë shkolle, nuk organizohen proçedure konkursi. Rezultati përfundimtar është se ka më shumë drejtorë dhe më shumë mësuese.

(d) Pagesë e njëjtë për punë të njëjtë. Nuk është bërë nga shteti asnjë kërkim që studion vlerën e punës së papaguar.

(e) Sigurimet shoqërore dhe përfitime të tjera. Gratë përfitojnë njësoj si burrat nga të gjitha skemat e ndihmës shoqërore: sigurimi shoqëror, ndihma për papunësi, leja për sëmundje, leja vjetore, pagesa e paaftësisë (varet nga lloji i paaftësisë), pagesa e pensionit (për të njëjtin pozicion pagesa është e njëjtë për burrat dhe gratë; megjithatë, përderisa pagesa mund të varet nga shkalla e vështirësisë, kohëzgjatjes dhe kushteve të punës, kjo nuk mund të jetë e njëjtë).

(f) E drejta për mbrojtjen e shëndetit dhe sigurisë në kushtet e punës duke përfshirë sigurimin e funksionit të riprodhimit. Inspektoriati i Punës mbikqyr që legjislacioni të respektohet në lidhje me kushtet e punës, dhe sigurimit të shëndetit. Kodi i rishikuar i Punës ka përmirësuar mbrojtjen e punëtorëve, grave dhe sidomos gratë shtatëzëna. Kapitulli 10 i këtij Kodi veçanërisht mbron gratë shtatëzëna dhe ato që ushqejnë me gji dhe ndalon turnin e punës natën për gratë shtatëzëna.

Megjithatë, kërkimet tregojnë se gratë shtatëzëna i nënshtrohen kushteve të këqija të punës dhe presioneve shtesë të punës në familjet e tyre. Një studim i bërë gjatë viteve 1993-1994 me 1,199 gra shqiptare shtatëzëna tregoi që faktorë të caktuar pune drejtpërdrejt lidheshin me peshën e ulët të lindjes, dështimet dhe/ose vdekjet perinatale. Faktorët e rëndësishëm përfshinin: më pak ndihmë në familje, të ndenjurit në këmbë, të punuarit në mjedis të nxehtë, udhëtimet, të ecurit dhe të mbajturit dhe ngriturit e peshave të rënda në punë (Senturia, 1997).

Një dispozitë për ngacminin seksual në vendin e punës është e përfshirë në Kodin e Punës, por kjo nuk mund të zbatohet. Nuk ekzistojnë proçedura se si të niset një rast i ngacmimit seksual. Gjithashtu, mungesa e mundësive për punë dekurajon gratë të mos raportojnë rastet e ngacmimeve seksuale. Gratë janë shumë pak të ndërgjegjësuara që ligji i mbron ato në rast se ato raportojnë raste të tilla.

2. Parandalimi i diskriminimit mbi bazë të martesës apo mëmësisë. Megjithëse dispozitat ligjore ndalojnë diskriminimin mbi bazë të martesës ose mëmësisë, pjesëmarrësit/et përmendën që ato kishin lexuar në shtypin shqiptar për rastet kur punëdhënësit refuzonin të punësonin gratë shtatëzëna ose vinin kufizime për gratë në lidhje me lejen e lindjes.

(a) Ilegale të largosh për arsye të shtatëzanisë, lejes së lindjes apo ndryshimit në statusin martesor. Pjesëmarrësit/et përmendën Kodin e Punës që ndalon punëdhënësit që të kërkojnë gratë të bëjnë teste të shatëzanisë para punësimit, apo të ndërpresin kontratën e punës gjatë kohës kur gratë janë shtatëzëna dhe derisa kthehen nga leja e lindjes.

(b) E drejta për lejen e lindjes me pagesë dhe përfitime. Pjesëmarrësit/et treguan se gratë kanë të drejtën për lejen e lindjes me pagesë dhe përfitime. Legjislacioni mbi lejen e lindjes zbatohet mirë, d.m.th., gratë marrin lejen 35 ditë para lindjes dhe 42 ditë pas lindjes së bebes, të ndërgjegjshme që ato janë të ndaluara me ligj të punojnë gjatë kësaj kohe. Pas 42 ditësh, nëse ato zgjedhin, gratë mund të kthehen në punë. Megjithatë, nëse zgjedhin lejen për një kohë më të gjatë, vendi i tyre i punës është i garantuar.

(c) Masa mbështetëse sociale për të ndihmuar prindërit të ndajnë detyrimet në familje dhe punë. Shërbimet shtetërore për shërbimet për kujdesin e fëmijëve mungojnë në shumë zona urbane dhe rurale. Mund të ekzistojnë nisma private për kujdesin e fëmijëve, por këto nuk mbulojnë gjithë nevojat e komuniteteve. Soros Fondacioni Shoqëria e Hapur ka

ofruar trainime dhe ka hapur qendra për kujdesin e fëmijëve në shumë zona në Shqipëri. Programi i tyre mësimor është aprovuar nga Ministria e Arsimit dhe Shkencës. Në lidhje me ndarjen e përgjegjësive në nivelin e familjes Shteti ka bërë shumë pak. Për shembull, Kodi Shqiptar i Punës diskriminon kundër meshkujve duke mos u dhënë leje për baballarët me lindjen e fëmijës.

(d) Mbrojtja e grave shtatëzëna në vendin e punës. Drejtoria e Shëndetit Publik bën studime periodike për t ë përcaktuar punë që është e dëmshme për shtatëzaninë.

(f) The right to protection of health and to safety in working conditions including the safeguarding of the function of reproduction. The Inspectorate of Labor oversees that the legislation is observed with regard to circumstances of work and health safety. The revised Labor Code has improved the protection of workers, women and especially pregnant women. Chapter 10 of this Code particularly protects pregnant women and those who are breastfeeding and bans night shift work for pregnant women.

Research indicates that pregnant women are subject to poor work conditions and additional work pressures in their families. A study conducted between 1993-1994 with 1,199 Albanian pregnant women showed that certain work factors directly correlated with low birth weight, miscarriage and/or perinatal death. The significant factors included fewer household helpers, standing, working in a hot environment, commuting, walking and carrying, and lifting heavy weights on the job (Senturia, 1997).

A provision on sexual harassment in the workplace is included in the Labor Code, but it cannot be implemented since no proçedures on how to initiate a sexual harassment case are in place. In addition the lack of opportunities for work discourages women from reporting cases of sexual harassment. There is very little awareness that the law protects women should they report such cases.

2. Prevent discrimination on grounds of marriage or maternity. Although legal provisions prevent discrimination on grounds of marriage or maternity, participants mentioned that they had read in the Albanian press about cases of employers refusing to employ pregnant women or restrictions imposed on women regarding maternity leave.

(a) Illegal to dismiss because of pregnancy, maternity leave or change in marital status. Participants cited the Labor Code that banned employers from asking for pregnancy tests before employment, termination of contract when women are pregnant or until they return from maternity leave.

(b) Right to maternity leave with pay and benefits. Participants related that women have the right to maternity leave with pay and benefits. The legislation on maternity leave was well implemented, i.e., women took leave 35 days before delivery and 42 days after delivery of the baby, fully aware that they were banned by legislation to work during this time. After the 42 days, if they so chose, women came back to work. However, if they opted for a longer leave, their position was guaranteed.

(c) Social support measures to help parents share family and work obligations. A number of urban and rural areas lack state child care services. Private child care initiatives may exist, but they do not cover all the needs of the communities. The Soros Open Society Foundation has also offered training and opened child care centers in various areas of Albania. Its curriculum has been approved by the Ministry of Education. With regard to sharing responsibilities at the family level the State has done very little. For example, the

Albanian Labor Code discriminates against men by not giving them paternity leave upon birth of their child.

(d) Protection for pregnant women in the workplace. The Directorate of Public Health conducts studies periodically to define work that is harmful to pregnancy.

3. Rishikimi legjislativ i masave mbrojtëse. Drejtoria e Shëndetit Parësor po përgatit një draft ligj për ndalimin e disa punëve për gratë shtatëzana dhe ato me qumësht. Ligji i shëndetit riprodhues po i nënshtrohet disa ndryshimeve përfshirë masat parandaluese për gratë shtatëzëna. Lista përfshin mjediset e dëmshme në fabrika ku helmet mund të jenë të dëmshme për gratë dhe fëmijët, si dhe punët e rënda që janë të dëmshme për gratë shtatëzëna dhe fetusin.

Neni 12
1. Shtetet Palë marrin te gjitha masat e duhura për të eliminuar diskriminimin e gruas në fushën e kujdesit për shëndetin, për t'i siguruar, mbi bazën e barazisë midis burrit dhe gruas, mundësitë për të përfituar shërbime mjekësore, përfshirë dhe ato të planifikimit familjar.
2. Pavarësisht nga dispozitat e paragrafit 1 të mësipërm, Shtetet Palë i sigurojnë gruas gjatë shtatzanisë, lindjes dhe paslindjes shërbime të përshtatshme, po qe nevoja, falas, si dhe një ushqim të përshtatshëm gjatë shtatzënisë dhe mbajtjes së fëmijës në gji.

Fushat Shqetësuese

- Legjislacioni shqiptar nuk ndalon posaçërisht diskriminimin në kujdesin shëndetësor.
- Legjislacionit shqiptar i mungon mbrojtja e duhur për nënat me fëmijë në gji.
- Niveli i ndërgjegjësimit për planifikimin familjar është ende i ulët.
- Aksesi në shërbimet e kujdesit shëndetësor nuk është sistematik.
- Niveli i ndërgjegjësimit për të mirëmbajtur shëndetin është i ulët.
- Mungon trainimi gjithëpërfshirës për dhunën e bazuar në përkatësinë gjinore.
- Grave në moshën e menopauzës u jepet pak vëmendje.

Përputhja *De Jure*

Legjislacioni shqiptar përputhet shumë pak me nenin 12 të CEDAW-t. Neni 55 i Kushtetutës shqiptare i garanton cilitdo të drejta të barabarta për kujdesin shëndetësor që ofrohet nga shteti. Gjithsesi, kjo dispozitë mbetet deklarative, ndërsa mungojnë edhe formulime të posaçme që ndalojnë diskriminimin në fushën e kujdesit shëndetësor. Kjo sepse Ligji për Kujdesin Shëndetësor është mjaft i vjetër (1963) dhe reflekton një tjetër kulturë juridike. Ndryshime të tij apo edhe një ligj i ri për kujdesin shëndetësor është i domosdoshëm për të reflektuar standartet dhe angazhimet e mëvonshme ndërkombëtare ku ka aderuar Shqipëria. Megjithatë, ka një dispozitë që përdor termin "diskriminim": "Çdo grua, e lirë dhe e përjashtuar nga çdo formë diskriminimi, detyrimi dhe dhune, ka të drejtë për t'u kontrolluar e për të vendosur lirisht për të gjitha çështjet që lidhen me seksualitetin e saj dhe shëndetin seksual e riprodhues." [49] Neni 8 i Ligjit për Shëndetin Riprodhues e përgjithëson më tej këtë parim duke përfshirë të dy sekset: "Ky ligj i garanton çdo individi vendimmarrjen për ushtrimin e të drejtave riprodhuese sipas dëshirës dhe interesit të tyre, të lirë nga diskriminimi, detyrimi dhe dhuna."

Legjislacioni shqiptar i ofron mbështetje të posaçme dhe shërbime shëndetësore nënës dhe fëmijës. [50] "Të gjitha gratë shtatzëna përfitojnë falas ndjekjen periodike mjekësore të shtatzënisë, të lindjes dhe të paslindjes, veçanërisht ekzaminimet e paralindjes dhe të paslindjes, të detyrueshme, që caktohen me akt të Ministrit të Shëndetësisë." [51] Megjithë formulimin e tyre, zbatimi i këtyre dispozitave, ashtu si edhe cilësia e shërbimit shëndetësor është e papërshtatshme.

Ndonëse Kuvendi rishtazi miratoi një ligj për mbrojtjen e ushqyerjes me gji, [52] ky ligj është hartuar vetëm për të çinkurajuar zëvendësimin e qumështit të gjirit me atë artificial, për të rregulluar tregtimin e ushqimeve për fëmijë dhe përhapjen e informacionit për

[49] Ligji për Shëndetin Riprodhues, nr. 8876, datë 4 prill 2002, neni 6
[50] Ligji për Shëndetin Riprodhues, nr. 8876, datë 4 prill 2002, neni 13/2
[51] Ligji për Shëndetin Riprodhues, nr. 8876, datë 4 prill 2002, neni 24/1
[52] Ligj nr. 8528, datë 23.9.1999, "Për mbrojtjen dhe nxitjen e të ushqyerit me gji"

përparësitë që ka ushqyerja me gji. Mbrojtja që i siguron legjislacioni shqiptar ushqyerjes me gji është e kufizuar dhe dispozita apo programe që të sigurojnë ushqimin e përshtatshëm për nënat e reja përgjithësisht mungojnë. Disa nga këto aspekte trajtohen nga Konventa e ILO-së nr. 183 për Mbrojtjen e Mëmësisë, ratifikuar nga RSH me 2001 (shih tabelën me poshtë) dhe në VKM nr. 397, datë 20 maj 1996, me ndryshimet e mëvonshme, i cili ndalon nënat me fëmijë në gji të ngrenë pesha të rënda dhe u garanton atyre të drejtën për shkëputje periodike gjatë orarit të punës për të ushqyer fëmijën.

Listë e Plotë e Konventave të ILO-së të Ratifikuara nga RSH				
	Titulli i Konventës	**Numri**	**Data**	**Data e ratifikimit**
1.	Konventa për Mbrojtjen e Amësisë	183	2000	24 korrik 2004
2.	Konventa për Format më të Rënda të Punës së Fëmijëve	182	1999	02 gusht 2001
3.	Konventa për Agjencitë Private të Punësimit	181	1997	30 qershor 1999
4.	Konventa për Inspektimin e Punës	178	1996	24 korrik 2002
5.	Konventa për Punën në Shtëpi	177	1996	24 korrik 2004
6.	Konventa për Sigurinë dhe Ruajtjen e Shëndetit në Miniera	176	1995	03 mars 2003
7.	Konventa për Punën me Kohë të Pjesshme	175	1994	03 mars 2003
8.	Konventa për Parandalimin e Aksidenteve të Mëdha Industriale	174	1993	03 mars 2003
9.	Konventa për Mbrojtjen e Pretendimeve të Punonjësve	173	1992	03 shkurt 2005
10.	Konventa për Punën e Natës	171	1990	28 qershor 2004
11.	Konventa për Sigurinë dhe Mbrojtjen e Shëndetit në Punë	155	1981	09 shkurt 2004
12.	Konventa për Kontratat Kolektive	154	1981	24 korrik 2002
13.	Konventa për Administrimin e Punës	150	1978	24 korrik 2002
14.	Konventa për Konsultimet Tripalëshe	144	1976	30 qershor 1999
15.	Konventa për Organizatat e Punëtorëve Ruralë	141	1975	18 gusht 2004
16.	Konventa për Moshën Minimale	138	1973	16 shkurt 1998
17.	Konventa për Përfaqësuesit e Punonjësve	135	1971	18 gusht 2004
18.	Konventa për Fiksimin e Moshës Minimale	131	1970	18 gusht 2004
19.	Konventa kundër Diskriminimit	111	1958	27 shkurt 1997
20.	Konventa për Heqjen e Punës së Detyruar	105	1957	27 shkurt 1997
21.	Konventa për Shpërblim të Barabartë	100	1951	03 qershor 1957
22.	Konventa për të Drejtën e Organizimit dhe Kontratat Kolektive	98	1949	03 qershor 1957
23.	Konventa e Migracionit për Punësim(E rishikuar)	97	1949	02 mars 2005
24.	Konventa për Mbrojtjen e Pagave	95	1949	02 gusht 2001

Listë e Plotë e Konventave të ILO-së të Ratifikuara nga RSH				
25.	Konventa për Lirinë Sindikale dhe Mbrojtjen e së Drejtës së Organizimit	87	1948	03 qershor 1957
26.	Konventa për Inspektimin e Punës	81	1947	18 gusht 2004
27.	Konventa për Ekzaminimin e të Rinjve	78	1946	03 qershor 1957
28.	Konventa për Ekzaminimin e të Rinjve	77	1946	03 qershor 1957
29.	Konventa për Pushimet e Paguara	52	1936	03 qershor 1957
30.	Konventa për Punën e Detyruar	29	1930	25 qershor 1957
31.	Konventa për Mekanizmin e Fiksimit të Pagës Minimale	26	1928	02 gusht 2001
32.	Konventa për Ekzaminimin e të Rinjve	16	1921	03 qershor 1957
33.	Konventa për të Drejtën e Organizimit	11	1921	03 qershor 1957

Deri më 1992 ndërprerja e shtatzanisë ishte e paligjshme në Shqipëri, ndërsa tashmë aborti lejohet deri në javën e 12-të të shtatzënisë dhe pas kësaj periudhe nevojitet leje e veçantë nga një komision mjekësor, në varësi të shëndetit të nënës dhe fetusit. Kodi Penal parashikon si sanksion deri në pesë vjet heqje lirie për ndërprerjen e shtatzënisë pa pëlqimin e gruas, për abortin e kryer në mjedise apo persona të paautorizuar, apo për dhënien e mjeteve gruas shtatzënë, me qëllim që ajo vetë të kryejë ndërprerjen e shtatzënisë.[53]

Përputhja *De Facto*

1. Aksesi në kujdesin shëndetësor. Aksesi në shërbimet e kujdesit shëndetësor është i njëjtë për burrat dhe gratë. Në fakt, në disa raste, legjislacioni është më bujar ndaj grave për arsye të specifikave të shëndetit të grave, duke përfshirë sëmundjet e organeve riprodhuese, ose ekzaminimet si mamografia që ndihmojnë me diagnostikimin e sëmundjeve serioze. Udhëzuar nga parimet e Shëndeti 21 nga Organizata Botërore e Shëndetësisë (OBSH), pjesa më e madhe e instrumenteve janë të njëjta për burrat dhe gratë. Megjithatë nevojiten fushata për ngritjen e ndërgjegjësimit për mirëmbajtjen e shëndetit. Gratë zakonisht kërkojnë ndihmë kur ato sëmuren. Në zonat rurale, gratë ende nuk shkojnë për ekzaminime periodike gjatë shtatëzanisë si një mënyrë për të shmangur shumë komplikime gjatë dhe pas lindjes. Ekzaminimet e rregullta mjekësore nuk janë pjesë e mirëmbajtjes së shëndetit edhe për gratë e moshuara dhe ato me paaftësi. Gjithashtu, pacientët mund të zgjedhin shërbimet, dhe ata mund të favorizojnë doktoresha për ekzaminimet dhe doktorët për kirurgjitë. Në përgjithësi, shtëpitë e lindjes shihen si vendet e grave, kur, sipas profesionistëve të shëndetit, problemet e lidhura me shëndetin duhet të përballohen nga çifti. Gjithashtu më shumë vëmendje i duhet dhënë grave më të moshuara gjatë kohës së menopauzës.

Sipas mendimit të pjesëmarrësve/eve, aksesi i pamjaftueshëm për kujdesin shëndetësor zakonisht justifikohet me faktin që sistemi i kujdesit shëndetësor është në krizë. Duke qenë se mjekët/et dhe kirurgët/et kanë emigruar në qytetet kryesore të vendit, mungesa e personelit të kualifikuar mjekësor në zonat më të vogla dhe të largëta ka sjellë kaos në shërbime. Shumica e pacientëve ende shkojnë në Tiranë për të marrë kujdesin shëndetësor. Gratë dhe burrat përballen njësoj me probleme në aksesimin e shërbimeve

[53] Kodi Penal i RSH, ligj nr. 7895, datë 27 janar 1995, nenet 93, 94 dhe 95

të kujdesit shëndetësor. Intervistuesit/et përmendën se gratë ende lindin në shtëpi. Në disa raste, personeli mjekësor paguhet nën dorë, ç'ka do të thotë që jo të gjithë pacientët kanë të njëjtën vëmendje për kujdes shëndetësor.

2. Dhënia e shërbimeve falas dhe ushqyerje e duhur gjatë shtatëzanisë dhe kohës së qumështit. Pjesëmarrësit/et raportuan se gratë ndiqen gjatë gjithë kohës së shtatëzanisë dhe u jepen të paktën tre sesione sonogramesh falas në qendrat spitalore. Stafi i specializuar adreson shqetësimet e tyre. Megjithatë, Anketa *Shqipëria - Dije, Qëndrim, Besim dhe Praktika 2000* tregohet se kujdesi prenatal është shumë i kufizuar. Vetëm 18 perqind e grave që qenë shtatëzënë rreth kohës së anketimit thanë që ishin ekzaminuar në trimesterin parë të shtatëzanisë së tyre të fundit; 45 perqind nuk ishin ekzaminuar deri në trimesterin e dytë, dhe 37 përqind nuk shkuan te doktori/resha deri në tre muajt e fundit të shtatëzanisë. Kjo mund të shpjegohet me nivelin arsimor dhe statusin social-ekonomik – grupet me status më të ulët social – ekonomik kanë më pak akses në shërbimet e kujdesit para lindjes, dhe gratë me arsim më të lartë e kuptojnë më mirë nevojën për të kërkuar kujdesin para lindjes.

Pas lindjes së fëmijës, shëndeti i fëmijës dhe gruas ndiqen nga një mjek/e në *Konsultore* (qendra të specializuara për nënën dhe fëmijën). Vaksinimet për nënën dhe beben janë falas dhe nënat janë të pajisura me një fletore të dhënash për të shënuar të gjitha vaksinimet. Një shqetësim kryesor, për mendimin e pjesëmarrësve/eve, ishte se nënave të reja nuk u jepet trainim në kujdesin e bebeve. Gratë inkurajohen të lënë maternitetin brenda 24 orëve të lindjes.

Një numër masash është marrë për të përmirësuar ushqyerjen gjatë shtatëzanisë. Sipas Protokollit të Ministrisë së Shëndetit, janë marrë masa për të shpërndarë suplemente hekuri dhe acidi folik gjatë shtatëzanisë. Ligji që inkurajon ushqyerjen me gji hartuar në bazë të rekomandimeve të Organizatës Botërore të Shëndetësisë dhe në Kodin Ndërkombëtar të Marketingut të Zëvendësuesve të Qumështit të Gjirit thotë që gratë duhet të ushqejnë me gji bebet e tyre gjatë gjashtë muajve të parë. Ligji nuk ndalon marketimin e zëvendësuesve, por rregullon se si këto produkte shiten dhe ndalon dhënësit e shërbimeve të kujdesit shëndetësor që të lëshojnë receta për to pa rekomandimin e mjekut/es. Spitali nuk merr masa në lidhje me ushqyerjen e grave shtatëzëna, por promovon ushqyerjen me gji. Nëse një nënë nuk ka mundësi të ushqejë me gji, bebja ushqehet nga gra të tjera të shëndetshme që janë në gjendje të ushqejnë me gji. Më shumë ndihmë ekonomike për gratë gjatë shtatëzanisë dhe periudhës së qumështit është e nevojshme – megjithëse gratë marrin informacion se si duhet të ushqejnë veten dhe beben, asnjëherë nuk sigurohet që gratë do të kenë mjetet që ta bëjnë këtë si duhet.

Pjesëmarrëset raportuan praktika të mira të sesioneve të trainimit të ndërmarra për kontrollin e gjirit. Gratë që morën pjesë në këto sesione trainimi konsultoheshin me doktorët më shumë se ato që nuk kishin marrë pjesë në to.

Pjesa më e madhe e shërbimeve të planifikimit familjar, duke përfshirë informacionin për planifikimin familjar, ofrohen falas, por jo të gjitha gratë përfitojnë nga këto pasi ato nuk janë të sigurta që fshehtësia e tyre do të ruhet nga personeli shëndetësor. Gratë mund të shkojnë në vende të ndryshme nga vendi i banimit, atje ku ato nuk njihen për të marrë kontraceptivë falas. Planifikimi familjar si një masë e lënies së hapësirave kohore midis fëmijëve nuk pranohet ende, sidomos nga burrat, dhe më shumë fushata për ngritjen e ndërgjegjësimit duhet të bëhen mbi këtë temë.

Aborti është shfaqur gjerësisht si metodë kontraceptive. Një raport i vitit 2004 nga klinika Mary Stopes/Nesmark gjeti që 17,000 aborte bëhen çdo vit nga femrat e moshës 25 - 35 vjetë, megjithëse femrat që nga mosha 14 ose 15 vjetë abortojnë. Aborti i bazuar në seksin e fetusit është evidentuar si një dukuri serioze. Ndërsa shërbimet e abortit ofrohen, fushatat që përqëndrohen në pasojat e abortit për shëndetin e femrave janë të nevojshme.

Ligje diskriminuese për HIV/AIDS. Nuk ka ligje diskriminuese për personat e infektuar me HIV/AIDS. Garantohet konfidencialiteti i trajtimit. Përfaqësuesit/et e Ministrisë së Shëndetsisë besojnë se Shqipëria është një nga vendet me përqindje më të ulët të HIV /AIDS, dhe deri më sot, asnjë grua shtatzënë nuk është diagnostikuar me HIV/AIDS. Megjithatë janë bërë përpjekje parandaluese në formën e fushatave për rritjen e ndërgjegjësimit. Gratë shtatëzëna dhe gratë e moshës që mund të lindin fëmijë marrin informacion për testimin e HIV/AIDS dhe pasojat e të infektuarit nga virusi, si dhe informacioni mbi terapinë retrovirale. Megjithëkëtë niveli i ndërgjegjësimit për HIV/AIDS mbetet i ulët sidomos në radhët e popullsisë femërore Rome.

Dhuna me bazë gjinore. Përgjithësisht besohet se femrat shqiptare i nënshtrohen dhunës, sidomos në mjedisin e shtëpisë. Të paktën tetë përqind e grave shqiptare janë abuzuar fizikisht në duart e një partneri intim, sipas një anketimi mbarëkombëtar të kryer në 2003, dhe rreth 25 përqind të tjera janë abuzuar psikologjikisht. Një tjetër studim i kryer me një kampion përfaqësues të 1,039 grave të martuara në grupmoshën 25-65 vjeç që jetonin në Tiranë u përqëndrua në dhunën nga një partner intim dhe në karakteristikat shoqërore dhe demografike të grave dhe bashkëshortëve të tyre. Ai gjeti që më shumë se një të tretat e grave kishin provuar dhunë në familje. Rreziku më i madh ishte për gratë në grupmoshën 25-34 vjeç, gratë me arsim universitar, gratë nënpunëse, gratë me bashkëshortë më pak të arsimuar dhe gratë e martuara me burra të rritur në zonat rurale. Gratë ishin në rrezik më të madh nësë ishin më të arsimuara se bashkëshortët e tyre (Burazeri, Roshi, Jewkes, Jordan, Bjegovic & Laaser, 2005).

Megjithëse pjesëmarrësit/et në intervista konfirmuan ekzistencën e dhunës në familje, ato gjithashtu përmendën se mbajtja e të dhënave për gratë e abuzuara është problematike përderisa gratë vetë e kanë të vështirë të raportojnë që ato janë abuzuar. Kjo është sidomos e vërtetë kur gratë kërkojnë ndihmë në qendrat shëndetsore.

Trainimi për personelin mjekësore që trajton gratë e dhunuara nuk është sistematik. Mjekët e përgjithshëm janë trainuar dhe vazhdojnë të trainohen për të diagnostikuar dhe trajtuar rastet e dhunës në familje, por në mënyrë sporadike. Një punonjëse e shëndetit përmendi që nëpërmjet bashkëpunimit me Universitetin e Montreal-it, është zhvilluar një seri leksionesh me mjekët e përgjithshëm në Tiranë në diagnostikimin dhe trajtimin e grave të abuzuara.

Në lidhje me kuadrin ligjor, një pjesëmarrëse përmendi që draft ligji për dhunën në familje që po përgatitetet do të ishte një instrument i dobishëm në identifikimin e rasteve specifike të dhunës në familje dhe në proçesimin e rasteve që në të kundërt nuk mund të zgjidhen nga legjislacioni i tanishëm.

Megjithatë, më shumë punë duhet bërë për të kuptuar dhunën me bazë gjinore. Për shembull nuk diskutohet rreth dhunës që rrjedh si pasojë e mos-përputhjes së grave me detyrimet seksuale brenda martesës; nuk ofrohen as shërbime, trainime apo këshillime përveçse nga OJF-të, dhe këto jo gjithmonë sistematike. Rekomandohet një studim që

përdor treguesit e Bashkimit Evropian 2002 për dhunën në familje kundër gruas (shihni faqen 97 të raportit). Treguesit masin shkallën e dhunës në familje, informojnë përgjigjet me anë të politikave dhe vlerësojnë përgjegjshmërinë e shteteve, përfshirë këtu një gamë mbështetjesh të disponueshme për gratë, dispozita legjislative, politika dhe burime buxhetore (për më shumë detaje shihni, Carrillo, Connor, Fried, Sandler & Waldorf, 2003)

.

Neni 13
Shtetet Palë duhet të marrin të gjitha masat e nevojshme për të eliminuar diskriminimin e gruas në fushat e tjera të jetës ekonomike dhe shoqërore, për t'i siguruar, mbi bazën e barazisë së burrit dhe gruas, të njëjtat të drejta dhe pikërisht:
(a) Të drejtën për shpërblime familjare;
(b) Të drejtën për hua bankare, ndihma hipotekare dhe forma të tjera të kreditit financiar;
(c) Të drejtën për të marrë pjesë në aktivitete zbavitëse, sportive dhe në të gjitha aspektet e jetës kulturore.

Fushat Shqetësuese

- Legjislacioni shqiptar nuk përmend në mënyrë specifike barazinë ose mos-diskriminimin e grave në sferën e së drejtës civile.
- Biznesi i udhëhequr nga gratë nuk është ende i zhvilluar mirë.
- Gratë përfitojnë pak nga huatë dhe kredia e bankave.

Përputhja *De Jure*

Legjislacioni shqiptar nuk e përmend shprehimisht barazinë apo mosdiskriminimin e grave në fushën e së drejtës civile. Megjithatë Kodi Civil, legjislacioni bankar dhe ligje të tjera përdorin gjuhë neutrale nga pikëpamja gjinore, të tilla si "çdo person", "palët", "personat fizikë". Kështu Kodi Civil përcakton se të gjithë personat fitojnë zotësinë për të vepruar kur mbushin moshën 18 vjeç dhe që nga ai moment mund të kryejnë lirisht çdo lloj veprimi juridik. Ka raste kur Kodi Civil përdor terma të tilla si "kreditor" apo "pronar" në gjininë mashkullore. Por kjo ndodh kudo në tekstet e ligjeve në Shqipëri. Ndonëse të gjithë, përfshi edhe juristët, me këto terma nënkuptojnë të dy gjinitë, të paktën për ligjet e ardhshme duhet të fillojë të përdoret një gjuhë e veçantë për të dy gjinitë dhe hartuesit duhet të ndërgjegjësohen më shumë për problemet gjinore dhe lidhjen e tyre me legjislacionin

Kushtetuta shqiptare i garanton kujtdo lirinë artistike dhe krijuese si dhe pjesëmarrjen në kërkimet shkencore (neni 58) ndërsa neni 59 parashikon lirinë e pjesëmarrjes në sporte dhe veprimtari zbavitëse. Sërish gjuha e përdorur është neutrale nga pikëpamja gjinore, por mungojnë dispozitat e posaçme për barazinë dhe mosdiskriminimin e grave në këto fusha të jetës ekonomike e sociale.

Përputhja *De Facto*

(a) Përfitimet për anëtarët e familjes. Përfitimet jepen për meshkujt dhe femrat veçan bazuar në kohëzgjatjen e punës.

(b) Huatë bankare dhe forma të tjera të kreditit financiar. Gratë rrallë aplikojnë për kredi, sepse ato perceptohen zakonisht sikur kanë një rol mbështetës në aktivitetet e biznesit. Gjithashtu, për shumë banka, politika e huasë kërkon që aplikuesi/sja të ketë kapital, ndërsa në të vërtetë pak gra e kanë një gjë të tillë. E dreja e gruas ndaj pronës zakonisht humbet kur prona rregjistrohet në emrin e burrit. Intervistat treguan për shumë raste kur banesa martesore e çiftit rregjistrohet (ilegalisht) nën emrin e bashkëshortit, megjithëse të dy bashkëshortët kanë të drejta pronësie mbi pasurinë. Zakonisht gratë nuk kanë mbështetjen e burrave në marrjen e nismave të biznesit, ose në disa raste ato nuk kanë kurajo që të ndërmarrin një nismë të tillë. Mungesa e informacionit kontribon gjithashtu në paaftësinë për të përdorur efektivisht bankat.

(c) Pjesëmarrja në sporte, aktivitete çlodhëse, dhe të gjitha aspektet e jetës kulturore. Femrat mund të angazhohen me çdo sport dhe aktivitet çlodhës që ato zgjedhin. Burimet ekonomike mund të influençojnë pjesëmarrjen e njëjtë të femrave dhe meshkujve në aktivitete çlodhëse, megjithatë femrat janë aktive në disa prej këtyre fushave. Të financuara nga qeveria dhe donatorë të tjerë, shoqëri që përqëndrohen në organizimin e ngjarjeve kulturore të udhëhequra nga gra organizojnë aktivitete të ndryshme (piktura, ekspozita, festivale muzikore, shfaqje televizive, etj.) Është e vështirë të përcaktohet pjesëmarrja e vajzave dhe grave në sporte. Instituti i Statistikës nuk i ndan të dhënat për pjesëmarrjen në sport sipas përkatësisë gjinore. Megjithatë, pjesëmarrësit/et treguan se mungesa e fondeve dhe stereotipet për pjesëmarrjen e grave në sporte të caktuara i dekurajojnë femrat nga pjesëmarrja në sporte.

Neni 14
1. Shtetet Palë duhet të mbajnë parasysh problemet e veçanta që ndesh gruaja fshatare dhe rolin e rëndësishëm që luan ajo për mbijetesën ekonomike të familjes, sidomos me punën e saj në sektorët jomonetarë të ekonomisë. Ata marrin të gjitha masat e nevojshme për të siguruar zbatimin e dispozitave të kësaj Konvente në dobi të grave të zonave bujqësore.
2. Shtetet Palë duhet të marrin të gjitha masat e duhura për të eliminuar diskriminimin e gruas në zonat fshatare me qëllim që të sigurojnë, mbi bazën e barazisë së burrit dhe gruas, pjesëmarrjen e saj në zhvillimin e fshatit dhe njëherësh në avantazhet që sjell ai. Në mënyrë të veçantë ata i sigurojnë gruas këto të drejta:
(a) Të marrë pjesë në përpilimin dhe zbatimin e planeve të zhvillimit në të gjitha hallkat;
(b) Të përfitojë shërbime të përshtatshme në fushën e shëndetit, përfshirë informacionin, këshillimin dhe shërbimet në fushën e planifikimit familjar;
(c) Të përfitojë drejtpërdrejt nga programet e sigurimeve shoqërore;
(ç) Të marrë çdo lloj formimi dhe edukimi të rregullt ose jo, përfshirë atë që ka të bëjë me alfabetizimin funksional, si dhe, ndër të tjera të përftojë nga të gjitha shërbimet e bashkësisë dhe të tjera, sidomos për të rritur njohuritë e saj teknike;
(d) Të organizojë grupe të ndihmës së ndërsjellë dhe kooperativa, me qëllim që të ketë mundësi të barabarta në rrafshin ekonomik, nëpërmjet punësimit ose vetëpunësimit;
(e) Të marrë pjesë në të gjitha aktivitetet e bashkësisë;
(ë) Të ketë mundësi të marrë kredi bujqësore, lehtësi marketingu e teknologji të përshtatshme. Të ketë trajtim të barabartë në fushën e reformës tokësore e agrare, si dhe në projektet e sistemimit bujqësor;
(f) Të ketë kushte jetese të përshtatshme, sidomos lidhur me strehimin, përmirësimin e mjedisit, furnizimin me energji elektrike dhe ujë, transportin dhe komunikacionin.

Fushat Shqetësuese

- Gratë në zonat rurale janë më të diskriminuara. Megjithatë, legjislacioni shqiptar nuk bën dallim midis grave në zonat rurale dhe jo rurale.
- Mungojnë autoritetet e ngarkuara me detyrën specifike që të zbatojnë ose monitorojnë zbatimin e legjislacionit që mbron të drejtat e grave në zonat rurale në nivelin lokal.
- Marrja e kujdesit shëndetësor është problematike, veçanërisht në zonat e largëta.
- Braktisja e shkollës nga vajzat mbi 14 vjeç është e lartë.
- Pak gra përfitojnë nga skemat e sigurimeve shoqërore.
- Si për meshkujt dhe për femrat ka pak mundësi për të zhvilluar biznesin nëpërmjet kredisë.
- Mundësitë për të marrë pjesë në jetën e komunitetit janë të kufizuara.
- Kushtet e strehimit, higjenës, elektricitetit, furnizimit me ujë, shërbimet e transportit dhe komunikimit të duhur nuk janë njësoj kudo.

Përputhja *De Jure*

Legjislacioni shqiptar nuk bën ndonjë dallim mes grave të zonave bujqësore apo jo-bujqësore, ndonëse në praktikë jeta e grave fshatare mund të jetë më e vështirë. Po kështu nuk bëhet dallim në zbatimin e CEDAW-t për gratë fshatare dhe jofshatare. Pra, duke patur parasysh mungesën e legjislacionit të veçantë për gratë fshatare, këto gra, ose organizmat e shoqërisë civile që i përfaqësojnë mund të invokojnë në gjykatë dhe t'i kërkojnë shtetit të zbatojë drejtperdrejt Konventën mbi Eliminimin e të Gjitha Formave të Diskriminimit të Gruas.

Siç u përshkrua në analizën në bazë të nenit 3 të këtij raporti, Ligji për Barazinë Gjinore në fakt përmend një rrjet nëpunësish të barazisë gjinore në nivel lokal (qarku), por pa përcaktuar më tej se çfarë do të përfshijnë detyrat dhe përgjegjësitë e tyre, si do të organizohen dhe funksionojnë ata, etj.

Legjislacioni bankar i ofron mundësinë e marrjes së huave kujtdo, pa dallim në lidhje me seksin apo vendbanimin. Shteti ofron kushte më të leverdisshme për pagesën e huave bujqësore, por sërish asnjë dallim nuk bëhet në varësi të gjinisë[54] Disa nene në Kodin Civil iu referohen familjeve bujqësore. Pronësia e kësaj familjeje iu përket të gjithë anëtarëve, të cilët përmes punës apo të drejtave të tjera, kanë kontribuar në krijimin dhe mbajtjen e kësaj veprimtarie të përbashkët ekonomike. Sipas nenit 224, familja bujqësore përfaqësohet nga kryetari i saj në marrëdhëniet tregtare apo pasurore me të tretët. Anëtarët e familjes bujqësore zgjedhin kryetarin e tyre, i cili ndonëse ligjërisht mund të jetë si femër ashtu edhe mashkull, në praktikë dhe me marrëveshje të heshtur është thuajse gjithmonë burrë. Edhe rastet e regjistrimit të pasurisë në emër të burrit nuk janë të rralla. Po të kemi parasysh vështirësitë që hasin gratë fshatare, është e rekomandueshme të ndërmerren masa legjislative dhe të tjera që t'u ofrojnë atyre më shumë mundësi.

Përputhja *De Facto*

1. Njohja e situatës së grave në zonat rurale. Diskriminimi i grave në zonat rurale është veçanërisht i dukshëm. Zonat rurale ushqejnë më shumë praktika kulturore që pengojnë gratë në arritjet e tyre. Sipas mendimeve të disa pjesëmarrësve, gratë në zonat rurale nuk trajtohen me respekt, pasi këto zona nuk ecin me të njëjtin hap të zhvillimit si në zonat urbane. Shumë norma dhe zakone të vjetra janë rrënjosur në mënyrën e të menduarit dhe të vepruarit dhe këto pranohen nga të gjithë.

2 (a) Pjesëmarrja në hartimin dhe zbatimin e planifikimit të zhvillimit në të gjithë nivelet. Gratë në zonat rurale në Shqipër mund të jenë të interesuara që të marrin pjesë aktive në planifikimin e zhvillimit në të gjithë nivelet, por ndryshimet strukturore dhe ndryshimet në teknologji janë një ngarkesë sidomos për gratë. Shumë lehtësira komunitare dhe sociale si kopështet nuk ekzistojnë më; këto më parë ishin falas ose shërbimet ishin lehtësisht të përballueshme. Bujqësia nuk është më e mekanizuar si ishte më parë në fermat shtetërore. Kështu që ngarkesa e dyfishtë e punës prodhuese dhe riprodhuese sot i lë grave pak kohë dhe energji për të marrë pjesë aktivisht në çështjet komunitare. Megjithatë, pjesëmarrësit/et raportuan se gratë janë të përfshira në takimet në nivel komunitar dhe vendimet e marra në këtë nivel marrin në konsideratë komentet e grave kur këto të fundit jepen.

2(b) Marrja e kujdesit shëndetsor në zonat rurale. Ekzisojnë mundësitë për të marrë informacion specifik mbi kujdesin shëndetsor. Kur kujdesi mjekësor profesionist nuk është i disponueshëm, gratë i referohen qendrave mjekësore në qytet, por këto janë rrallë të përballueshme financiarisht për to. OJF-të në bashkëpunim me qeverinë vendore, punojnë për të mbushur hendekun informativ në kujdesin e përgjithshëm shëndetësor dhe në veçanti atë për shëndetin riprodhues. Në zonat e largëta është vënë re një migrim i gjerë ose braktisje e detyrës nga ana e stafit mjekësor, qendrat shëndetësore janë mbyllur. Qendrat shëndetësore po ndërtohen në komunitete të mëdha prej 2,000-3,000 banorësh. Jepet pagë shtesë për të inkurajuar mjekët e përgjithshëm për të shërbyer në zonat e largëta me pak ose aspak kujdes shëndetsor. Megjithatë, kushtet e këtyre qendrave shëndetësore nuk janë optimale. Megjithëse stafi mjekësor në zonat rurale

[54] Kodi Civil, ligj nr. 7850, datë 29 korrik 1994, neni 222

marrin pjesë në trainime të shpeshta, individët mund të të marrin kujdes të specializuar shëndetsor vetëm në zonat urbane. Zgjedhja e bazuar në informacion nuk është ende e zakonshme për gratë në zonat rurale. Ato veçanërisht nuk kanë informacion mbi shëndetin mendor.

Puna në zonat rurale është më i vështirë. Ndërsa gratë duan të informohen, ato pengohen nga shoqëria, familja dhe bashkëshortët e tyre. Për shembull, pjesëmarrëset thanë se nëse një gruaje i duhet të marrë shërbimin për planifikimin familjar, asaj i duhet të marrë leje nga bashkëshorti dhe nga vjehrra.

2(c) Përfitimi i drejtpërdrejtë nga programet e sigurimeve shoqërore. Sipas Institutit të Statistikës, pagesa e pensionit për individët në zonat rurale është një e treta e pagesës shtetërore të pensionit. Gjithashtu, gratë në zonat rurale e kanë të vështirë të përfitojnë nga skema shtetërore si sigurimet shoqërore, përfitimet e papunësisë, lejet për sëmundje, kompensimi për pension dhe moshën e thyer. Vetëm gratë që punonin në kooperativat shtetërore që u shpërbënë pas fillimit të viteve 1990 përfitojnë nga këto skema. Shumica e grave në zonat rurale janë tani të vetë-punësuara dhe nuk kanë dëshirë ose janë të keq-informuara për të paguar sigurimet shoqërore vetë që të mund të përfitojnë në moshë të thyer.

2(d) Marrja e arsimit. Vajza në zonat rurale e kanë të vështirë të vazhdojnë arsimin në shkollë të mesme. Në fakt, numri i vajzave në zonat fshatare që ndjekin shkollat e mesme është zvogëluar. Kërkimet tregojnë se në zonat rurale brezi i ri i grave në fshat do të vuajë dënimin shtesë të analfabetizmit. Një vështrim etnografik i një fshati në veri të Shqipërisë në fund të viteve 1990s tregon se në kohën e studimit pothuaj asnjë nga vajzat e fshatit nuk ishte shkolluar përtej moshës 14 ose 15 vjeç. Shkolla më e afërt e mesme ishte në qytet, dhe frikërat reale të sulmimit dhe rrëmbimit e bënin frekuentimin shumë të rrezikshëm në sytë e shumë prindërve (Lawson, Mcgregor & Saltmarshe, 2000).

Në kuadrin e Ligjit për Qeverinë Vendore dhe decentralizimit të qeverisë vendore, problemet që lidhen me shkuarjen në shkollë të vajzave si djemtë janë zgjidhur individualisht nga komunat. Për shembull, megjithëse nuk parashikohet si detyrim ligjëror, në shumë zona si në komunat e Fushë Arrëzit, Malësisë së Madhe dhe Delvinës, ka funksionuar një shërbim me autobus që mbledh nxënësit dhe i dërgon në shkollë çdo ditë. Ky shërbim nuk është kombëtarizuar, por pjesëmarrësit/et debatuan se nisma të tilla ndodhin vetëm në zona ku qeveria vendore është e ndërgjegjësuar për çështjet e barazisë gjinore.

2(e) E drejta për mundësi ekonomike nëpërmjet punësimit ose vetë-punësimit. Përderisa nuk ekzistojnë ndërmarrje të mëdha, gratë kanë pak mundësi për punësim. Kjo nuk është e njëjtë për burrat që mund të emigrojnë për punë sezonale që të punësohen në qytet ose jashtë shtetit. Megjithëse disa agjensi zhvillimi i kanë ndihmuar gratë të fillojnë biznesin e tyre, në përgjithësi, ekzistojnë pak mundësi për të zhvilluar një biznes nëpërmjet kredisë si për burrat dhe gratë.

2(f) E drejta për të marrë pjesë në të gjithë aktivitetet e komunitetit. Gratë dëshirojnë të marrin pjesë në aktivitetet shoqërore dhe kulturore. Ndërsa gratë mbajnë peshën kryesore të kujdesit për fëmijët, pjesëmarrja në aktivitetet e komunitetit influencohet shumë nga ekzistenca e shërbimit të kujdesit për fëmijët. Ka shumë pak shërbime cilësore në zonat rurale. Në shumë zona nuk ka çerdhe dhe kopështe dhe gratë dhe anëtare të tjera të familjes kujdesen për fëmijët. Për më tepër, emigracioni i burrave jashtë shtetit apo aktiviteti tregtar i burrave i lë gratë të përballojnë pjesën më të madhe të punës bujqësore.

I vetmi argëtim për gratë mbeten dasmat ose festimet fetare. Parja e programeve televizive mund të jetë një mundësi tjetër argëtuese, por shpesh kjo nuk është e mundur pasi energjia elektrike mungon shpesh. Si shteti dhe OJF-të bëjnë pak për të adresuar pjesëmarrjen e grave në jetën komunitare.

2(g) Marrja e kreditit dhe borxhit bujqësor, reforma e tokës. Raporti Kombëtar i Zhvillimit Njerëzor (2005) raporton se mungojnë të dhënat zyrtare si hyrja në programet e kreditit dhe institucionet financiare si dhe numri i grave të vetëpunësuara në zonat rurale. Në intervista, gratë raportuan se në fillim të viteve 1990 kur ndodhi privatizimi i pronave, të gjitha pronat që i takonin kooperativave bujqësore u shpërdanë njësj femrave dhe meshkujve sipas rregullave. Megjithatë, problem kryesor mbetet se nësë toka rishpërndahet sipas numrit të anëtarëve të familjes, ajo u rregjistrua në emër të kryetarit të familjes që është në të njëjtën kohë dhe pronari i ligjshëm i pronës. Kështu, zakonisht, respekti i të drejtës së grave ndaj tokës dhe pronave është në dorë të burrave.

Të intervistuarit/at raportuan se gratë zakonisht trashëgojnë tokën nga baballarët. Sipas zakonit dhe traditës, nëse një grua ka të drejtën e tokës në familjen e origjinës, ajo duhet t'ia dorëzojë familjes këtë pronë kur martohet. Ajo nuk ka të drejtë të ketë në pronësi tokë apo të tjera gjëra në familjen e bashkëshortit. Megjithatë, edhe kur toka i takon gruas, ajo konsiderohet pronë e të gjithë familjes, dhe gratë zakonisht nuk lejohen të administrojnë tokën sipas dëshirës së tyre. Kur lindin konflikte për tokën, femrat dhe meshkujt kanë të drejtë të mbrojnë pronën e tyre. Zakonisht këto raste zgjidhen në gjyq. Nuk është raportuar asnjë rast diskriminimi ndaj grave deri tani në këtë fushë.

2(h) Strehim, higjenë, elektricitet dhe furnizim me ujë i duhur, transporti dhe komunikimi. Ndërsa kushtet e jetesës janë përmirësuar deri në një shkallë, standartet e jetesës janë më të ulta se në zonat urbane. Tabela e mëposhtme krahason pajisjet shtëpiake dhënë nga Instituti i Statistikave. Siç tregon kjo tabelë, shtëpitë të fshat janë më dobët se ato në zonat urbane, dhe kushtet e jetesës dhe të punës për gratë janë më të vështira në zonat rurale.

Pajisjet në shtëpitë shqiptare

(në përqindje të familjeve)

Lloji i pajisjeve	**Totali**	**Urbane**	**Rurale**
Televizor	90.0	95.1	85.8
Antenë sateliti	23.5	23.1	23.8
Frigorifer	74.1	88.0	62.4
Sobë me elektricite për gatim	42.5	62.1	26.1
Sobë me gas për gatim	18.7	26.5	12.2
Makinë larëse	39.3	67.5	15.7
Mikrovalë	1.9	2.8	1.1
Ajër i kondicionuar	1.3	2.4	0.4
Kompjuter	1.4	2.7	0.3
Makinë	8.0	11.4	5.2

* INSTAT, Rregjistrimi i Strehimit dhe Popullsisë, Prill 2001

Megjithëse shumica e familjeve fshatare në zonat e pjesëmarrësve/eve kanë ujë në shtëpitë e tyre, të dhënat nga Instituti Shqiptar i Statistikave tregojnë se rreth 43 përqind

e familjeve në vend e bëjnë furnizimin me ujë jashtë ndërtesës dhe rreth 41 përqind përdorin pus ose depo.

Shpërndarja e Familjeve sipas Mënyrës së Furnizimit me Ujë (në përqindje të familjeve)			
	Totali	Urbane	Rurale
Brenda banesës	46.9	84.4	15.5
Jashtë banesës	28.5	10.9	43.3
Pus, depo, etj.	24.6	4.7	41.2
Totali	100.0	100.0	100.0
* INSTAT, Rregjistrimi i Strehimit dhe Popullsisë, Prill 2001			

Ashtu si në zonat urbane, shtëpitë në zonat rurale i plotësojnë nevojat e tyre për ngrohje në mënyrë individuale. Nuk ekziston sistemi i ngrohjes qendrore. Furnizimi me elektricitet është njësoj problematik në zonat urbane dhe rurale, nëse jo më i keq në këto të fundit. Ekziston mundësia për transport në zonat urbane, por ky është një shërbim i privatizuar dhe burime financiare nevojiten për të përballuar shpenzimet.

Dhuna me bazë gjinore në zonat rurale. Ndërsa media raporton për praninë e dhunës me bazë gjinore, dhe sidomos rastet e vrasjeve, pjesëmarrësit/et vetë nuk raportuan asnjë rast dhune. Megjithatë, një nga sfidat e luftës kundër dhunës me bazë gjinore në këto zona është njohja e dhunës si problem dhe të besuarit dhe përdorimit të institucioneve përkatëse që ndihmojnë në adresimin e kësaj dhune.

Neni 15
1. Shtetet Palë i njohun gruas barazinë me burrin para ligjit.
2. Shtetet Palë i njohin gruas, në lëmin civil, zotësi juridike të njëjtë me atë të burrit dhe të njëjtat mundësi për ta ustrhuar këtë zotësi. Ata i njohin asaj në mënyrë të veçantë të drejta të barabarta përsa i përket lidhjes së kontratave dhe administrimit të pasurisë e po ashtu i akordojnë të njëjtin trajtim në të gjitha fazat e proçedurës gjyqësore.
3. Shtetet Palë u morën vesh që çdo kontratë ose çdo dokument tjetër privat, i çdo lloji qoftë, që ka për efekt juridik kufizimin e zotësisë juridike të gruas, duhet të konsiderohet i paqenë.
4. Shtetet Palë u njohin burrit dhe gruas të njëjtat të drejta lidhur me legjislacionin që trajton të drejtën e personave për të qarkulluar lirisht, si dhe për të zgjedhur vendbanimin dhe banesën e tyre.

Fushat Shqetësuese

- Perceptimet social-kulturore kufizojnë mundësitë për t'u angazhuar me biznes.
- Shteti nuk ka bërë asnjë studim për të parë nëse ekziston ndonjë anësi gjinore në arsyetimin, praktikat dhe vendimet gjyqësore.
- Gratë kanë nevojë të marrin leje nga burrat për t'u angazhuar në punë apo për të udhëtuar.
- Nuk ekzistojnë politika inkurajuese nga qeveria që lejojnë gratë të përfshihen në aktivitete biznesi.

Përputhja *De Jure*

Legjislacioni shqiptar nuk përmban ndonjë dispozitë që të ndalojë diskriminimin e gruas në çështjet civile, por megjithatë përmban një dispozitë që sanksionon të drejta të barabarta. Neni 1 i Kodit Civil përcakton se çdo person fizik gëzon zotësi të plotë dhe të barabartë për të patur të drejta civile dhe për të marrë përsipër detyrime, brenda kufijve të përcaktuar me ligj. Një person që mbush moshën madhore, fiton zotësinë e plotë për të ndërmarrë të drejta e detyrime; për gratë që martohen para moshës 18, kjo ndodh më herët. Neni 4 i Kodit Civil parashikon se të drejtat civile të një personi mund të kufizohen vetëm me ligj. Ndonëse jo i formuluar posaçërisht për femrat, neni 11 parashikon se çdo veprim juridik apo akt që synon të kufizojë zotësinë për të vepruar të një individi, është i pavlefshëm. Gratë, si dhe burrat gëzojnë zotësi të plotë për të hyrë në marrëdhënie kontraktore apo për të nënshkruar instrumente të tjera private, për të administruar prona, të përfshihen në marrëdhënie tregtare, etj., pavarësisht nga gjendja civile dhe çdo akt që ka për qëllim të kufizojë zotësinë e tyre për të vepruar, është i pavlefshëm.

Sipas Kushtetutës shqiptare kushdo ka të drejtë të paraqesë padi apo ankesa para organeve shtetërore. Kodet e Proçedurës Penale e Civile i garantojnë cilitdo të drejta të barabarta në të gjitha shkallët e gjykimit. Pjesëmarrja e tyre në gjykim mund të jetë në cilësinë e paditësit, të padituri a dëshmitarit. Kodi Civil përdor gjuhë neutrale nga pikëpamja gjinore, kështu që për gratë nuk ka kurrfarë pengese ligjore për të marrë pjesë në gjykime dhe gjykata. Gratë po ashtu mund të marrin pjesë në proçes edhe si gjyqtare, prokurore, avokate, eksperte, etj. Ndonëse për këto funksione ka kufizime apo kritere që lidhen me kualifikim e personit, këto nuk lidhen me gjininë e tij/saj.

Së fundi, ligji shqiptar i granton lirinë e lëvizjes kujtdo. Në bazë të nenit 38 të Kushtetutës, gjithkush ka të drejtën të zgjedhë vendbanimin dhe të lëvizë lirisht nëpër çdo pjesë të territorit shqiptar. Askush nuk mund të ndalohet të udhëtojë lirisht jashtë

shtetit. Ligji parashikon se të gjithë qytetarët kanë të drejtën e pajisjes me pasaportë. Të miturit mund ta marrin pasaportën vetëm me kërkesën e prindërve a kujdestarit. Në këtë rast ligji nuk bën dallim për gruan a burrin, nënën a babanë. Gjuha e përdorur nga ky nen i përfshin të dy sekset, pra është jodiskriminuese.[55] Veç këtyre, neni 12 i Kodit Civil i ofron çdo personi madhor të drejtën për të caktuar lirisht vendbanimin e tij.

Përputhja *De Facto*

1. Barazia para ligjit. Ndërsa ekziston baza ligjore, asnjë studim nuk është bërë për të identifikuar fushat në të cilat gratë nuk trajtohen njësoj me burrat. Përpjekjet për të informuar publikun e gjerë mbi barazinë gjinore janë bërë kryesisht nëpërmejt Komitetit për Mundësi të Barabarta (KMB). KMB-ja ka organizuar sesione trainimi në zona të ndryshme të Shqipërisë që nga 1998 për të ndërgjegjësuar përfaqësuesit/et e OJF-ve dhe qeverisë lokale për legjislacionin shqiptar dhe atë ndërkombëtar mbi të drejtat e grave, përfshirë një leksion mbi CEDAW të komentuar nen për nen, dhe Platformën e Veprimit të Qeverisë Shqiptare. Këto përpjekje u financuan nga donatorë të ndryshëm si Organizata Ndërkombëtare e Punës, Soros Shoqëria e Hapur për Shqipërinë, PNUD, dhe Fondacioni Friedrich Ebert.

2. Kapacitet i njëjtë ligjor si burrat, duke përfshirë dhe të drejtën për të përfunduar kontrata. Pjesëmarrja e grave në nisma biznesi është shumë e ulët, rreth 27 përqind. Shumica e grave janë të angazhuara në ndërmarrje të vogla biznesi. Kjo ndodh sepse pronësia e biznesit nuk konsiderohet si partneritet midis burrit dhe gruas, por si pronë e burrit, dhe gruaja përfshihet për të lehtësuar detyrimet fiskale. Një nga arsyet që ndalon gratë të angazhohen në biznes është se shumë individë ende perceptojnë angazhimin në biznes si një aktivitet korruptiv që nuk është i përshtatshëm për gratë. Gjithashtu, mungojnë politika të qeverisë që inkurajojnë gratë për t'u angazhuar në aktivitetet e biznesit.

3. Kontratat ose instrumentet që kufizojnë kapacitetin ligjor të grave janë të pavlefshme. Shteti nuk ka bërë ndonjë studim për të vendosur nëse ka ndonjë anshmëri mbi bazë të përkatësisë gjinore në arsyetimin, praktikat apo vendimet juridike.

4. Liria e lëvizjest; zgjedhja e banesës. Intervisat në grup treguan që gratë nuk ishin aq të lira sa burrat për t'u angazhuar në aktivitete jashtë shtëpisë. Megjithëse gratë mund të donin të largoheshin nga shtëpia vetëm, kjo ishte e vështirë përderisa burrat nuk janë të mësuar me zgjedhje të tilla. Leje duhej marrë në çdo rast me përjashtim të rasteve kur duhej shkuar te doktori – "urgjencat për sëmundje përjashtohen nga rregulli," siç u shpreh një pjesëmarrëse. Gratë që jetojnë në zonat urbane konsultoheshin me bashkëshortët nëse donin të punonin jashtë shtëpisë apo të udhëtonin jashtë shtetit. Në rastet e grave që jetojnë në zonat rurale, leja merrej nga kryetari i familjes, në disa raste, vjehrrit. Në një rast, një pjesëmarrrëseje i duhej të merrte leje nëpërmjet telefonit nga burri i saj emigrant për të vizituar familjen e saj. Kur gratë largohen nga shtëpia për pak ditë, leja gjithashtu nevojitej nga vjehrra që do të kujdesej për fëmijët dhe gjithë punët e shtëpisë. Leja e dhënë grave për të vizituar një qendër sociale ose për t'u angazhuar në aktivitete jashtë shtëpisë në zonat rurale ishte ndonjëherë e lidhur me interesin e burrave për të marrë nga komuna një nxitje apo mbështetje ekonomike. Kërkimi i lejes perceptohej nga gratë

[55] Neni 2, ligj nr. 8668, datë 23 nëntor 2000 "Për pajisjen e shtetasve shqiptarë me pasaportë për jashtë shtetit"

pjesëmarrëse si traditë dhe si shenjë respekti për brezat që jetojnë së bashku. Në kontrast, burrat e martuar raportuan se ata konsultoheshin me gratë e tyre vetëm kur ata vendosnin të udhëtonin jashtë shtetit. Si meshkujt e pamartuar dhe ata të martuar nuk e shihnin të nevojshme të merrnin leje nga askush për t'u larguar nga shtëpia për punë apo për argëtim.

Neni 16
1. Shtetet Palë do të marrin të gjitha masat e përshtatshme për të eliminuar diskriminimin e gruas në të gjitha çështjet që kanë të bëjnë me martesën dhe marrëdhëniet familjare. Në mënyrë të veçantë ata i sigruojnë gruas mbi bazën e barazisë së burrit dhe gruas:
(a) Të njëjtën të drejtë për të lidhur martesë;
(b) Të njëjtën të drejtë të zgjedhë lirisht bashkëshortin dhe të lidhë martesë vetëm me pëlqimin e vet, të lirë dhe të plotë;
(c) Të njëjtat të drejta dhe përgjegjësi gjatë martesës dhe në prishje të saj;
(ç) Të njëjtat të drejta dhe përgjegjësi si prindër, cilado qoftë gjendja martesore, për ato çështje që lidhen me fëmijët. Në të gjitha rastet, interesi i fëmijëve është konsiderata parësore;
(d) Të njëjtat të drejta për të vendosur lirisht dhe me njohuri të plota për numrin dhe shkallëzimin e lindjeve e po ashtu për të marrë informacionin, arsimin dhe mjetet e nevojshme që bëjnë të mundur ushtrimin e këtyre të drejtave;
(e) Të njëjtat të drejta dhe përgjegjësi për çështjet që kanë të bëjnë me tutelën, kujdestarinë, ruajtjen dhe birësimin e fëmijëve ose lidhur me institucione të ngjashme, kur këto koncepte ekzistojnë në legjislacionin kombëtar; në çdo rast, interesi i fëmijëve është konsiderata parësore;
(ë) Të njëtjat të drejta personale, si burrit dhe gruas, përfshirë dhe të drejtën për të zgjedhur mbiemrin, profesionin dhe llojin e punës;
(f) Të njëjtat të drejta për secilin prej bashkëshortëve lidhur me pronësinë, blerjen, drejtimin, administrimin, gëzimin dhe disponimin e pasurisë, si falas ashtu edhe me pagesë.
2. Fejesat dhe martesat e fëmijëve të mitur nuk kanë efekt juridik, prandaj merren të gjitha masat e nevojshme, përfshirë dispozitat ligjore, me qëllim që të caktohet një moshë minimale për martesë dhe të bëhet i detyrueshëm regjistrimi i martesës në një regjistër zyrtar.

Fushat Shqetësuese

- Familja mbetet një nga mjediset kryesore ku vajzat dhe gratë diskriminohen.
- Mundësia e vajzave të reja në zonat rurale për të zgjedhur bashkëshortin është e kufizuar.
- Gratë kanë pjesën më të madhe të përgjegjësive për punët e shëpisë dhe kujdesin e fëmijëve.
- Shteti nuk ka ndërmarrë ndonjë fushatë informuese në lidhje me martesën nën moshën e lejuar me ligj.
- Megjithëse gratë mund të trashëgojnë prona nga baballarët, zakonisht të drejat e pronësisë i takojnë të gjithë familjes dhe mund të transferohen te kryetari i familjes.

Përputhja *De Jure*

Legjislacioni shqiptar përputhet mirë me Nenin 16 të CEDAW-t. Kushtetuta (neni 53) i garanton çdokujt të drejtën për t'u martuar dhe për të patur familje. Kodi i Familjes që ka hyrë së fundmi në fuqi shpall në nenin 1 të tij parimin e rëndësishëm të barazisë morale dhe juridike të bashkëshortëve. Pëlqimi i lirë i të dy bashkëshortëve, i shprehur para nëpunësit të gjendjes civile përbën një kusht të rëndësishëm për vlefshmërinë e martesës.[56] Mosha minimale për martesë është 18 për të dy bashkëshortët e ardhshëm.[57] Në martesë, burri dhe gruaja kanë të njëjtat të drejta dhe detyrime[58], përsa i përket

[56] Kodi i Familjes, ligj nr. 9062, datë 8 maj 2003, nenet 8 dhe 33
[57] Kodi i Familjes, ligj nr. 9062, datë 8 maj 2003, neni 7
[58] Kodi i Familjes, ligj nr. 9062, datë 8 maj 2003, neni 50

besnikërisë, dashurisë dhe respektit reciprok, mbështetjes morale dhe materiale, bashkëpunimit, rritjes dhe edukimit të fëmijëve. Kur njëri nga bashkëshortët nuk përmbush detyrimet që rrjedhin nga martesa, bashkëshorti tjetër (pa dallim përsa i përket seksit) mund të kërkojë nga gjykata marrjen e masave urgjente. Qëllimi i tyre është të detyrojnë bashkëshortin të zbatojë detyrimet e tij ndaj familjes. Me qenë se Kodi i Familjes ka hyrë rishtazi në fuqi, nuk ka ende jurisprudencë (vendime gjyqësore) që të vënë në dukje llojet e ndryshme të masave urgjente.

Kodi kërkon mirëkuptimin reciprok dhe pëlqimin e të dy bashkëshortëve lidhur me banesën e tyre bashkëshortore, administrimin e pasurisë, lidhjen e kontratave martesore, zgjedhjen e regjimit pasuror dhe madje edhe për rastet e zgjidhjes së martesës me pëlqimin e palëve. Rastet e tjera të zgjidhjes së martesës bëhen me ngritjen e padisë nga njëri bashkëshort.

Legjislacioni shqiptar tregon kujdes të veçantë për pëlqimin si dhe për mbrojtjen e jetës familjare. Kështu, Kodi Penal i kushton një seksion të tërë mbrojtjes së fëmijëve, martesës dhe familjes.[59] Kodi i konsideron vepra penale dhe vendos sanksione (gjobë ose burgim) për veprimet e mëposhtme: (a) braktisjen e fëmijëve të mitur; (b) mosdhënien e mjeteve për jetesë fëmijëve dhe familjes; (c) mosnjoftimin e ndryshimit të vendbanimit; (d) marrjen e padrejtë të fëmijës dhe (e) shtrëngimin ose pengimin për të bashkëjetuar ose për të zgjidhur martesë. Mbrojtje e mëtejshme sigurohet nga dispozitat që trajtojnë abuzimin seksual me të mitur[60] Në legjislacionin shqiptar nuk gjejmë ndonjë rregullim për robërinë shtëpiake (mbajtjen e detyruar të një personi në shtëpi si shërbëtor/e).

Barazia e bashkëshortëve është parim në legjislacionin shqiptar dhe gjen zbatim edhe pas zgjidhjes së martesës, kur bëhet fjalë për pjesëtimin e pasurisë dhe zgjidhjen e çështjeve të tjera. Neni 147 parashikon se gjykata mund të urdhërojë njërin bashkëshort që t'i paguajë tjetrit një kontribut që ka për qëllim të kompensojë pabarazinë në nivelin e jetesës që mund të rrjedhë nga pjesëtimi i pasurisë. Neni 153, nga ana tjetër, i jep të drejtën bashkëshortit jopronar të vazhdojë të përdorë banesën bashkëshortore edhe pas zgjidhjes së martesës kur atij/asaj i besohet përgjegjësia prindërore, ose kur bashkëshorti pronar ka braktisur familjën.

E drejta familjare shqiptare parashikon të njëjtat të drejta dhe detyrime për të dy prindërit kundrejt fëmijëve të tyre, pavarësisht nga gjendja e tyre martesore. Ndonëse janë kryesisht gratë ato që mbajnë barrën më të madhe, Kodi përdor termin neutral nga pikëpamja gjinore "prind". Kushtetuta[61] dhe Kodi i Familjes[62] vendosin barazinë e fëmijëve të lindur nga martesa apo jashtë martese. Neni 3/1 i Kodit të Familjes e përforcon këtë parim: "Prindërit kanë detyrë dhe të drejtë të kujdesen për mirërritjen, zhvillimin, mirëqenien, edukimin dhe arsimimin e fëmijëve të lindur nga martesa ose jashtë martese." [63] Po kështu, zgjidhja e martesës nuk i ndryshon këto të drejta dhe përgjegjësi ndaj fëmijëve, me përjashtim të rasteve të parashikuara nga ky Kod. Prindi të cilit nuk i është besuar fëmija për rritje dhe edukim, ruan të drejtën të mbikqyrë rritjen

[59] Kodi Penal i RSH, ligj nr. 7895, datë 27 janar 1995, seksioni IX
[60] Kodi Penal i RSH, ligj nr. 7895, datë 27 janar 1995, nenet 100 dhe 101
[61] Kushtetuta e RSH, ligj nr. 8417, datë 21 tetor 1998, neni 54/2
[62] Kodi i Familjes, ligj nr. 9062, datë 8 maj 2003, neni 4
[63] Sipas nenit 220 të Kodit të Familjes përgjegjësia prindërore u përket dhe ushtrohet së bashku nga të dy prindërit në lidhje me fëmijën e lindur gjatë martesës së tyre ose jashtë martese.

dhe edukimin e fëmijës si dhe të informohet në lidhje me zgjedhjet e rëndësishme për jetën e fëmijës. Gjithashtu ky prind ruan edhe të drejtën e vizitës.[64]

Për birësimin kërkohet pëlqimi i të dy prindërve biologjikë. Kodi nuk bën ndonjë dallim mbi bazën e seksit për prindërit adoptivë dhe përdor termin "prind adoptiv". Një ndryshim që ka lidhje me seksin ka të bëjë me mbiemrin e fëmijës, si kur ky është natyral, ashtu edhe kur është i adoptuar. Fëmija merr mbiemrin e përbashkët të prindërve, ose mbiemrin që prindërit vendosin me marrëveshje (kur ata mbajnë mbiemra të ndryshëm). Mirëpo në rast mosmarrëveshje fëmija merr mbiemrin e babait.

Bashkëshortët gëzojnë të njëjtat të drejta në lidhje me mbiemrin e tyre;[65] ata janë të lirë të mbajnë mbiemrin e vet apo të marrin mbiemrin e bashkëshortit (nuk bëhet dallim për nga seksi).

Neni 63 parashikon të drejtën e secilit bashkëshort (burrit apo gruas) për të ushtruar një profesion dhe për të disponuar të ardhurat nga puna apo nga burime të tjera, në bazë të regjimit pasuror të zgjedhur, pasi të kenë kontribuar në detyrimet që rrjedhin nga martesa. Bashkëshortët kanë të njëjtat të drejta mbi pronësinë, përfshi fitimin, administrimin, gëzimin dhe disponimin. Ndërsa secili nga bashkëshortët ka të drejtën të administrojë dhe disponojë lirisht pasurinë vetjake, [66] pëlqimi i bashkëshortit tjetër është i domosdoshëm në rastin e disponimit të banesës bashkëshortore dhe pajisjeve të saj.[67] Gjithashtu, bashkëshortët janë të lirë të lidhin një kontratë paramartesore ose një kontratë të mëvonshme martesore, ku ata mund të zgjedhin regjimin pasuror martesor që i përshtatet më shumë mënyrës së tyre të jetesës.

Martesë mund të lidhet mes një burri dhe gruaje që kanë mbushur të paktën 18 vjeç.[68] Për shkaqe me rëndësi (kryesisht shtatzëni) gjykata mund të autorizojë martesën para mbushjes së moshës ligjore. Ndërsa ligji shqiptar nuk njeh dhe nuk rregullon fejesën, martesën e të miturve e konsideron të pavlefshme.[69]

Përsa i përket regjistrimit të martesës neni 30/2 i Kodit të Familjes përcakton: "Akti i martesës hartohet menjëherë, nënshkruhet nga bashkëshortët, dëshmitarët dhe nëpunësi i gjendjes civile dhe regjistrohet në regjistrin e martesave." Ndërkaq, Ligji për Gjendjen Civile[70] vendos detyrimin për regjistrimin e martesës në Librin e Martesave dhe njëkohësisht parashikon edhe rregullat proçedurale për këtë veprim.

Përputhja *De Facto*

Institucioni më i qëndrueshëm i shoqërisë shqiptare, familja, mbetet gjithashtu një rrugë e rëndësishme për diskriminimin dhe dhunën ndaj vajzave dhe grave. Në mënyrë të vazhdueshme, pjesëmarrësit/et përmendën ndarjen e pabarartë të punëve të shtëpisë dhe kujdesit. Në fakt gratë priten të kontribojnë më shumë në familje se në shoqëri.

---

[64] Përkufizimi i përgjegjësisë prindërore bëhet nga neni 215 i Kodit të Familjes si tërësia e të drejtave dhe detyrave që kanë për qëllim të sigurojnë mirëqenien emocionale, sociale dhe materiale të fëmijës, duke u kujdesur për të, duke mbajtur raporte vetjake me të, duke i siguruar atij mirërritjen, edukimin, arsimimin, përfaqësimin ligjor dhe administrimin e pasurive të tij.
[65] Kodi i Familjes, ligj nr. 9062, datë 8 maj 2003, neni 51
[66] Kodi i Familjes, ligj nr. 9062, datë 8 maj 2003, neni 64
[67] Kodi i Familjes, ligj nr. 9062, datë 8 maj 2003, neni 54
[68] Kodi i Familjes, ligj nr. 9062, datë 8 maj 2003, neni 7
[69] Kodi i Familjes, ligj nr. 9062, datë 8 maj 2003, neni 39
[70] Ligj nr. 8950, datë 10 tetor 2002 "Për gjendjen civile", nenet 42/1, 43 dhe 48

1(a) E njëjta e drejtë për të hyrë në martesë. Megjithëse informacioni mbi të drejtat e barabarta në martesë, regjistrimi në zyrën e gjendjes civile dhe zgjidhjes së martesës është i disponueshëm dhe i jepet si burrave dhe grave, individët mbështeten në rrjetet e tyre shoqërore për të marrë dhe shkëmbyer këtë lloj informacioni. Për më tej, në zonat rurale, informacioni në këto fusha jepet në formën e normave dhe vlerave shoqërore që respektohen dhe vlerësohen nga të gjithë.

1(b) E njëjta e drejtë për të zgjedhur bashkëshortin/en lirisht dhe për të hyrë në martesë vetëm lirisht dhe me pëlqim të plotë. Gratë kanë të drejtë të zgjedhin burrin lirisht dhe të hyjnë në martesë lirisht dhe me pëlqimin e tyre të plotë. Megjithatë martesa është e ndërtuar si një normë dhe është e dëshirueshme për statusin shoqëror të gruas.

Burrat dhe gratë shqiptare kanë tendencë të martohen herët. Pjesa më e madhe martohen midis moshës 20 dhe 29 vjeç, por femrat martohen më herët siç tregohet në tabelën e mëposhtme:

Grupmosha	Femra	Meshkuj
Deri 19 vjeç	22%	1%
20-24 vjeç	49%	21%
25-29 vjeç	18%	43%
30-34 vjeç	6%	23%
35-39 vjeç	2%	7%
40-44 vjeç	1%	3%
45-49 vjeç	1%	1%
Mbi 50 vjeç	1%	1%
INSTAT, 2004		

Studimet tregojnë se martesa shpesh perceptohet si qëllim i jetës, megjithëse femrat shqiptare mund të zgjedhin të martohen për t'i shpëtuar varfërisë dhe dhunës në shtëpinë e prindërve. Traditat patriakale të martesave të rregulluara nëpërmjet autoritetit prindëror janë ende të shpeshta (Baban, 2004). Vajzat e reja në zonat rurale zakonisht presin që familja e tyre t'u zgjedhë bashkëshortin dhe rrallë e kundërshtojnë zgjedhjen e familjes.

1(c) Të njëjtat të drejta dhe përgjegjësi gjatë martesës dhe në zgjidhjen e saj. Gratë dhe burrat kanë të njëjta të drejta dhe përgjegjësi, megjithatë gratë perceptohen se kanë pjesën më të madhe të ngarkesës në mirëmbajtjen e shtëpisë. Ndërsa gratë kanë ligjërisht të drejtën të shkurorëzojnë bashkëshortin e tyre, stigma social-kulturore e bëjnë të vështirë marrjen e vendimit, veçanërisht në zonat rurale.

1(d) Të drejtat dhe përgjegjësitë e prindërve në lidhje me fëmijët. Të dy prindërit kanë të drejta dhe përgjegjësi ndaj fëmijëve, megjithatë gratë janë ato që mbajnë përgjegjësitë më të shumta për kujdesin e fëmijëve.

1(e) Numri dhe planifikimi i fëmijëve; marrja e informacionit për planifikimin familjar. Shih informacionin në Nenin 10, 12, dhe 15.

1(f) Kujdestaria dhe adoptimi i fëmijëve. Në lidhje me barazinë para ligjit për prindërimin dhe neglizhencën e fëmijëve, të dy prindërit mund t'i drejtohen gjyqit për t'ia hequr të drejtën

e kujdestarisë nga prindi tjetër. Përfaqësuesit/et e ligjit përmendën që zakonisht gruaja favorizohet më shumë, pasi në shumicën e rasteve kujdestaria e fëmijës i jepet grave. Pak pjesëmarrës perceptonin që gjykatësit/et bëjnë më shumë lëshime me gratë në rastet e gjyqeve për çështjeve të familjeve.

1(g) E drejta për të zgjedhur mbiemrin, profesionin dhe vendin e punës. Kjo e drejtë ushtrohet sidomos nga gratë në zonat urbane. Stereotipet lidhur me profesionin dhe vendin e punës janë të shumta. Vajzat e reja gjendjen më shumë në shkencat shoqërore dhe filologjike.

1(h) Të drejtat e pronës. Megjithëse gratë mund të trashëgojnë pronë nga baballarët e tyre, pjesëmarrëset përmendën se të drejtat e pronës zakonisht i takojnë të gjithë familjes dhe ndoshta mund të transferohen te kryetari i familjes.

2. Martesa para moshës së pëlqimit; vendosja e një rregjistri zyrtar të martesave. Megjithëse mosha ligjore për martesë është 18 vjeç, pjesëmarrësit/et përmendën raste të vajzave të reja që martohen në moshën 16 vjeç, sidomos në zonat rurale. Megjithatë nuk ka informacion mbi shpeshtësinë e kësaj dukurie. Martesa para moshës së pëlqimit nuk deklarohet në zyrën e gjendjes civile, sepse kjo lloj martese është e dënueshme nga ligji. Asnjë fushatë ndërgjegjësimi nuk është ndërmarrë nga shteti në lidhje me martesën para moshës së pëlqimit.

> "Unë nuk jam dakord që vajzat të martohen në moshë kaq të re [16 vjeç]. Ato nuk dinë asgjë rreth detyrimeve në familje…nuk e dinë se ç'do të thotë të kesh përgjegjësi ndaj burrit, ndaj vjehrrit dhe vjehrrës. Ti ndan një shtëpi me ta. Është e rëndësishme që ajo t'idijë detyrat t saj."
>
> *Pjesëmarrëse nga Vlora*

KONKLUZIONE

Ky vlerësim tregoi se ndërsa ka patur arritje, mbetet shumë punë për të bërë në adresimin e barazisë gjinore në shumë fusha të jetës në Shqipëri. Në këto konkluzione, ne reflektojmë në dobishmërinë e të dhënave të paraqitura në raport, drejtimet e ardhshme për zbatimin e legjislacionit për gratë, dhe disa nga fushat për punë të mëtejshme sugjeruar nga pjesëmarrësit që kontribuan në pjesën *de facto* të raportit.

Dobishmëria e të dhënave

Përdorimi i të dhënave si bazë për raportet e qeverisë dhe raportet alternative. Një nga sfidat kryesore në përpilimin e këtij raporti vlerësues ishin të dhënat e pamjaftueshme në lidhje me gjendjen e përgjithsme të gruas krahasuar me zbatimin e Konventës. Për shembull, nevojiten statistika më të mira që mbështesin informacionin e gjithanshëm në punësim, shëndet, dhe marrje të shërbimeve financiare. Duke treguar se çfarë të dhënash mungojnë, vlerësimi sugjeron natyrën e statistikave të nevojitura dhe si ato mund të interpretohen në bazë të rekomandimeve që vijnë nga CEDAW. Këto të dhëna mund të përdoren më pas - së bashku me të dhëna të tjera ekonomike – nga bërësit/et e politikave në bërjen e vendimeve nëse punohet për të marrë masa për të influencuar punën e ardhshme në përmirësimin e pozicionit të grave ose të ndihmojnë ata që preken nga çështje social ekonomike, si ato të papunësisë, mungesa e arsimit cilësor dhe mungesa e marrjes së shërbimeve të kujdesit shëndetësor.

Instrument për ngritjen e kapaciteteve. Një temë që përshkron vlerësimin është që shteti shqiptar ka nevojë të përmirësojë efektivitetin dhe efiçencën me të cilën organizmat ekzekutive dhe legjislative japin shërbimet dhe programet, duke rritur kështu përfitimet për vajzat dhe gratë në zonat urbane dhe rurale. Duke u mbështetur në të dhënat dhe përvojat aktuale të aktorëve qeveritarë dhe jo-qeveritarë të dhënat për çdo aspekt të neneve të CEDAW, vlerësimi tregon se si puna e ardhshme mund të përshtatet për të ndihmuar në përmirësimin dhe promovimin e zbatimit të Konventës.

OJF-të mund ta përdorin për të eksploruar fushat e punës së tyre. Vlerësimi tregoi se OJF-të e grave kanë udhëhequr punën në përmirësimin e pozicionit të grave në shoqërinë shqiptare. Ato kanë shërbyer kryesisht si agjente të advokacisë dhe burime për mendime alternative. Megjithatë, ato ende kanë nevojë të koordinojnë punën e tyre dhe të përmirësojnë aftësitë dhe përvojën e tyre për të planifikuar, zbatuar dhe vlerësuar projekte që kanë për qëllim të përmirësojnë jetën e vajzave dhe grave. Raporti mund të japë sugjerime se si OJF-të mund të monitorojnë dhe të vlerësojnë projekte të tilla.

Përmbajtje për trainime me gratë. Puna në terren tregon se më shumë duhet bërë për të familiarizuar vajzat dhe djemtë, gratë dhe burrat shqiptarë me përmbajtjen e CEDAW.

Të dhënat mund të shërbejnë si material ilustrues për të prezantuar dhe shpjeguar nenet e Konventës. Këto sesione trainimi mund të përshtaten për bërësit dhe zbatuesit e politikave, edukatorëve të shkollave dhe punonjësve në sektorin e shërbimeve.

Përdorimi nga donatorët për të koordinuar ndihmën në lidhje me gratë dhe zhvillimin. Vlerësimi gjithashtu tregoi se mungon koordinimi i punës për të përmirësuar pozicionin e grave ç'ka mund të rezultojë në shpërdorimin e burimeve. Për të koordinuar këtë lloj ndihme, është e domosdoshme që donatorët të bien dakord në një strategji të përbashkët zhvillimi dhe të vendosin programe zhvillimi me synim për të ndarë punën mes tyre për të ndjekur synime të përbashkëta të politikave. Duke ofruar të dhëna nga intervistat në terren, vlerësimi i fton donatorët të koordinojnë ndihmën e tyre të bazuar në realitetin e asisistimit të aktiviteteve për gratë dhe vajzat në nivelin e terrenit. Intervistat sugjeruan që nismat e marra në nivelin lokal (për shembull, nisma për të përballuar mungesën e mjediseve për arsimim cilësor) duhet t'u përgjigjen nisma të ofruesve të ndihmës për zhvillim në mbështetje të atyre nismave.

Vështrim drejt së ardhmes lidhur me zbatimin e legjislacionit shqiptar për gruan

Megjithë tablonë legjislative përgjithësisht pozitive, zbatimi i ligjit ende përbën sfidë për Shqipërinë post-komuniste. Për këtë rekomandohet krijimi i mekanizmave efektive që sigurojnë zbatimin e ligjit, të tilla si struktura të thjeshta me mandate dhe kompetenca të qarta, sanksione dhe mbikqyrje efektive, gërshetuar edhe me vullnet të vendosur politik dhe trysni të fortë nga organizatat e shoqërisë civile.

Integrimi i perspektivës gjinore (*gender mainstreaming*) në të gjitha ligjet dhe politikat si një concept i avancuar dhe strategji në vetvete për arritjen e barazisë gjinore duhet të përqafohet nga të gjithë organet ligjvënëse dhe ligjzbatuese. Analiza e thelluar e legjislacionit ekzistues në të gjitha fushat dhe sidomos e projektligjeve të ardhshme nga këndvështrimi gjinor duhet bërë pjesë e pandarë e çdo proçesi ligjvënës.

Drejtime të Ardhshme për Zbatimin *De Facto* të CEDAW

Në lidhje me zbatimin e të drejtave të grave, pjesëmarrësit/et u pyetën se si e shikonin të ardhmen e statusit të grave dhe nëse ata do të sugjeronin ndryshime në praktikën e tanishme.

Një lëvizje e gruas që duhet të ketë burrat si partnerë është thelbësore për zbatimin e të drejtave të grave.

Që situata e grave të përmirësohet, burrat kanë nevojë të njohin dhe mbrojnë lëvizjen e grave për përfitimin e njwjtw tw grave dhe burrave. Mbështetja e burrave është e rëndësishme në të gjitha aspektet e ndryshimit, duke përfshirë ndarjen e përgjegjësive në shtëpi dhe prindërimin, dhënien fund të të gjitha formave të dhunës kundër grave, përfshirë përdhunimin, ngacmimin seksual dhe dhunën në familje. Pjesëmarrësit/et pranuan nevojën vendimtare për të përfshirë burrat në të gjitha shërbimet dhe edukimin që i mundëson ata të ndajnë përgjegjësitë për punësim dhe shëndet riprodhues.

Barazia gjinore arrihet nëpërmjet punës së shumë aktorëve.

Shteti, OJF-të dhe individët janë të gjithë aktorë të rëndësishëm në përmirësimin e pozicionit të grave në shoqërinë shqiptare. Për mendimin e pjesëmarrësve/eve:

- Shteti është pushteti organizativ me strategji të qarta, shërbime konkrete dhe mbështetje financiare. Legjislacion ka nevojë të forcohet dhe të bëhet më normativ dhe i detyrueshëm. Strategji afat-gjata me qëllime të qarta duhet të përqëndrohen në grupet e margjinalizuara, përfshirë gra rurale dhe Roma.

- Shoqëria civile duhet të mbështesë dhe të komplementojë këto politika dhe të rrisë ndërgjegjësimin. Transparenca dhe bashkëpunimi midis organizatave të shoqërisë civile është shumë i rëndësishëm.

- Media ka nevojë të bëjë fushata informimi dhe të edukojë publikun mbi rëndësinë e njohjes dhe respektimit të legjislacionit mbi përkatësinë gjinore. Puna duhet të përqëndrohet veçanërisht në eliminimin e stereotipeve që diskriminojnë gratë në media.

- Individët duhet të përpiqen shumë për të mbrojtur të drejtat e tyre. Gratë gjithashtu duhet të mësojnë se si të lobojnë dhe të mbrojnë njëra tjetrën mbi të drejtat e tyre dhe më shumë solidaritet gjinor midis tyre. Burrat gjithashtu duhet të përfshihen në të gjithë përpjekjet për rritjen e ndërgjegjësimit.

Një buxhet i përgjegjshëm ndaj gjinisë është i rëndësishëm për arritjen e qëllimeve drejt barazisë gjinore.

Shqipëria nuk ka bërë asnjë analizë të ndikimit që shpenzimet dhe të ardhurat e qeverisë kanë në gratë dhe vajzat krahasuar me burrat dhe djemtë. Sipas njohurive të pjesëmarrësve dhe të autorëve, asnjë nismë për buxhet gjinor nuk është ndërmarrë në nivelin kombëtar apo lokal nga Ministria e Financave ose ndonjë OJF. Buxhetimi gjinor mund të jetë një nga mënyrat për ta mbajtur Qeverinë Shqiptare përgjegjëse ndaj angazhimit të saj për të respektuar dhe zbatuar të drejtat dhe barazinë e grave.

SHTOJCA 1

BURIME SUPLEMENTARE

Baban, A. (2004). *Domestic violence against women in Albania* [Dhuna shtëpiake kundër grave në Shqipëri]. Tiranë, Shqipëri: UNICEF.

Burazeri, G., Roshi, E., Jewkes, R., Jordan, S., Bjegovic, V., & Laaser, U. (2005). Factors associated with spousal physiçal violence in Albania: a cross sectional study [Faktorë të shoqëruar me dhunën fizike bashkëshortore në Shqipëri]. *BMJ, 331*, 197-201.

Carrillo, R., Connor, M., Fried, S., Sandler, J. & Waldorf, L. (2003). *Not a minute more: Ending violence against women* [Asnjë minutë më shumë: T'i japim fund dhunës kundër grave]. New York, NY: United Nations Development Fund for Women.

Chen, M., Vanek, J., Lund, F., & Heintz, J. (2005). Progress of World's Women 2005: Women, work and poverty. New York, NY: United Nations Development Fund for Women.

Qendra për Nisma Ligjore Qytetare(2005). *Civil Society Monitoring Draft Laws from the Gender Perspective Monitorimi i Projektligjeve nga Shoqëria Civile në Këndvështrimin Gjinor*. Tiranë Shqipëri

Committee for Equal Opportunities. (2002). Initial and first periodic report of state parties under the Convention on the Elimination of All Forms of Discrimination Against Women Albania. Tirana, Albania: Author.

Gjermeni, E. & Bregu, M. (2003). *Monitoring media coverage of domestic violence 2001-2002*. Tirana, Albania: Women's Center.

Lawson, C. W., Mcgregor, J. A., & Saltmarshe, D. K. (2000). Surviving and thriving: Differentiation in a peri-urban community in Northern Albania. *World Development, 28* (8), 1499-1514.

Shkolla e Magjistraturës dhe Qendra për Nisma Ligjore Qytetare (2005). *Trajtesa Juridike dhe Sociale për Mbrojtjen nga Dhuna ne Familje*. Numër special i revistës "Jeta Juridike" dhe "Ligji-mundësi zhvillimi për gratë"

National Human Development Report Albania. (2005). *Pro-poor & pro-women policies & development in Albania: Approaches to operationalising the MDGs in Albania*. Tirana, Albania: UNDP Albania.

Orgocka, Aida. (2005). Albanian high skilled migrant women in the US: The ignored experience. In R. King, N. Mai and S. Schwander-Sievers (Eds.), *The New Albanian Migration*. Brighton: Sussex Academic Press.

Senturia, K. D. (1997). A woman's work is never done: Women's work and pregnancy outcome in Albania. *Medical Anthropology Quarterly, 11*(3), 375-395.

Tarifa, F. (1994). Disappearing from politics: Social change and women in Albania. In M. Rueschemeyer (ed), *Women in the politics of postcommunist Eastern Europe* (pp. 133-151). New York: M. E. Sharpe, Inc.

SHTOJCË 2

LISTË E PLOTË E ASPEKTEVE SHQETËSUESE

Neni 1

- Përkufizimi i "diskrimimit" në legjislacionin e tanishëm shqiptar është i paplotë.
- Përkufizimi "diskriminim kundër grave" siç jepet në Nenin 1 të CEDAW nuk është pasqyruar në legjislacionin shqiptar.
- Ka mospërputhje të konsiderueshme midis konceptit të barazisë midis burrave dhe grave si përshkruhet në ligj dhe si zbatohet në jetë.
- Megjithëse Shqipëria ka ratifikuar CEDAW, kjo e fundit njihet pak ndër aktorë të ndryshëm. Koordinimi midis Qeverisë Shqiptare dhe OJF-ve për të informuar gratë për CEDAW dhe legjislacionin mbi të drejtat e grave në Shqipëri mbetet i dobët.

Neni 2

- Sfera e aplikimit të Ligjit të Barazisë Gjinore është e kufizuar vetëm në jetën publike. Diskriminimi me bazë gjinore në besimin fetar apo jetën private nuk mbulohen nga garanci ligjore.
- Është e nevojshme të hartohen aktet nënligjore dhe të ngrihen mekanizmat institucionalë për zbatimin e barazisë gjinore dhe eliminimin e diskriminimit me bazë gjinore.
- Zbatimi i sanksioneve kundër diskriminimit sipas Ligjit të Barazisë Gjinore është i vështirë pasi dispozita është e paqartë.
- Kodi Penal Shqiptar nuk përmban dispozita për dhunën në familje.
- Legjislacionit shqiptar i mungojnë mekanizmat dhe proçedurat e duhura për rastet e dhunës në familje.
- Nuk është bërë asnjë analizë gjinore mbi legjislacionin e tanishëm apo atë që po hartohet.
- Niveli i perceptimit në lidhje me ekzistencën e sanksioneve kundër pabarazisë gjinore është i ulët.
- Ekzistojnë pak instrumente që sigurojnë zbatimin e barazisë gjinore.
- Praktikat fetare dhe kulturore ndikojnë në diskriminimin e grave.
- Shteti shqiptar ende nuk ka botuar një përkthim zyrtar të tekstit të CEDAW-t.

Neni 3

- Aktet nënligjore që përshkruajnë me hollësi përbërjen, strukturën dhe detyrat specifike të institucioneve që sigurojnë barazinë gjinore nuk është i disponueshëm.
- Mbështetja financiare për këto struktura nuk merret në konsideratë në aprovimin e ligjit të buxhetit vjetor.
- Mungojnë autoritetet/strukurat për përkatësinë gjinore në nivelin ministror me mandat ligjor integrimin e përkatësisë gjinore në të gjitha fushat (*gender mainstreaming)*.
- Mungon plani afatgjatë për zbatimin e nenit 3 të CEDAW-t

Neni 4

- Legjislacionit shqiptar përgjithesisht i mungojnë masat e veçanta të përkohshme, të tilla si kuotat, sistemi i zebrës, trajtim preferencial për gratë, etj. që synojnë

përshpejtimin e arritjes së barazisë midis burrave dhe grave në të gjitha sferat e jetës.

- Ligji i Barazisë Gjinore prezanton konceptin e masave të veçanta të përkohshme, por pa specifikime të mëtejshme për ta bërë efektiv.
- Fushatat informuese për të kuptuar Ligjin e Barazisë Gjinore janë organizuar kryesisht nga OJF-të.

Neni 5

- Fushatat kombëtare informuese për të adresuar eleminimin e stereotipeve gjinore janë kryer kryesisht nga OJF-të.
- Media i ushqen stereotipet duke kriminalizuar ose mbivlerësuar seksualisht gratë.
- Gratë ende vazhdojnë të mbajnë peshën kryesore në familje, megjithëse ato mund të jenë të punësuara dhe jashtë shtëpisë.

Neni 6

- Legjislacioni shqiptar e penalizon prostitucionin.
- Mbrojtja e dëshmitarëve nuk është shumë efektive
- Mungon bashkëpunimi për zbatimin e ligjeve.
- Janë bërë pak përpjekje në fushata mbarëkombëtare për rritjen e ndërgjegjësimit në lidhje me trafikun.
- Dhuna kundër prostitutave nuk raportohet. Nuk ka të dhëna për nivelin e dhunës.
- Nevojitet mbrojtja dhe/ose ndihma për viktimat dhe rehabilitimin e tyre.

Neni 7

- Pjesëmarrja e ulët e grave në jetën politike ka rezultuar në përfaqësim të ulët të grave në strukturat e vendimmarrjes.
- Mungojnë kuotat ose sisteme të ngjashme që inkurajojnë pjesëmarrjen e grave në politikë ose në strukturat e vendimmarrjes.
- Megjithë përputhjen e mirë legjislative me këtë nen, ligjet rrallë përkthehen në programe konkrete dhe politika që sigurojnë pjesëmarrjen reale për gratë.
- Një mentalitet specifik gjinor që i sheh gratë si ofruese të kujdesit familjar dhe burrat si udhëheqës në politikë i bën gratë të tërhiqen nga pjesëmarrja në jetën politike.
- Duhet të bëhet kujdes për një drejtpeshim midis cilësisë dhe sasisë së kandidateve të angazhuara në politikë.

Neni 8

- Gratë kanë përfaqësim të ulët në nivelet ndërkombëtare.
- Gratë kanë përfaqësim të ulët në Trupin Diplomatik.

Neni 9

- Megjithëse gratë mund të pajisen me pasaporta dhe nuk kërkohet nga ligji që ato të paraqesin leje, ato zakonisht kërkojnë pëlqimin e bashkëshortit përpara se të udhëtojnë brenda ose jashtë vendit.

Neni 10

- Tekset mësimore nuk janë rishikuar në lidhje me stereotipet gjinore.
- Arsimimi për të rritur ndodh vetëm në mënyrë sporadike.

- Zbatimi i rregulloreve që dekurajojnë lënien e shkollës nga vajzat dhe djemtë ka mangësi.
- Megjithë dispozitat jo diskriminuese në bazë të përkatësisë gjinore, sportet mbeten të dominuara nga meshkujt.
- Edukimit për shëndetin dhe planifikimin familjar nuk i kushtohet vëmendje e duhur në planin mësimor dhe stafi mësimdhënës është pak i kualifikuar për të dhënë mësim në këto fusha.

Neni 11

- Ligjet që mbulojnë disa marrëdhënie specifike të punës dhe kategori specifike punonjësish nuk parashikojnë shprehimisht parimin 'pagesë të barabartë për punë me vlerë të barabartë'.
- Legjislacioni shqiptar nuk e njeh lejen e paslindjes për baballarët.
- Diferencimi në moshën e pensionit ul mundësitë e grave për ngjitje në karierrë dhe çon në një pagesë më të ulët pensioni, ç'ka rrit nivelet e varfërisë midis grave të moshuara.
- Legjislacioni mbrojtjes rishikohet vetëm në mënyrë sporadike.
- Mungojnë proçedura specifike ligjore për rastet e ngacmimit seksual.
- Mungojnë politika konkrete për integrimin e grave rurale që kanë emigruar në zonat urbane.

Neni 12

- Legjislacioni shqiptar nuk ndalon posaçërisht diskriminimin në kujdesin shëndetësor.
- Legjislacionit shqiptar i mungon mbrojtja e duhur për nënat me fëmijë në gji.
- Niveli i ndërgjegjësimit për planifikimin familjar është ende i ulët.
- Aksesi në shërbimet e kujdesit shëndetësor nuk është sistematik.
- Niveli i ndërgjegjësimit për të mirëmbajtur shëndetin është i ulët.
- Mungon trainimi gjithëpërfshirës për dhunën e bazuar në përkatësinë gjinore.
- Grave në moshën e menopauzës u jepet pak vëmendje.

Neni 13

- Legjislacioni shqiptar nuk përmend në mënyrë specifike barazinë ose mos-diskriminimin e grave në sferën e së drejtës civile.
- Biznesi i udhëhequr nga gratë nuk është ende i zhvilluar mirë.
- Gratë përfitojnë pak nga huatë dhe kredia e bankave.

Neni 14

- Gratë në zonat rurale janë më të diskriminuara. Megjithatë, legjislacioni shqiptar nuk bën dallim midis grave në zonat rurale dhe jo rurale.
- Mungojnë autoritetet e ngarkuara me detyrën specifike që të zbatojnë ose monitorojnë zbatimin e legjislacionit që mbron të drejtat e grave në zonat rurale në nivelin lokal.
- Marrja e kujdesit shëndetësor është problematike, veçanërisht në zonat e largëta.
- Braktisja e shkollës nga vajzat mbi 14 vjeç është e lartë.
- Pak gra përfitojnë nga skemat e sigurimeve shoqërore.
- Si për meshkujt dhe për femrat ka pak mundësi për të zhvilluar biznesin nëpërmjet kredisë.

- Mundësitë për të marrë pjesë në jetën e komunitetit janë të kufizuara.
- Kushtet e strehimit, higjenës, elektricitetit, furnizimit me ujë, shërbimet e transportit dhe komunikimit të duhur nuk janë njësoj kudo.

Neni 15

- Perceptimet social-kulturore kufizojnë mundësitë për t'u angazhuar me biznes.
- Shteti nuk ka bërë asnjë studim për të parë nëse ekziston ndonjë anësi gjinore në arsyetimin, praktikat dhe vendimet gjyqësore.
- Gratë kanë nevojë të marrin leje nga burrat për t'u angazhuar në punë apo për të udhëtuar.
- Nuk ekzistojnë politika inkurajuese nga qeveria që lejojnë gratë të përfshihen në aktivitete biznesi.

Neni 16

- Familja mbetet një nga mjediset kryesore ku vajzat dhe gratë diskriminohen.
- Mundësia e vajzave të reja në zonat rurale për të zgjedhur bashkëshortin është e kufizuar.
- Gratë kanë pjesën më të madhe të përgjegjësive për punët e shëpisë dhe kujdesin e fëmijëve.
- Shteti nuk ka ndërmarrë ndonjë fushatë informuese në lidhje me martesën nën moshën e lejuar me ligj.
- Megjithëse gratë mund të trashëgojnë prona nga baballarët, zakonisht të drejat e pronësisë i takojnë të gjithë familjes dhe mund të transferohen te kryetari i familjes.

SHTOJCA 3

LISTË E PLOTË E LEGJISLACIONIT TË MARRË NË ANALIZË

1. Kushtetuta e Republikës së Shqipërisë, ligj nr. 8417, datë 21.10.1998
2. Ligji për një Shoqëri Gjinore të Barabartë, nr. 9198, datë 1.7.2004
3. Kodi i Punës i Republikës së Shqipërisë, ligj nr. 7961, datë 12.7.1995
4. Kodi Civil i Republikës së Shqipërisë, ligj nr. 7850, datë 29.7.1994
5. Kodi Penal i Republikës së Shqipërisë, ligj nr.7895, datë 27.1.1995
6. Kodi i Proçedurës Penale i Republikës së Shqipërisë, ligj nr. 7905, datë 21.3.2005
7. Kodi i Familjes, ligj nr.. 9062, datë 8.5.2003
8. Kodi Zgjedhor, ligj nr. 8609, datë 8.5.2000
9. Ligji për Statusin e Nëpunësit Civil, nr. 8549, datë 11.11.1999
10. Ligji për Shtetësinë Shqiptare, nr. 8389, datë 5.8.1998
11. Ligji për Shërbimin e Jashtëm, nr. 9095, datë 3.7.2003
12. Ligji për Shëndetin Riprodhues, nr. 8876, datë 4.4.2002
